



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri
Telekomunikacioni”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Evis Trandafili

2. PhD. Miralda Çuka

Korrik/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë "Instituti Kanadez i Teknologjisë"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhëri i MA Nr. 781 datë 10/11/2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër MASR Nr. 8482/1, datë 31.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim ASCAL Nr. 38, datë 13.07.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	22 PAE / 2 PAK (Viti Akad. 2023-2024)
18	Numri i studentëve:	2021-2022 - 13 studentë; 2022-2023 - 8 studentë; 2023-2024 - 4 studentë.
19	Komente / të tjera:	




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Instituti Kanadez i Teknologjisë është një Institucion jopublik i Arsimit të Lartë licencuar me urdhër të Këshillit të Ministrave Nr. 781 datë 10/11/2011. Instituti Kanadez i Teknologjisë është akredituar në nivel institucional, për herë të parë me vendimin Nr. 116, datë 15.12.2017, për një periudhë 5 vjeçare dhe riakredituar me vendimin Nr. 06, datë 27.01.2023 për një periudhë 5-vjeçare.

Instituti Kanadez i Teknologjisë përbëhet nga 2 njësi kryesore, fakultete:

- Fakulteti i Ekonomisë;
- Fakulteti i Inxhinierisë;

Fakulteti i Inxhinierisë, njësi kryesore ku ky program studimi ofrohet, është i përbërë nga tre njësi bazë, përkatësisht:

- Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit;
- Departamenti i Inxhinierisë Softuerike;
- Qendra e Kërkimit Shkencor CIRD Inxhinieri;

Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” i cili përfshihet në ciklin e parë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit, Fakulteti i Inxhinierisë, Instituti Kanadez i Teknologjisë (IKT), është hapur që në vitin 2011 me emërtimin Bachelor në “Inxhinieri Industriale” dhe në vitin 2018 është riorganizuar me emërtimin Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” bazuar në vendimin e MASR Nr. 8482/1, datë 31.08.2018. Programi i studimit është rishikuar deri në masën 20% në vitin 2021 dhe në vitin 2024.

Vlerësimi i jashtëm për qëllim të akreditimit po realizohet për herë të dytë bazuar në kërkesën e Rektorit të Institutit Kanadez të Teknologjisë (IKT), “Aplikim për akreditimin periodik të programeve të studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” dhe Master i Shkencave në “Financë Kontabilitet”, drejtuar ASCAL-it, më datë 24.05.2023, Nr. 347 Prot. Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike ku në përfundim të tij përfitohet Diplomë Universitare Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni”. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” është i hartuar dhe zbatohet nga Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit, duke harmonizuar të gjithë komponentët e tij në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe me qëllimet dhe misionin e Institucionit dhe Departamentit. Qëllimi i këtij programi studimi është: Të formojë profesionistë të njohurive teknologjike dhe kompetencave profesionale në inxhinierinë e telekomunikacionit duke mos u kufizuar në teknologjitë apo specializimet konkrete.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni”. Bazuar në Urdhër nr. Nr.9, Datë 23.01.2024, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, grupi i vlerësimit përbëhet nga:

- Prof. Asoc. Evis Trandafili
- PhD. Miralda Cuka.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Aleksandra Xhamo.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Shkurt 2024 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB, dokumentacioni i paraqitur edhe në sistemin AMS të ASCAL.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 2 dhe 3 Maj 2024, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, Fakulteti i Inxhinierisë, Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit të procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterëve, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. dhe u zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.



Më datë 10.07.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 83/7 Prot., datë 10.07.2024, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 10.07.2024, dhe me shkresë zyrtare Nr. 415 Prot., datë 11.07.2024, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

Pasi shqyrtuam komentet e ardhura nga institucioni ne si ekspertë të jashtëm konkludojmë që institucioni është i dakortësuar me draft raportin e vlerësimit të jashtëm (DRVJ) prandaj gjykojmë që ky draft dërgohet tani nga ana jonë si Raport i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” në Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësish kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës, Instituti Kanadez i Teknologjisë (IKT), si Institucion i Arsimit të Lartë, në përputhje me përcaktimet e Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” GVJ vëren se programet e studimit të ofruara nga kjo IAL nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Në qëllimet dhe objektivat dhe misionin e këtij institucioni vërejmë: Krijimi, zhvillimi, përcjellja dhe mbrojtja e dijeve, si dhe përgatitja e qytetarëve paraprakis të së ardhmes, profesionistëve dhe akademikëve të ardhshëm me anë të mësimdhënies, të të nxëniet dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe integritetit në komunitet, si dhe duke siguruar njohuritë, aftësitë, karakterin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen ndërkombëtar. [Evidence 1.1 Statuti i KU IKT 2023 i amenduar] [Evidence 2. “Strategjia e Zhvillimit të KU “IKT” 2024”]
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit në Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” është hapur nga ky institucion në vitin 2011 me emërtimin Bachelor në “Inxhinieri Industriale”, në përputhje me misionet kryesore të institucionit. Këto qëllime dhe misione janë të përcaktuara qartë në statutin e tij dhe në aktet rregullatore të hartuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, që nga hapja e institucionit dhe programit të studimit. Programi është akredituar për herë të parë për një periudhë 6 vjeçare, me Vendim të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) Nr. 38, datë 13.07.2018. Menjëherë pas akreditimit të programit, një muaj më pas, programi me propozim të Njësish Bazë, Fakultetit dhe miratim të Senatit Akademik ka kërkuar ndryshimin e kurrikulës, riorganizim dhe emërtimin e programit nga Bachelor në “Inxhinieri Industriale” në Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni”. Kërkesa është miratuar nga MASR përmes shkresës Nr. 8482/1, datë 31.08.2018. [Evidence 1.1 Statuti i KU IKT 2023 i amenduar] [Evidence 1.2 Vendim për licensimin e KU IKT nr. 781, 10.11.2011] [Evidence 26 Argumentimi i Ndryshimeve”, 2018, dërguar në MAS bashkë me dokumentet e tjera për riorganizimin e programit]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” është hartuar në përputhje me

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë qim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.

Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në këtë fushë.

[Evidence 1.1 Statuti i KU IKT 2023 i amenduar]

[Evidence 26. Argumentimi i Ndryshimeve", 2018, dërguar në MAS bashkë me dokumentet e tjera për riorganizimin e programit]

[Evidence 6. "Rregullore Institucionale e KU IKT"]

Evidence 8. "Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë" (shqip)

Evidence 18.4. "Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit" (shqip)

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IKT, GVJ konstaton se ky institucion ka mbi 13 vjet përvojë në fushën akademike, ka kapacitetet e nevojshme infrastrukturore dhe struktura ndihmëse, si dhe burimet e duhura në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Personeli akademik në programin e studimit është i kualifikuar dhe me përvojë shumëvjeçare në fushat studimore dhe aplikative, brenda dhe jashtë vendit, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

Programi i studimit Bachelor në " Inxhinieri Telekomunikacioni " ofrohet nga Fakulteti i Inxhinierisë, i cili ka në përbërje tre njësi bazë:

- Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit
- Departamenti i Inxhinierisë Softuerike
- Qendra e Kërkimit Shkencor CIRD Inxhinieri

Stafi akademik, bazuar në CV-të e tyre, rezultoi të ketë përvojë dhe të jetë i përshtatshëm për disiplinat specifike të sistemeve të informacionit. Sipas të dhënave të paraqitura në DVV, numri i anëtarëve të stafit akademik është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për disiplinat specifike të këtij programi studimi. Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) i angazhuar në këtë program studimi për vitin akademik 2023-2024 kanë kualifikimet e mëposhtme:

Kualifikimi	PAE	PAK
Prof. Dr.	3	0
Prof. Asoc.	3	1
Dr./PhD	6	1
Dr. në proces	4	0
Msc.	6	0
Total	22	2

Në Departamentin e Inxhinierise Elektronike dhe Telekomunikacioni, i cili është përgjegjës për programin e studimit, (7 staf akademik efektiv dhe 2 staf akademik me kontratë), të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi	PAE	PAK
Prof. Dr.	2	-
Prof. Asoc.		1
Dr./PhD	2	-
Dr. në proces	1	-
Msc.	2	1





	Total	7	2
	Stafi akademik ka kualifikimin e duhur për formimin e njësive bazë si dhe angazhimi i tyre akademik është në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës. <i>Evidence 3. Tabela përmbledhese e korrigjuar</i> <i>Evidence 21. CV e stafit akademik të programit të studimit</i> <i>Evidence 22. CV e stafit akademik të Fakultetit të Inxhinierisë</i>		
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës, GVJ konstaton se njësia kryesore, Fakulteti i Inxhinierisë ku zhvillohet ky program studimi, ka dy njësi bazë dhe një qendër kërkimore që kanë në fokus fushën dhe zhvillimin e këtij program studimi: • Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit • Departamenti i Inxhinierisë Softuerike • Qendra e Kërkimit Shkencor CIRD Inxhinieri GVJ konstaton që nga IAL është realizuar kodifikimi i programeve dhe lëndëve të studimit në përputhje me nenin 86 të ligjit të ligjit nr. (80/2015) “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe direktivat evropiane. <i>Evidence 18.4 “Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit”</i> <i>Evidence 10. “Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni” (shqip)</i>		
Konkluzione	<i>Programi i studimit, Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” ofrohet nga Instituti Kanadez i Teknologjisë në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe aktivitetin e tij.</i> <i>Njësia kryesore ofron programe studimi në fushën e teknologjisë së informacionit që prej vitit 2011 dhe disponon kapacitete në mbështetje të saj, në infrastrukturë dhe burime të nevojshme. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” ofrohet nga njësia bazë “Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit” dhe njësia kryesore “Fakulteti i Inxhinierisë” që kanë të njëjtën fushë akademike me atë të këtij programi studimi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në KU IKT, GVJ konstaton se në funksion të hartimit, monitorimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit ka realizuar ndarjen e detyrave mes njësive bazë dhe kryesore të IAL, të paraqitura dhe në organigramën e përditësuar të vitit 2023 të organizimit të IKT që përcaktohet nga institucioni në aktet rregullore dhe udhëzuese të tij. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit menaxhon dhe drejton me efektivitet

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	programin e ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni " me kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite. Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit. Për të gjithë anëtarët e rinj, Burimet Njerëzore shpërndajnë Manualin e Stafit Akademik (Staff Handbook) i cili shpjegon dhe përcakton qartë detyrat dhe të drejtat e stafit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar u evidentua që disa prej lëndëve të këtij programi studimi mbulohen nga staf akademik i njësisë të tjera bazë të këtij fakulteti dhe në përgjithësi të këtij universiteti, sipas fushës së tyre të ekspertizës. <i>Evidence 1. Organigrama e miratuar prej MAS - Dergohet urdhri per njohje dhe zbatim</i> <i>Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip - pdf</i> <i>Evidence 14. "Manuali i Stafit Akademik (Staff Handbook)" (shqip)</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	GVJ, duke u bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit si dhe në takimin me përfaqësuesit e zyrës përgjegjëse, vlerëson se IKT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi, si me institucione të tjera të arsimit të lartë ashtu edhe me subjekte ekonomike private dhe institucione të tjera shtetërore. Në veçanti, institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë jashtë vendit, me të cilat ka patur apo ka marrëveshje për zhvillimin e programeve të studimit apo lëshimin e diplomave të përbashkëta. Nga takimi me studentët, personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, u konstatua se institucioni ka bashkëpunime me IAL-të vendase dhe të huaja, si dhe me kompani biznesi. Gjithashtu, vihet re një rritje e kërkesës dhe angazhimit në aktivitete ndërkombëtare, siç është Erasmus+. <i>Evidence 24. Marrëveshjet aktive ne kuader te Erasmus+ 2018-2024</i> <i>Evidence 25. Marrëveshjet aktive me Universitetet 2018-2024</i> <i>Evidence 26. Marrëveshjet active me biznesin, sipërmarrjet dhe institucionet e tjera 2018-2024</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Bazuar në DVV dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në IAL, GVJ vëren se IKT ka bashkëpunime ndërinstitucionale me disa institucione shtetërore dhe IAL brenda dhe jashtë vendit, si dhe me kompani dhe komunitetin e biznesit. IKT ka nënshkruar marrëveshje dhe bashkëpunon me shumë institucione, organizata dhe biznese për zhvillimin e praktikave profesionale. Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese për praktikat profesionale janë të ndryshme dhe përfshijnë institucione të tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm për arsimin e lartë. Studentëve u ofrohet mundësia që të zhvillojnë praktikat mësimore pranë këtyre institucioneve përgjatë periudhës së përcaktuar në programin e studimit. Për të siguruar zhvillimin e praktikave profesionale institucioni përdor Zyrën e Shërbimit të Studentëve dhe Karrierës (Students Affair & Career Office), parapërgatit studentët për procesin e praktikave profesionale dhe dhënien e informacionit dhe asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/stazheve/internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë.

	Vlerësimi i studentëve për praktikën profesionale bëhet nga një Komision Vlerësues i cili ngrihet nga Këshilli i Fakultetit. Komisioni përbëhet nga pedagogu që e ka mbikëqyrur studentin gjatë praktikës, përgjegjësi i departamentit, dhe një ose dy pedagogë të tjerë nga Departamenti. Studentët e këtij programi studimi janë të detyruar të zhvillojnë lëndën e "Praktikës" në semestrin e dytë të vitit të tretë akademik. <i>Evidence 24. Marrëveshjet aktive ne kuader te Erasmus+ 2018-2024</i> <i>Evidence 25. Marrëveshjet aktive me Universitetet 2018-2024</i> <i>Evidence 26. Marrëveshjet aktive me biznesin, sipërmarrjet dhe institucionet e tjera 2018-2024</i> <i>Evidence 20.1 Manuali i praktikës Mesimore Bachelor (shqip)</i> <i>Evidence 49. Informimi i studentëve për mundësitë e punësimit dhe praktikat</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Institucioni përdor disa forma komplementare të vlerësimit të përfitimeve të marrëveshjeve, duke i parë ato në këndvështrim të rritjes së cilësisë së bashkëpunimit. Të evidentuara janë aktivitetet më të rëndësishme mblidhen prej njësive baze dhe atyre kryesore dhe publikohen që evidentohen në: • Buletini mujor "IKT Newsletter", që përmbledh aktivitetet e zhvilluara prej fakulteteve dhe departamenteve. • Raportin Vjetor Institucional Vlerësimi i praktikës kryhet nga mbikëqyrësi i praktikës plotëson një formë vlerësimi që përfshin një përshkrim të përgjegjësisë dhe detyrave kryesore të studentit, si dhe një tabelë vlerësimi të cilësive dhe karakteristikave që studenti ka shfaqur gjatë praktikës. Ky vlerësim përbën 70% të notës përfundimtare. <i>Evidence 20.1 Manuali i praktikës Mesimore Bachelor (shqip)</i> <i>Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT për MAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)</i>			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar Instituti Kanadez i Teknologjisë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere dhe aktorë të tregut të punës, duke i analizuar ato periodikisht për të siguruar përfitim të ndërsjellë dhe përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut. Këto marrëveshje përfshijnë:</i> – <i>Partneritete me institucione akademike dhe kërkimore si shkëmbimin e njohurive, organizimin e konferencave të përbashkëta apo mundësi për studime të avancuara dhe projekte kërkimore;</i> – <i>Bashkëpunime me kompani dhe korporata për krijimin e programeve të praktikës profesionale, zhvillimin e projekteve të përbashkëta dhe sigurimin e mundësive të punësimit për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1																							
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.																							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																						
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, dhe me kohë të plotë. Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" përmban 180 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar. Aktiviteti didaktik për këtë program studimi shtrihet në: • Leksione • Seminare • Ushtrime • Laboratorë • Projekte Programi i studimit kërkon një angazhim të studentit dhe institucionit sipas tabelës në vijim: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th><th>Orë në auditor</th><th>Orë studim individual</th><th>Raporti Final</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Viti i parë</td><td>606</td><td>894</td><td>40.4% / 59.6%</td></tr> <tr> <td>Viti i dytë</td><td>610</td><td>886</td><td>40.8% / 59.2%</td></tr> <tr> <td>Viti i tretë</td><td>612</td><td>886</td><td>40.9% / 59.1%</td></tr> <tr> <td>Totali</td><td>1828</td><td>2666</td><td>40.7% / 59.3%</td></tr> </tbody> </table> Vërehet që institucioni përdor një metrikë të njëjtë në vlerësimin e ngarkesës në auditor për kredit për lëndë. <i>Evidence Aneksi nr.1 Tabelat përmbledhese - shqip</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2022-2023</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2023-24</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2021 - 2022</i>			Viti	Orë në auditor	Orë studim individual	Raporti Final	Viti i parë	606	894	40.4% / 59.6%	Viti i dytë	610	886	40.8% / 59.2%	Viti i tretë	612	886	40.9% / 59.1%	Totali	1828	2666	40.7% / 59.3%
Viti	Orë në auditor	Orë studim individual	Raporti Final																				
Viti i parë	606	894	40.4% / 59.6%																				
Viti i dytë	610	886	40.8% / 59.2%																				
Viti i tretë	612	886	40.9% / 59.1%																				
Totali	1828	2666	40.7% / 59.3%																				
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" në IKT synon të formojë profesionistë me aftësi dhe njohuri të avancuara në një gamë të gjerë fushash profesionale. Në përfundim të ciklit të studimeve, studenti duhet të jetë i aftë të përdorë një sërë aftësish, duke përfshirë: - Edukim inxhinierik me ekspertizë të plotë në elektronikë, rrjete dhe telekomunikacion, për t'u mundësuar atyre performancë të mirë në projektimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve përkatëse; - Përditësim të vazhdueshëm të njohurive të fituara, duke ruajtur një komponent të fortë praktik për të ndërthurur dhe forcuar teorinë e mësuar; - Edukim të orientuar sipas parimeve etike, rigorozitetit profesional, kompetencës teknike, shkathtësisë dhe lehtësisë së përshtatjes, duke përfshirë punën në grup në fusha shumëdisiplinore, aftësitë organizative, udhëheqjen dhe sipërmarrjen;																						

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




fushë të specializuar studimi ose profesionale.	- Njohuri mbi metodologjitë për analizimin dhe përmirësimin e proceseve të biznesit, me fokus në optimizim dhe reduktimin e mbetjeve; - Aftësinë për të ushtruar me sukses profesionin e inxhinierit, si punonjës apo përmes vetëpunësimit, dhe përgatitjen e nevojshme për ndjekjen e studimeve pasuniversitare dhe përfitimin e pozicioneve drejtuese. Përveç këtyre, programi ofron një formim në lidhje me sistemet elektronike, përpunimin dhe përhapjen e sinjalit, rrjetet e komunikimit dhe aplikacionet e ndryshme. Gjithashtu praktika profesionale dhe punimi i diplomës, kërkohen të jetë me natyrë aplikative. Programi përfshin gjithashtu lëndë të avancuara si "Antenna and Wave Propagation", "Security Engineering", "Signals and Systems", "Digital Transmission", dhe "Fundamentals of Programming II". Lëndë të tjera, si "Introduction to Economics", "Academic Reading and Writing", "Introduction to Statistics", dhe "E-commerce and Innovation". <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2022-2023</i> <i>Evidence 19.1 Studimi dhe Analiza e Tregut të punës për programin BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni - Nentor 2022</i>																														
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Bazuar në DVV dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi mësimor i ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" përmban një shpërndarje të krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, dhe elementët e mësimdhënies, të cilat janë paraqitur në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Nga shqyrtimi i programit mësimor Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite, duke respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh, me një total prej 180 kreditesh në 3 vite. Sipas VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni" për vitin akademik 2023 – 2024 grupohen si vijon: <table><tr><th>Tipi i veprimtarisë (A-E)</th><th>Lende</th><th>Kredite ECTS</th><th>Përqindje</th><th>Standardi</th></tr><tr><td>A – Lëndë Bazë</td><td>5</td><td>30</td><td>16.7</td><td>15-20%</td></tr><tr><td>B – Lëndë Karakterizuese</td><td>16</td><td>96</td><td>53.3</td><td>50-55%</td></tr><tr><td>C- Lëndë ndërdisiplinore / Integruese</td><td>5</td><td>30</td><td>16.6</td><td>12-15%</td></tr><tr><td>D – Lëndë plotësuese</td><td>3</td><td>18</td><td>10</td><td>10-15%</td></tr><tr><td>E – Detyrime përmbyllëse</td><td>1</td><td>6</td><td>3.3</td><td>3-5%</td></tr></table> – GVJ në lidhje me këtë element të programit të studimit jep konsideratat si vijon: Ndarja e lëndëve sipas kategorive A, B, C, D dhe E është pjesërisht në përputhje me standartet e kërkuara për secilën disipline me <u>shmangie nga standardi për lëndët e kategorisë C.</u> Vihet re që plotësohet kushti i shumës të paktën 70% të krediteve për komponentët mësimorë A dhe B. Secila lëndë në syllabusin e saj ka të përcaktuar titullarin dhe pedagogun e lëndës, objektivat formuese, ngarkesën e parashikuar për studentët në total	Tipi i veprimtarisë (A-E)	Lende	Kredite ECTS	Përqindje	Standardi	A – Lëndë Bazë	5	30	16.7	15-20%	B – Lëndë Karakterizuese	16	96	53.3	50-55%	C- Lëndë ndërdisiplinore / Integruese	5	30	16.6	12-15%	D – Lëndë plotësuese	3	18	10	10-15%	E – Detyrime përmbyllëse	1	6	3.3	3-5%
Tipi i veprimtarisë (A-E)	Lende	Kredite ECTS	Përqindje	Standardi																											
A – Lëndë Bazë	5	30	16.7	15-20%																											
B – Lëndë Karakterizuese	16	96	53.3	50-55%																											
C- Lëndë ndërdisiplinore / Integruese	5	30	16.6	12-15%																											
D – Lëndë plotësuese	3	18	10	10-15%																											
E – Detyrime përmbyllëse	1	6	3.3	3-5%																											




kreditesh dhe orët në auditor, duke i ndarë ato në aktivitete didaktike formuese leksione, seminare, ushtrime, laboratore, projekte.

Në formatin e syllabusit, paraqitet edhe mënyra e vlerësimit të dijeve dhe notave përkatëse. Më konkretisht vlerësimi i njohurive shprehet me pikë në përqindje, vlerësimi me shkronja (A+-F) dhe me nota me bazë 4. Si në tabelën në vijim:

Përqindja	Nota e Shprehur në Shkronjë	Pikëzimi	Notat nga 0-10
90-100	A+	4.0	10
85-89	A	3.7	9
80-84	A-	3.5	8
75-79	B+	3.3	
70-74	B	3.0	7
65-69	B-	2.7	
60-64	C+	2.5	6
55-59	C	2.0	
53-54	D+	1.5	5
50-52	D	1.0	
0-49	F	0.0	4
	FNA	0.0	0

Sugjerohet: VKM nr. 41, datë 24.1.2018, përcakton se elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë duhet të përmbajnë lëndë ndërdisiplinore / integruese me një përqindje prej 12-15% të totalit të krediteve ECTS. Përqindja prej 16.6% e krediteve ECTS të alokuara për lëndët Ndërdisiplinore / Integruese tejkalon kufirin e sipërm prej 15% të përcaktuar në këtë VKM. GVJ sugjeron që duhet të rishikohet shpërndarja e krediteve në këtë kategori për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore.

Evidence Aneksi nr. 1 Tabelat permbledhese - shqip - pdf

Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne hxxh. Telekom. 2022-2023

Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022

Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023

Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024

Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.

Plani mësimor parashikon në total 29 lëndë mësimore si dhe projekt diplomën, për një total prej 30 lëndë/module didaktike të ndara në veprimtari formuese në kategoritë A-E sipas VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar.

Në detyrimet e lëndëve plotësuese, institucioni ka parashikuar edhe zhvillimin e praktikës profesionale me 6 kredite ECTS, praktikë e cila zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të tretë.

Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024

20. Programet e lendeve 2022-2023

20. Programet e lendeve 2021-2022




	Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2022-2023																																			
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nuk aplikohet																																			
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” i ofruar nga KU IKT parashikon një aktivitet didaktik në auditor dhe jashtë tij, si në tabelën në vijim: <table><tr><th>Viti</th><th>Orë në auditor</th><th>Orë studim individual</th><th>Raporti Final</th></tr><tr><td>Viti i parë</td><td>606</td><td>894</td><td>40.4% / 59.6%</td></tr><tr><td>Viti i dytë</td><td>610</td><td>886</td><td>40.8% / 59.2%</td></tr><tr><td>Viti i tretë</td><td>612</td><td>886</td><td>40.9% / 59.1%</td></tr><tr><td>Totali</td><td>1828</td><td>2666</td><td>40.7% / 59.3%</td></tr></table> Referuar programeve të studimit të ngjashëm, të ofruar nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda vendit, kanë një përafërsi në organizimin e planit mësimor IALLeksione + SeminareLaborator + Praktikë RaportiUET Inxhinieri Informatike” me profil: “Inxhinieri Telekomunikacioni 131229981.14%/18.56%UPT Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni 1899302.586.26%/13.74%KU IKT Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni 142837279.33%/20.67% <table><tr><th>IAL</th><th>Orë në auditor</th><th>Orë studim individual</th><th>Totali</th><th>Raport përqindje</th></tr><tr><td>Universiteti Politeknik i Tiranës</td><td>2275.5</td><td>2224.5</td><td>4500</td><td>50.57% / 49.3</td></tr><tr><td>Kolegji Universitar Instituti Kanadez i Teknologjisë</td><td>1828</td><td>2666</td><td>4494</td><td>40.7% / 59.3 %</td></tr></table> Të dhënat për planet mësimore të institucionit të përmendur në tabelën më sipër i referohen raporteve për program studimit që janë të publikuar në faqen zyrtare të ASCAL këtu. Ngarkesë është në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018 e ndryshuar, e cila specifikon numrin e orëve në auditor jo më shumë se 50%, por nuk vendos limit të poshtëm. Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2022-2023	Viti	Orë në auditor	Orë studim individual	Raporti Final	Viti i parë	606	894	40.4% / 59.6%	Viti i dytë	610	886	40.8% / 59.2%	Viti i tretë	612	886	40.9% / 59.1%	Totali	1828	2666	40.7% / 59.3%	IAL	Orë në auditor	Orë studim individual	Totali	Raport përqindje	Universiteti Politeknik i Tiranës	2275.5	2224.5	4500	50.57% / 49.3	Kolegji Universitar Instituti Kanadez i Teknologjisë	1828	2666	4494	40.7% / 59.3 %
Viti	Orë në auditor	Orë studim individual	Raporti Final																																	
Viti i parë	606	894	40.4% / 59.6%																																	
Viti i dytë	610	886	40.8% / 59.2%																																	
Viti i tretë	612	886	40.9% / 59.1%																																	
Totali	1828	2666	40.7% / 59.3%																																	
IAL	Orë në auditor	Orë studim individual	Totali	Raport përqindje																																
Universiteti Politeknik i Tiranës	2275.5	2224.5	4500	50.57% / 49.3																																
Kolegji Universitar Instituti Kanadez i Teknologjisë	1828	2666	4494	40.7% / 59.3 %																																
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej	Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, mbështetur në klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas VKM 310, datë 11.05.2022, “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” kodifikimi i këtij programi studimi është përcaktuar nga KU IKT me kodin: 63BA 0714A.																																			

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-13423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@asc.al




kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Më tej institucioni kryen kodifikimi e lëndëve të programit. Kodifikimi i lëndëve të programit bëhet në bazë të Kodifikimit të përdorur në Amerikën e Veriut dhe Kanada, dhe sipas Rregullores për Kodifikimin e Lëndëve të KU IKT. <i>Evidence 23. Rregullorja per Kodifikimin e Lendëve</i> <i>Evidence RVB e Bachelor ne Inxhinieri Telekomunikacioni - (shqip-word-pdf)</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk Aplikohet Fakulteti i Inxhinierisë në KU IKT nuk ofron programe të përbashkëta me institucione të tjera.			
Konkluzione	- Lëndët në tërësi, plani mësimor dhe organizimi i tij, janë në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimesh. - Ky program studimi është organizuar nga Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. - Ky program studimi ka të përcaktuar në planin mësimor ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse dhe është i ngjashëm me programet e studimit në të njëjtën fushë mbi masën 70 %. - Ky program studimi shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të kërkuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. - GVJ konstaton <u>shmangie nga standardi për lëndët e kategorisë C dhe sugjeron IAL të ndajë lëndët sipas kategorive A, B, C, D dhe E, në përputhje me standartet e kërkuara për secilën discipline VKM nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të ndryshuar.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2				
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Inxhinierisë ku zhvillohet ky program studimi, ka dy njësi bazë dhe një qendër kërkimore që kanë në fokus fushën dhe zhvillimin e këtij program studimi: 1. Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit 2. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike 3. Qendra e Kërkimit Shkencor CIRD Inxhinieri Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” për vitin akademik 2023-2024, ka gjithsej 24 pedagogë, nga të cilët 22 janë pedagogë efektivë (PAE) dhe 2 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:			
	Tituj/ Grada	2023-2024	2022-2023	2021-2022

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Lektorë me titullin Prof. Dr	3	0	1	0	1	0	
Lektorë me titullin Prof. të Assoc.	3	1	3	0	3	0	
Lektorë me gradën Dr/Phd	6	0	7	1	10	0	
Asistentë me Msc (ne proces Dr)	4	1	4	0	1	0	
Asistentë me Msc	6	0	6	0	5	0	
Totali	22	2	21	1	20	0	

Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni", përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas tre viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Kualifikimi	PAE	PAK
Prof. Dr.	2	
Prof. Assoc.		1
Dr./PhD	2	
Dr. në proces	1	
Msc.	2	1
Total	7	2

Njësia bazë, përmbush kriteret minimale të parashikuara në ligjin 80/2015 për numrin dhe kualifikimin minimal të stafit efektiv për krijimin dhe ekzistencën e njësive bazë.

Evidence Organigrama e miratuar prej MAS - Dergohet urdhri për njohje dhe zbatim
Evidence 1. Statuti i KU IKT 2016 shqip
Evidence 1.1 Statuti i KU IKT 2023 i amenduar
Evidence 1.6 Praktika për riorganizimin e programit dhe shkresa e pranimit nga MAS Nr.8482-1 dt 31.08.2018 (riorganizimi i programit, praktika)
Evidence 21. CV e stafit akademik të programit të studimit
Evidence 22. CV e stafit akademik të Fakultetit të Inxhinierisë
Evidence Aneksi nr.1 Tabelat përmbledhese - shqip

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike klinike, etj.	KU IKT angazhon staf ndihmës akademik për të siguruar zhvillimin efektiv të aktiviteteve laboratorike dhe praktike në tërësi. Gjithashtu, në ndihmë të studentëve janë edhe një sërë zyrash, biblioteka dhe personel administrativ si për orientimin e studentëve, informacione të ndryshme. IKT ka angazhuar 2 (dy) staf ndihmës akademik përgjegjës për laboratorin të cilët kontribuojnë në mirëmbajtjen dhe ndihmojnë stafin akademik gjatë zhvillimit të seancave laboratorike. Përveç stafit ndihmës akademik, për mirëmbajtjen e laboratorëve angazhohet edhe Zyra e IT, ashtu dhe stafi akademik me eksperiencë. <i>Evidence Aneksi nr.1 Tabelat përmbledhese - shqip</i>
--	--




Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Përgjegjës për programin e studimit është drejtuesi i njësive bazë, i cili është edhe pikë referuese e studentëve në tërësi, mbas pedagogëve të lëndëve respektive. Bazuar në rregulloren e departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit, Neni 5 cilësohet që ndër kompetencat e përgjegjës të departamentit janë: - Të kujdeset për përmbajtjen e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë dhe të programeve të lëndëve që menaxhon; - Të hartojë përmbajtjen e formularit për zgjedhjen e lëndëve nga studentët - Të përgjigjet për ecurinë e provimeve gjatë sezonit dhe për mbarëvajtjen e tyre; - Të kërkojë rishikime dhe përmirësime të programeve të studimit, të kurrikulave në bazë të nevojave dhe treguesve akademikë. GVJ vlerëson edhe rolin e Këshilltarit akademik i cili në bazë të Rregullores së Tutoriatit dhe Këshillimit Akademik, çdo javë përcakton një orar për takime me çdo student ka në kujdestarinë e tij. IAL cakton cdo vit këshilluesit akademikë për cdo grup studentësh. <i>Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip)</i> <i>Evidence shtese 11.Vendimi Keshillit te Fakultetit per miratimin e tutoriatit studentor per keshillimin akademik</i> <i>Evidence 9. "Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit" (shqip)</i>			
Konkluzione	- GVJ evidenton se kriteret minimale të këtij standarti përmbushen për njësine kryesore dhe bazë përgjegjëse për numrin dhe shkallën e kualifikimit (titujt) të personelit akademik që mbulon programin e studimit. - Ngarkesa mësimore realizohet në masën më të madhe nga personeli akademik efektiv duke respektuar detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi. - Njësia bazë, ka caktuar për cdo grup studentësh një këshillues akademik i cili në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit janë përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit. - Njësia kryesore, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacioni në veçanti, përmbushin kriteret organizative në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e ciklit të parë, Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni", Departamenti i Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit, disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: rregulloren, programin mësimor dhe syllabuset e lëndëve ku paraqitet informacion i hollësishëm mbi detyrimin e frekuentimit / ndjekjes së programit, mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj.


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




	Të dhëna që janë edhe në nivel të njësisë kryesore, ku mund të përmendim: Të dhëna të përgjithshme mbi programin, objektivat formuese, synimet, kriteret përzgjedhëse, regjistrimet, transferimet, tarifat, metodat e mësimdhënies etj. - rregullorja e programit, - plani mësimor; - syllabuset e lëndëve si dhe ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese shqip dhe anglisht, - CV e personelit akademik. Dokumentacioni i sipërcituar ruhet, arkivohet dhe menaxhohet sipas rregullave të brendshme institucionale. <i>Evidence 10. "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2022-2023</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2023-24</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2021 - 2022</i> <i>Evidence Aneksi nr. 1 Tabelat permbledhese - shqip - pdf</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024</i> <i>Evidence 21. CV e stafit akademik të programit të studimit</i>																													
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" është i strukturuar në 3 vite akademike të organizuara në 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 28 lëndë të ndara sipas 3 viteve: - 10 lëndë në vitin e parë; - 10 lëndë në vitin e dytë; - 8 lëndë në vitin e tretë; Në vitin e tretë është parashikuar edhe Praktika Profesionale me 6 kredite ECTS dhe Diploma me 6 kredite ECTS. Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni", rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh në 3 vjet në total 180 kredite. Shpërndarja e orëve në auditor dhe jashtë auditorit për të tre vitet akademike, është si më poshtë vijon: <table><tr><th>Year</th><th>Semester</th><th>Orët në auditor</th><th>Orët jashtë auditorit</th></tr><tr><td rowspan="2">1st Year</td><td>1st Semester</td><td>302</td><td>448</td></tr><tr><td>2nd Semester</td><td>304</td><td>446</td></tr><tr><td rowspan="2">2nd Year</td><td>1st Semester</td><td>306</td><td>444</td></tr><tr><td>2nd Semester</td><td>308</td><td>442</td></tr><tr><td rowspan="2">3rd Year</td><td>1st Semester</td><td>310</td><td>440</td></tr><tr><td>2nd Semester</td><td>304</td><td>446</td></tr><tr><td colspan="2">Total</td><td>1834</td><td>2666</td></tr></table> Sipas Ligjit Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Shqipëri, ndarja e orëve mësimore dhe ngarkesa e lëndëve duhet të jetë e përcaktuar qartë në planin mësimor të programeve të studimit. Ky ligj kërkon	Year	Semester	Orët në auditor	Orët jashtë auditorit	1 st Year	1 st Semester	302	448	2 nd Semester	304	446	2 nd Year	1 st Semester	306	444	2 nd Semester	308	442	3 rd Year	1 st Semester	310	440	2 nd Semester	304	446	Total		1834	2666
Year	Semester	Orët në auditor	Orët jashtë auditorit																											
1 st Year	1 st Semester	302	448																											
	2 nd Semester	304	446																											
2 nd Year	1 st Semester	306	444																											
	2 nd Semester	308	442																											
3 rd Year	1 st Semester	310	440																											
	2 nd Semester	304	446																											
Total		1834	2666																											




që programet e studimit të përfshijnë informacion mbi ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, dhe ndarjen e orëve në auditor dhe jashtë auditorit për të siguruar një edukim cilësor dhe të strukturuar për studentët.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" rezulton se:

- Viti i parë: 302 orë në auditor, 448 orë jashtë auditorit (semestri 1); 304 orë në auditor, 446 orë jashtë auditorit (semestri 2).
- Viti i dytë: 306 orë në auditor, 444 orë jashtë auditorit (semestri 1); 308 orë në auditor, 442 orë jashtë auditorit (semestri 2).
- Viti i tretë: 310 orë në auditor, 440 orë jashtë auditorit (semestri 1); 304 orë në auditor, 446 orë jashtë auditorit (semestri 2).

Format e mësimdhënies	Programi i Studimit
Orët totale në auditor	1828
Leksione	876
Seminare	272
Ushtrime	280
Laboratorë	252
Projekte	28
Praktikë profesionale	120

IAL ka parashikuar në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve numrin total të krediteve ECTS dhe ndarjen e tyre në aktivitete formuese si Leksione, Ushtrime/Seminare, Laboratorë, detyra/Projekte kursi, praktika, etj. si dhe orët në total për çdo lëndë në auditor/ jashtë auditorit. GVJ konstaton një mospërputhje midis tabelës 10 dhe tabelës 13 ku numri i orëve nuk përkon. Në tabelën 10 janë gjithsej 1834 orë në auditor, ndërsa në tabelën 13 janë 1828 orë në auditor.

Evidence 16. Planii mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2022-2023

Evidence 16. Planii mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2023-24

Evidence 16. Planii mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2021 - 2022

Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip

Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022

Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023

Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015.

KU IKT pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga IAL të tjera, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkollat të tjera të larta, sipas procedurave të parashikuara në këtë rregulloren e fakultetit (neni 33).

- Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit të Kurrikulave: Përgjegjësi i Departamentit përkatës ngre një komision ad hoc për të shqyrtuar dosjen e studentit dhe programet e lëndëve të zhvilluara. Ky komision përcakton lëndët që njihen nga KU IKT dhe ato që duhet të ndiqen plotësisht.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	– Vendimi për Pranimin: Vendimi për pranimin e studentëve që kanë kërkuar transferimin merret nga Rektori, mbështetur në propozimin e Dekanit dhe vendimin e Komisionit të Njohjes dhe Ekuivalentimit. Studentët e pranuar lidhin kontratën përkatëse me IKT-në, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e palëve. Sipas rregullores së fakultetit neni 43 ekuivalentimi i studimeve kryhet nga Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit, i cili shqyrton dosjen e studentit dhe përcakton numrin e krediteve që njihen dhe ato që duhet të plotësohen nga studenti për të përmbushur kërkesat e programit të IKT-së. – Komisioni shqyrton programet e lëndëve të zhvilluara dhe përcakton ekuivalentimin e tyre sipas standardeve të IKT-së. Kjo përfshin përcaktimin e lëndëve që njihen plotësisht dhe ato që kërkojnë plotësimin e mëtejshëm të krediteve. Pas rishikimit dhe vendosjes së ekuivalentimit, komisioni paraqet vendimin për miratim te Dekani dhe Rektori. Studentët informohen për vendimin dhe procedurat e mëtejshme për të vazhduar studimet e tyre në KU IKT. <i>Evidence 8. "Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë" (shqip)</i> <i>Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i> <i>Evidence 16. Nje procedure ekuivalence - Vendim Komisioni i njohjeve te krediteve</i> <i>Evidence 18. Kriteret e Pranimin të studentëve 2023 – 2024</i> <i>Evidence 54. Kontrate tip student – Bachelor</i> <i>Evidence 8. "Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë" (shqip)</i>																
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Plani Mësimor i programit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" ofron informacion të detajuar mbi kategoritë e lëndëve, shpërndarjen e tyre në vite dhe semestra, kreditet, orët mësimore brenda dhe jashtë klase, detyrimet akademike dhe ngarkesën lëndore. Ai përfshin gjithashtu llojin e orëve mësimore, kohën e zhvillimit të praktikës mësimore, dhe detyrimet përfundimtare të studentit, duke përfshirë temën e diplomës. Bazuar në Planin Mësimor ngarkesa totale për 180 ECTS është 1828 orë totale në auditor nga ku: <table border="1" data-bbox="762 1339 1340 1646"> <thead> <tr> <th>Format e mësimdhënies</th><th>Programi i Studimit</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Orët totale në auditor</td><td>1828</td></tr> <tr> <td>Leksione</td><td>876</td></tr> <tr> <td>Seminare</td><td>272</td></tr> <tr> <td>Ushtrime</td><td>280</td></tr> <tr> <td>Laboratorë</td><td>252</td></tr> <tr> <td>Projekte</td><td>28</td></tr> <tr> <td>Praktikë profesionale</td><td>120</td></tr> </tbody> </table> Programet e lëndëve përmbajnë numrin e orëve, kreditet, literaturën, përshkrimin e lëndës, objektivat, shpërndarjen e njohurive në javë, literaturën kryesore dhe ndihmëse, frekuentimin, vlerësimin dhe komponentët e vlerësimit. Çdo program lënde përfshin të dhënat e titullarit, pedagogut të lëndës, ngarkesën, tipologjinë dhe llojin e lëndës, kodin dhe adresën elektronike të pedagogut, përshkrimin e lëndës me konceptet themelore, temat, literaturën dhe format e kontrollit, si dhe rregulloren për frekuentimin	Format e mësimdhënies	Programi i Studimit	Orët totale në auditor	1828	Leksione	876	Seminare	272	Ushtrime	280	Laboratorë	252	Projekte	28	Praktikë profesionale	120
Format e mësimdhënies	Programi i Studimit																
Orët totale në auditor	1828																
Leksione	876																
Seminare	272																
Ushtrime	280																
Laboratorë	252																
Projekte	28																
Praktikë profesionale	120																




	e kursit. GVJ <u>sugjeron</u> që në syllabuset e lëndëve të përcaktohen temat e detyrave/ projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike. GVJ është i mendimit që programi përmban elementët e kërkuar nga VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2022-2023</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2023-24</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2021 - 2022</i> <i>Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të përcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në përmbajtjen e programit të studimit, në fillim të çdo viti akademik. Neni 18 i Rregullores të Fakultetit të Inxhinierisë specifikon funksionet dhe kompetencat e Përgjegjës të Qendrës Kërkimore Shkencore, duke përfshirë rishikimet dhe përmirësimet e programeve të studimit dhe kurrikulave bazuar në nevojat dhe treguesit akademikë. Sipas nenit 5 të Rregullores së Departamentit, përgjegjësi i departamentit përkatës gjithashtu ka detyrën për rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit dhe kurrikulave bazuar në këto nevoja dhe tregues akademikë. Programi është akredituar për herë të parë, për një periudhë 6 vjeçare, me Vendim të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) Nr. 38, datë 13.07.2018. Menjëherë pas akreditimit të programit, një muaj më pas, programi me propozim të Njësisë Bazë, Fakultetit dhe miratim të Senatit Akademik ka kërkuar ndryshimin e kurrikulës, riorganizim dhe emërtimin e programit nga Bachelor në “Inxhinieri Industriale” në Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni”. Kërkesa është miratuar nga MASR përmes shkresës Nr. 8482/1, datë 31.08.2018. Këto ndryshime, brenda normës 20%, janë miratuar nga Senati Akademik dhe janë njoftuar MAS. Ndryshimet hynë në fuqi për atë vit akademik, duke nisur me vitin e parë të programit. Institucioni, bazuar edhe në kërkesat dhe studimet e tregut të punës, vlerëson në mënyrë periodike ndryshimet e nevojshme në planin mësimor dhe përmbajtjen e lëndëve. Kjo është saktësuar edhe në planin strategjik të zhvillimit të institucionit në tërësi, dhe të këtij programi studimi në veçanti. Gjithashtu procesi i përmirësimit të programit ka ardhur edhe prej vlerësimit që bëjnë studentët përmes pyetësorëve të zhvilluar në fund të çdo semestri prej NJSBC. Ky vlerësim më së tepërmi është substancial dhe i referohet ecurisë së programit brenda institucionit, kështu që dhe përmirësimi fokusohet e vërehet më shumë në përmirësimin e literaturës, cilësisë së mësimdhënies, ndërveprimit pedagog-student, metodat dhe teknikat e vlerësimit, angazhimin e stafit në këshillim.




	<i>Evidence 1. Argumentimi i ndryshimeve 2018 derguar ne MAS bashke me dokumentet e tjera per riorganizimin e programit</i> <i>Evidence 2. "Strategjia e Zhvillimit të KU "IKT" 2024" - (CIT Growth Strategy 2024), miratuar me vendim Senati Akademik nr. 11, datë 08.05.2017</i> <i>Evidence 2.1 Strategjia e Zhvillimit të KU "IKT" e përditësuar 2020-2025</i> <i>Evidence 8. "Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë" (shqip)</i> <i>Evidence 9. "Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit" (shqip)</i> <i>Evidence 29.1 Model pyetësori per programin BSc ne Inxhinieri Telekomunikacioni - Model Pyetësori i NJSBC</i> <i>Evidence 29.8 Pyetësor mbi kënaqësinë e studentëve në CIT - 2023</i>			
Konkluzione	- Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. - Programi i studimit dhe dokumentacioni përbërës si plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit dhe ajo e praktikës mësimore, janë të detajuara dhe përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët si gjatë kohës së studimeve pranë institucionit, ashtu edhe në rast kërkesë për transferime. - GVJ <u>sugjeron</u> që në syllabuset e lëndëve të përcaktohen edhe temat e detyrave/ projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" janë të fokusuar në fushën e telekomunikacionit, sistemeve të përpunimit dhe transmetimit të sinjalit, dhe sigurisë së rrjetit. Programi siguron shpërndarjen logjike të lëndëve në semestra dhe vite akademik, duke trajtuar argumentet dhe përçar njohuritë në përputhje me objektivat e tij. Ky program aftëson studentët për punësim në fushën e telekomunikacionit dhe për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë në këtë fushë. <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2022-2023</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2023-24</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2021 - 2022</i> <i>Evidence Aneksi nr. I Tabelat permbledhese - shqip</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




	<i>Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024</i>																																													
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimit profesional. Referuar planit mësimor të paraqitur në tabelat përmbledhëse të RVB-së, institucioni ka paraqitur të ndara në orë mësimore në auditor për secilin prej aktiviteteve didaktike si Leksione, Seminare dhe Laboratorë, konform specifikave të secilës lëndë. <table><tr><th>Format e mësimdhënies</th><th>Programi i Studimit</th></tr><tr><td>Orët totale në auditor</td><td>1828</td></tr><tr><td>Leksione</td><td>876</td></tr><tr><td>Seminare</td><td>272</td></tr><tr><td>Ushtrime</td><td>280</td></tr><tr><td>Laboratorë</td><td>252</td></tr><tr><td>Projekte</td><td>28</td></tr><tr><td>Praktikë profesionale</td><td>120</td></tr></table> Programi gjithashtu respekton totalin vjetor prej 60 kreditesh në 3 vjet në total 180 kredite. Shpërndarja e oreve në auditor dhe jashtë auditorit për të tre vitet akademike, është si më poshtë vijon: <table><tr><th>Year</th><th>Semester</th><th>Orët në auditor</th><th>Orët jashtë auditorit</th></tr><tr><td rowspan="2">1st Year</td><td>1st Semester</td><td>302</td><td>448</td></tr><tr><td>2nd Semester</td><td>304</td><td>446</td></tr><tr><td rowspan="2">2nd Year</td><td>1st Semester</td><td>306</td><td>444</td></tr><tr><td>2nd Semester</td><td>308</td><td>442</td></tr><tr><td rowspan="2">3rd Year</td><td>1st Semester</td><td>310</td><td>440</td></tr><tr><td>2nd Semester</td><td>304</td><td>446</td></tr><tr><td colspan="2">Total</td><td>1834</td><td>2666</td></tr></table> Bazuar në DVV dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi mësimor i ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" përmban një shpërndarje të krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, dhe elementët e mësimdhënies, të cilat janë paraqitur në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. <i>Evidence 16. Planit mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2022-2023</i> <i>Evidence 16. Planit mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2023-24</i> <i>Evidence 16. Planit mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2021 - 2022</i> <i>Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024</i>	Format e mësimdhënies	Programi i Studimit	Orët totale në auditor	1828	Leksione	876	Seminare	272	Ushtrime	280	Laboratorë	252	Projekte	28	Praktikë profesionale	120	Year	Semester	Orët në auditor	Orët jashtë auditorit	1 st Year	1 st Semester	302	448	2 nd Semester	304	446	2 nd Year	1 st Semester	306	444	2 nd Semester	308	442	3 rd Year	1 st Semester	310	440	2 nd Semester	304	446	Total		1834	2666
Format e mësimdhënies	Programi i Studimit																																													
Orët totale në auditor	1828																																													
Leksione	876																																													
Seminare	272																																													
Ushtrime	280																																													
Laboratorë	252																																													
Projekte	28																																													
Praktikë profesionale	120																																													
Year	Semester	Orët në auditor	Orët jashtë auditorit																																											
1 st Year	1 st Semester	302	448																																											
	2 nd Semester	304	446																																											
2 nd Year	1 st Semester	306	444																																											
	2 nd Semester	308	442																																											
3 rd Year	1 st Semester	310	440																																											
	2 nd Semester	304	446																																											
Total		1834	2666																																											
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të	Programet e studimit në Institutit Kanadez të Teknologjise janë të hartuara duke iu përshtatur kërkesave të Kartës së Bolonjës, të cilat mundësojnë transferimin e krediteve dhe nxisin mobilitetin e studententëve tek IAL partnere brenda dhe jashtë vendit. Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri																																													


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43 423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Telekomunikacioni” është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e KU-IKT. Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa e shprehur në kredite, si dhe raporti i teorisë dhe praktikës janë në përputhje me profilin e programit Bachelor “Inxhinieri Telekomunikacioni” dhe të përafëruara me programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare. KU IKT ka rreth 20 marrëveshje mobilitetesh të nënshkruara me universiteteve të ndryshme perëndimore, si dhe është pjesë e CEEPUS prej vitit 2016-2017. Studentë të Fakultetit të Inxhinierisë kanë pasur mundësinë që të përfitojnë prej mobiliteteve të ndryshme si psh: CEEPUS apo Erasmus+. Mobilitetet CEEPUS – Total Studentë të ardhur 12 – Total pedagogë që shkojnë 24 – Total Studentë që shkojnë 37 – Totali Mobiliteteve staf+stud. 61 Mobilitetet Erasmus+ – Total staf që shkojnë 81 – Total studentë që shkojnë 75 – Totali Mobiliteteve staf+stud. 15 <i>Evidence 1. Statuti i KU IKT 2016 shqip</i> <i>Evidence 6. “Rregullore Institucionale e KU IKT” (shqip)</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2022-2023</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2023-24</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2021 - 2022</i> <i>Evidence 14. Mobilitetet CEEPUS 2016</i> <i>Evidence 24. Marrëveshjet aktive në kuadër të Erasmus+ 2018-2024</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni”. Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, rezultojnë se nga 22 studentë të diplomuar që kanë përfunduar studimet në këtë program, 10 prej tyre janë punësuar menjëherë pas përfundimit të studimeve, ndërsa të tjerët janë punësuar më vonë. Nga 22 të diplomuar, 13 janë të punësuar në profesion dhe për 9 prej tyre nuk ka informacion. Sa i përket mobilitetit, bazuar në tabelën 21 të siguruar nga institucioni, 4 studentë të fakultetit kanë lëvizur në kuadër të mobilitetit në institucione ndërkombëtare. Megjithatë, asnjë nga këta studentë nuk i përket programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni”. <i>Evidence 19.2 Raport për punësimin e studenteve ALUMNI 2017-2022 - Gjurmimi i studenteve ALUMNI prej institucionit</i>




	<i>Evidence Aneksi nr. 1 Tabelat permbledhese - shqip Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesit e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit, GVJ evidentoi praktikën e punës në IAL, ku në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit dhediskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” është hapur që në vitin 2011 me emërtimin Bachelor në Inxhinieri Industriale dhe në vitin 2018 është riorganizuar me emërtimin Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” bazuar në një analizë të thelluar të tregut të punës. Rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve prek edhe përditësimin e literaturës, veçanërisht literaturës elektronike që aksesohet prej stafit akademik të KU “IKT”, në bashkëpunim me McGraw-Hill Education, një nga tre botuesit akademikë më të njohur botërorë. Literatura përfshin botimet më të fundit dhe përdor tekstet më të mira akademike për mësimdhënien, me të cilat punojnë dhe institucione akademike prestigjioze në botë. Çdo student që ndjek studimet në një nga programet e institucionit përfiton akses në bibliotekën virtuale të McGraw-Hill Education dhe platformën O'Reilly. Për një gamë më të gjerë literature në anglisht, studentët mund të aksesojnë platformën O'Reilly në bibliotekë. <i>Evidence 72. Marrëveshje CIT- McGrawHill Education</i> <i>Evidence 80. Marrëveshja CIT- TEXO per O'Reilly</i> <i>Evidence 19.1 Studimi dhe Analiza e Tregut te punes per programin BSc ne Inxhinieri Telekomunikacioni - Nentor 2022</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese që garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi në nivel Bachelor. Lëndët që ofrojnë aftësi teknike kërkuara për profesionistët në këtë fushë janë: <i>Bazat e Telekomunikacionit, Sistemet e Komunikimit Wireless, Antenat dhe Përhapja e Valëve, Programimi i Orientuar nga Objektet me Java etj.</i> Këto lëndë janë dizajnuar për të siguruar që studentët të zhvillojnë aftësi të avancuara teknike dhe të jenë të përgatitur për sfidat profesionale të fushës së telekomunikacionit. <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2022-2023</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2023-24</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2021 - 2022</i> <i>Evidence 19.1 Studimi dhe Analiza e Tregut te punes per programin BSc ne Inxhinieri Telekomunikacioni - Nentor 2022</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” nuk ofron një program studimi master në të njëjtin




punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	drejtim/fushë. Gjatë takimit me drejtuesit e institucionit, GVJ mësoi që aplikimet për hapjen e programit master janë bërë nga IAL, por nuk janë miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Megjithatë, IAL ofron për studentët e këtij programi studimi, programe të ciklit të dytë në fusha të tjera të ngjashme të inxhinierisë dhe teknologjisë, si më poshtë: - Inxhinieri Softuerike (Software Engineering) - Dizajn Multimedial (Multimedia Design) /Profile në Inxhinieri Kompjuterike dhe IT (Profile of Computer Engineering & IT) - Rrjetat dhe Siguria Kibernetike (Network & Cyber Security)/ Profile në Inxhinieri Kompjuterike dhe IT (Profile of Computer Engineering & IT) - Inxhinieri Kompjuterike dhe Big Data (Computer Engineering & Big Data) Programi i studimit ka një shkallë të lartë tëpunësimit të të diplomuarve të studentëve në fushat e teknologjisë së informacionit në kompani si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Edhe nga studimi që ka bërë institucioni, rezulton një pritshmëri e lartë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi. https://cit.edu.al/department-of-software-engineering-english Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2022-2023 Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2023-24 Evidence 16. Plani mesimor i programit te studimit Bsc ne Inxh. Telekom. 2021 - 2022 Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip Evidence 19.1 Studimi dhe Analiza e Tregut te punes per programin BSc ne Inxhinieri Telekomunikacioni - Nentor 2022			
Konkluzione	- Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, në përputhje me nivelin 6 të KSHK-së, rezultateve të të nxëniet, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës në fushën e programit të studimit. - Programi i studimi është riorganizuar në vitin 2018 bazuar në një studim të tregut duke ndryshuar edhe emërtimin nga Bachelor në "Inxhinieri Industriale" në Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni". - Programi i studimit është i ngjashëm me atë të ofruar nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit për këtë profil - Ndarja e aktiviteteve formuese brenda lëndës mundëson përvetësimin e njohurive si teorike ashtu edhe praktike në përputhje me provimin Bachelor të këtij program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Fakulteti i Inxhinierisë, ka një marrëdhënie të konsoliduar bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës, në bashkëpunim me të cilët organizon edhe praktikant mësimore të parashikuara në programin e studimit. Ndër veçoritë e vlerësimit të bashkëpunimit me aktorët e tregut, institucioni vlerëson edhe nevojat e tij për të mundësuar përshtatjen e programeve të studimit. Gjithashtu, institucioni mban kontakte të vazhdueshme me ish studentët e diplomuar, jo vetëm në këtë program studimi. Në këtë kontekst është edhe roli i Zyrës për Çështjet Studentore dhe Karrierës, ku informacionet e mbledhura prej saj, bëhen pjesë e analizave periodike të studimit të tregut dhe nevojave për përshtatjen e programeve të studimit. Edhe në analizën vjetore, institucioni vlerëson edhe nevojat e tregut të punës, të evidentuara nga pyetësorët, takimet e drejtpërdrejta por edhe nga bashkëpunimet institucionale si me partnerët e biznesit ashtu edhe me ata akademik. <i>Evidence 25. Marrëveshjet aktive me Universitetet 2018-2024</i> <i>Evidence 26. Marrëveshjet aktive me biznesin, sipërmarrjet dhe institucionet e tjera 2018-2024</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Sipas statutit dhe rregullores së programit të studimit, institucioni i përfshin studentët në strukturat kryesore, si komitete, komisione si dhe kanë organizimin e tyre që i përfaqëson që është Qeveria Studentore. Në vlerësimin e programit të studimit marrin pjesë dhe studentët. Institucioni ka zhvilluar vlerësime të programit të studimit, ku janë angazhuar studentë si nga NJSBC ashtu dhe nga qeveria studentore”: Studentët janë përfshirë edhe në vlerësimin e programit të bërë në vitin 2021 nga Fakulteti i Inxhinierisë në bashkëpunim me Komitetin e Kurrikulave. Institucioni mban takime të shpeshta me studentët e diplomuar, zhvillon pyetësorë për të marrë mendimin e tyre, si dhe për të parë punësimin e tyre. Marrëdhëniet me studentët në KU IKT mbahen prej Zyrës së për Çështjet Studentore dhe Karrierës (Student Affair and Career Office), e cila pasi takimeve me studentët ALUMNI publikon opinionet e tyre për eksperiencat që ata kanë fituar në institucion gjatë studimeve por edhe pasi janë përfshirë në tregun e punës. <i>Evidence 1. Statuti i KU IKT 2016 shqip</i> <i>Evidence 10. “Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni”(shqip)</i> <i>Evidence 19.2 Raport per punesimin e studenteve ALUMNI 2017-2022 - Gjurmimi i studenteve ALUMNI prej institucionit</i> <i>Evidence 29.2 Vleresimi i programit BSc ne Inxhinieri Telekomunikacioni nga studentet 2023 - Pyetesor i NJSBC</i>


Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, realizon në mënyrë të përvitshme një analizë në tërësi të aktivitetit të saj, përfshirë edhe atë të nevojave për përmirësim të vazhduar të ofertës së saj didaktike. Në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime studentët nëpërmjet: - Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar që realizohet cdo semestër para provimeve; - Përfshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë. Fakulteti i Inxhinierisë harton një raport të përbashkët të të gjithë departamenteve, ku secili department përfshin në të të dhënat lidhura me programet, studentët, marrëveshjet, mobilitetet, stafin, ngarkesën mësimore, aktivitetet shkencore etj. Raporti i Fakultetit të Inxhinierisë hartohet cdo vit dhe detyrën për ta hartuar këtë raport e ka Qendra e Kërkimit Shkencor CIRD Inxhinieri, e cila koordinon dhe organizon procesin e mbledhjes së të dhënave, përpunimin e tyre si dhe bashkërendimin me dy departamentet e tjera, ashtu si dhe me zyrat si HR, Sekretaria, NJSBC, Komitetet dhe komisionet e ndryshme. Në këtë kuadër është edhe rishikimi dhe riorganizimi i këtij programi studimi në vitin 2018, dhe emërtimin e programit nga Bachelor në "Inxhinieri Industriale" në Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni". <i>Evidence 6.1 Raporti Vjetor i Fakultetit të Inxhinierisë - me të dhënat e mbledhura prej departamenteve</i> <i>Evidence 1. Argumentimi i ndryshimeve 2018 dërguar në MAS bashkë me dokumentet e tjera për riorganizimin e programit</i>			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit në veçanti, analizojnë dhe marrin opinionet e bashkëpunëtorëve si nga tregu i punës ashtu edhe nga ai akademik i institucioneve partnere për përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës didaktike.</i> <i>GVJ evidenton se në IAL, njësitë përgjegjëse janë angazhuar në përfshirjen e studentëve dhe bashkëpunëtorëve në përmirësimin e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ konstatoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" përfshijnë një kombinim të metodave tradicionale dhe bashkëkohore të dijeve të zhvilluara përmes leksioneve, seminarëve, ushtrimeve, praktikave profesionale dhe diplomës të miratuara nga IAL bazuar në rregulloret e IKT, Fakultetit të Inxhinierisë dhe të programit të studimit. Format e mësimdhënies i prezantohen studenti nga pedagogu i lëndës për secilën lëndë. Gjatë një viti akademik, studentët plotësojnë të paktën 60 Kredite ECTS. Metodat e vlerësimit përfshijnë pjesëmarrjen në klasë, provimet e ndërmjetme, detyrat, kuizet, ese-të, detyra shtëpie dhe provimin final. Këto metoda janë të përshkruara qartë në syllabusin e çdo lënde, dhe çdo lektor përcakton përqindjen e vlerësimit për secilën komponentë. <i>Evidence 6. "Rregullore Institucionale e KU IKT" (shqip)</i> <i>Evidence 8. "Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë" (shqip)</i> <i>Evidence 9. "Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit" (shqip)</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024</i> <i>Evidence Aneksi nr.1 Tabelat përmbledhese - shqip</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik monitoron me kujdes rastet specifike dhe gjithmonë përpiqet të identifikojë kërkesat e studentëve që mund të kenë nevojë. I gjithë personeli akademik dhe ndihmës akademik i njësisë bazë është i disponueshëm për të ndihmuar studentët si në aktivitetet e tyre didaktike, ashtu edhe në zhvillimin e projekteve individuale. Për këtë qëllim, vendosin në dispozicion edhe laboratorët dhe ambientet e institucionit. Sipas Nenit II.5 të librit të rregulloreve institucionale, personeli akademik prezanton dhe përdor disa metoda dhe burime të mësimdhënies dhe të nxënit, si brenda dhe jashtë klasës, për të motivuar, sfiduar dhe përfshirë studentët, si: - diskutimet - kazuset - trajtimi i problematikave gjatë leksioneve - projektet individuale IKT përdor një portal online në mbështetje të procesit të mësimdhënies me anë të të cilit studentët dhe pedagogët logohen nëpërmjet adresës elektronike zyrtare institucionale dhe aksesojnë të dhënat të ndryshme të lidhura me profilin e tyre. Sistemi ka të integruar platforma si Google Classroom dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.




	Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip) Evidence 72. Marreveshje CIT- McGrawHill Education Evidence 80. Marreveshja CIT- TEXO per O'Reilly Evidence Marreveshja CIT-IERA Academy per CISCO Evidence 82.1 Anëtarësimi i KU IKT në CISCO Evidence https://ums.ikt.edu.al/index.php?signln=1
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni siguron që gjithë personeli akademik në Fakultetin e Inxhinierisë dhe në Departamentin e Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit është përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohet për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Për të mbështetur stafin akademik në këtë përpjekje, institucioni zhvillon rregullisht trajnime dhe aktivitete të ndryshme që synojnë rritjen e kompetencave didaktike dhe përputhjen me rezultatet e pritshme të të nxënit. Gjatë takimit me stafin akademik të KU-IKT, GVJ konstaton që në tërësi institucioni mbështet dhe angazhohet në avancimin akademik të personelit akademik. Një formë e mbështetjes është pjesëmarrja në projekte kërkimore-shkencore apo në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+ për shkëmbim stafi dhe studentësh. Formë tjetër mbështetje është me anë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me biznese në fushën e teknologjisë së informacionit dhe trajnimeve, organizmi i orëve të hapura, pjesëmarrjes dhe referimit në konferenca shkencore dhe publikimit në revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Evidence 77. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022 Evidence 78. Katalogu i Veprimtarive 2022-2024 [Evidence Aneksi nr. 2 Aktiviteti shkencor i organizuar ne 5 vitet e fundit 2018-2023 - (shqip)] [Evidence 12. Lista e stafit dhe studenteve te ketij programi qe kane kryer mobilitete] [Evidence shtese 14. Mobilitetet CEEPUS 2016] [Evidence https://crj.ikt.edu.al/]
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Programi i studimit mbulohet në masën më të madhe nga personeli akademik i institucionit në tërësi (PAE). Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në lëndët që mbulojnë dhe me një përvojë relativisht të gjatë në mësimdhënie. Edhe personeli akademik i jashtëm me kohë të pjesshme i angazhuar në këtë program studimi, ka formimin specifik në fushën e lëndës që mbulon. Stafi akademik, bazuar edhe në syllabuset e lëndëve, i përshtat ato me programe të ngjashme të institucioneve homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda interaktive duke i bërë tërheqëse orët e mësimi. Këto metoda përfshijnë simulime, video, detyrë kursi, diskutime, prezantime etj. Evidence 21. CV e stafit akademik të programit të studimit
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë	KU IKT organizon rregullisht pyetësorë për të vlerësuar kënaqësinë dhe përmbushjen e pritshmërive të studentëve ndaj institucionit. Këto pyetësorë, të cilët realizohen nga NJSBC, përfshijnë pyetje që maten kënaqësinë e studentëve në lidhje me pritshmëritë e tyre pas regjistrimit. Në organizimin e




periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	këtyre pyetësorëve, angazhohen studentët pjesë e NJSBC dhe përfaqësues të Qeverisë Studentore. Nga ana tjetër, NJSBC në pyetësorin që organizon në fund të çdo semestri ka përfshirë edhe pyetje që lidhen drejtpërdrejt me programin e lëndës, gjithëpërfshirjen e studentëve, etj. Pyetje të tilla si: – Syllabusi shpjegon qartësisht pritshmëritë e studentëve për lëndën; – Materialet e përdorura në mësimdhënie, veç tekstit mësimor, janë të dobishme; – Lënda ka ndihmuar marrjen e njohurive mbi fushën që trajton; – Pedagogu i nxit studentët që të përfshihen gjatë shpjegimit; – Pedagogu merr parasysh mendimin e studentit; – Institucioni vë në dispozicion infrastrukturë të domosdoshme për mësimdhënien, etj. Stafi akademik vlerësohet nga NJSBC dhe mësimdhënia vlerësohet nga pyetësi që kjo njësi realizon. <i>Evidence 29.1 Model pyetësori për programin BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni - Model Pyetësori i NJSBC Aleksandra Xhamo /13.02.2024 10:56</i> <i>Evidence 29.2 Vlerësimi i programit BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni nga studentet 2023 - Pyetësori i NJSBC</i> <i>Evidence 29.8 Pyetësori mbi kënaqësinë e studentëve në CIT - 2023</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Bazuar në DVV dhe vizitën në IAL konstatohet se KU IKT ka struktura dhe njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe koordinojnë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. NJSBC, Zyra e Kurrikulave, Zyrën e Burimeve Njerëzore, dhe Qendra për Trajnimin e Biznesit dhe Edukimit të Vazhdueshëm organizojnë trajnime për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies. NJSBC është themeluar në vitin akademik 2012-2013 dhe është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë, të cilat miratohen nga Senati Akademik. Ajo vlerëson periodikisht nëpërmjet pyetësorëve rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Trajnimet dhe Zhvillimi Profesional organizohen me qëllim përmirësimin e aftësive të mësimdhënies në fusha të ndryshme, duke përfshirë "Cloud Computing dhe DevOps", përditësimet e literaturës akademike, dhe teknikat e mësimdhënies. Në strukturën institucionale funksionon edhe Komiteti Permanent për Programet dhe Kurrikulat (KPPK), i cili përbëhet nga 4-6 anëtarë dhe kontribuon në vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit ekzistuese. Si përfundim gjykojmë që KU IKT ka struktura të mirëorganizuara që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe trajnojnë vazhdimisht personelin akademik. <i>Evidence 11. "Manualin e Sigurimit të Cilësisë" (CIT QAU Handbook).</i> <i>Evidence 15. Formulare vlerësimi 1 - me kohë të pjesshme</i> <i>Evidence 15. Formulare vlerësimi 2 - me kohë të plote</i> <i>Evidence 19. Vlerësimi i Programeve të Studimit në Përputhje me Objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Fakultetit Tregu i punës dhe të dhëna për studentet pas diplomimit" 2019-2021</i>

	Evidence 29.6 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023 - 21.12.2023 Evidence 29.1 Model pyetësori për programin BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni - Model Pyetësori i NJSBC Evidence 29.2 Vlerësimi i programit BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni nga studentët 2023 - Pyetësori i NJSBC Evidence 29.3 Vlerësimi i stafit akademik të Fakultetit të Inxhinierisë nga strukturat drejtuese Evidence 29.4 Raport i përcjell në senat nga NJSBC - 2020 Evidence 29.5 Raport i përcjell në senat nga NJSBC - 2020 – 2021 Evidence 29.6 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023 - 21.12.2023 Evidence 31.1 Vlerësime të ndryshme për lenden dhe pedagogun e lendes prej studentëve të BSc në Inxh Telekom			
Konkluzione	KU IKT ka të ngritur mekanizma për monitorimin e brendshëm të cilësisë, mekanizma të cilët përfshijnë edhe studentët si një hallkë e rëndësishme e procesit të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë. KU IKT ka struktura të mirëorganizuar që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe trajnojnë vazhdimisht personelin akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucioni/rregullore të posaçme. bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e njësisë bazë, në veçanti në nenin 5.2.1 të Rregullores së Programit të Studimit përshkruhet që vlerësimi akademik i studentëve bazohet në parimin e vlerësimit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të disa komponentëve: – pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor (0-10%) – provimit të mesëm (20-30%) – detyrave, kuizeve, eseve, projekteve individuale apo grupore (20-30%) – provimit përfundimtar (50%) Në Rregulloren e Programit të Studimit, përshkruhen në detaje format e mësimdhënies dhe vlerësimit akademik. Këto rregullore sigurojnë që proceset e vlerësimit janë të standardizuara dhe të përputhura me ligjin në fuqi dhe aktet nënligjore. Sipas nenit 5.1.2 të Rregullores së Programit të Studimit, format e mësimdhënies përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, projektet dhe praktikatat profesionale. Këto forma ndihmojnë në zhvillimin e plotë të njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve. Informacione të tjera studentët i marrin tek guida e studentit është publike dhe gjendet në faqen e studentëve në web.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	Gjithashtu, edhe pse këto rregullore janë të disponueshme për të gjithë të interesuarit në format elektronik dhe fizik brenda institucionit, ato nuk janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të IKT-së. GVJ rekomandon që rregulloret institucionale të bëhen publike dhe të aksesueshme online në faqen zyrtare të institucionit të arsimit të lartë, në mënyrë që të jenë më lehtësisht të disponueshme për të gjithë të interesuarit, dhe jo vetëm për studentët e këtij institucioni. <i>Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024</i> <i>Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit).pdf</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në: – Rregulloren e programit të studimit, Neni 5 – Syllabus Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Ky informim përfshin format e kontrollit të dijeve, të cilat janë të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditura studentëve në javën e parë të procesit mësimor. Syllabuset shpërndahen në mënyrë efektive nëpërmjet Google Classroom dhe rregulloret e institucionit dërgohen online nëpërmjet emailit, duke qenë gjithashtu të disponueshme në bibliotekë. Në syllabuset përcaktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar, sipas natyrës së lëndës dhe rëndësisë së aspektit aplikativ. Studentët marrin informacion të detajuar jo vetëm nga pedagogët e lëndëve, por edhe nga këshilltarët akademikë dhe sistemi elektronik në përdorim nga institucioni. Informacionet rregullisht përditësohen dhe shpërndahen për të siguruar që studentët janë gjithmonë të informuar mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit. Kjo metodologji e informimit kontribuon në një përvojë akademike më të plotë dhe të kënaqshme për studentët, duke i përgatitur ata më mirë për karrierën e tyre të ardhshme. <i>Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i> <i>Evidence 18.7 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore – Çikli i Parë" (shqip – anglisht)</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të	Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik.




demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Format e testimit të njohurive janë të përcaktuara në “Rregulloren e programit të studimit” në pikën 5 të saj në të cilën rregullohet procesi i vlerësimit të studentit dhe ku përcaktohen: – Sistemi i vlerësimit (tabela e notave) – Metoda e vlerësimit të njohurive Sipas nenit 5.2.1 të Rregullores së Programit të Studimit vlerësimi akademik i studentëve bazohet në parimin e vlerësimit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të disa komponentëve: – pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor (0-10%) – provimit të mesëm (20-30%) – detyrave, kuizeve, eseve, projekteve individuale apo grupore (20-30%) – provimit përfundimtar (50%) Tek komponentët e tjerë përfshihen vlerësimi i punimeve të projekteve të studentëve apo elementë të tjerë të parashikuar në syllabusin e secilës lëndë. <i>Evidence 18.6 “Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni” (shqip)</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, u konstatua që në Departamentin e Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit, përdoren një sërë metodash pedagogjike të shumëllojshme dhe fleksible, të cilat janë të përshtatshme dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe objektivat formues. Diskutimet me stafin e angazhuar në programin e studimit kanë treguar se ka një përkushtim për përmirësimin e programit, literaturës, aspekteve teknike të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimi, diplomimeve, kërkimit shkencor dhe angazhimit të studentëve në projekte dhe detyra kursi për të përthithur sa më mirë aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrin nga secila lëndë. Studentët marrin pjesë në të gjitha komitetet dhe komisionet institucionale, si dhe në Senatin Akademik, ku diskutohet lidhur me përmirësimin e metodave dhe teknikave të mësimdhënies, që reflektojnë sugjerimet dhe vërejtjet e bëra. Institucioni organizon periodikisht pyetësorë mbi kënaqësinë dhe realizimin e pritshmërive të studentëve ndaj institucionit. Këto pyetësorë përfshijnë pyetje që lidhen drejtpërdrejt me programin e lëndës, gjithëpërfshirjen e studentëve dhe kënaqësinë e tyre me procesin mësimor. Studentët shprehin mendimet e tyre për silabuset, materialet e përdorura në mësimdhënie, dhe ndihmën e marrë nga pedagogët për përfshirjen në procesin mësimor. Rezultatet e këtyre pyetësorëve analizohen dhe përdoren për të përmirësuar pikat ku vlerësimi i studentëve ka qenë i dobët. <i>Evidence 7. “Libri i Rregulloreve Institucionale” (shqip)</i> <i>Evidence 29.6 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023 - 21.12.2023</i>




	Evidence 19. Vlerësimi i Programeve të Studimit në Përputhje me Objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Fakultetit Tregu i punës dhe të dhëna për studentët pas diplomimit” 2019-2021			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Programi i studimit mbulohet në pjesën më të madhe nga personeli akademik i institucionit (PAE) në tërësi dhe në veçanti nga staf i njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi. Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është i kualifikuar në fushën e lëndëve që mbulon si dhe me një përvojë relativisht të gjatë në mësimdhënie. Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion KU IKT, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, në të cilën mbështet nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnimet dhe pjesëmarrjet në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë. Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda interaktive duke i bërë tërheqëse orët e mësimi. Këto metoda përfshijnë simulime, video, detyrë kursi, diskutime, prezantime etj. Përdorimi i infrastrukturës laboratorike në mësimdhënie ka vend për përmirësim. Evidence 24. Marrëveshjet aktive në kuader të Erasmus+ 2018-2024 Evidence 25. Marrëveshjet aktive me Universitetet 2018-2024 Evidence 72. Marrëveshjet CIT- McGrawHill Education			
Konkluzione	Institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për të drejtat dhe detyrimet e studentëve për sa i përket vlerësimit të njohurive të përçuara në secilën lëndë dhe ka të përcaktuar qartë të drejtat e studentëve për t'u njohur apo ankimuar vlerësimin e marrë. Gjithashtu, institucioni ka të përcaktuar dhe funksionale struktura për dëgjimin e opinioneve të studentëve rreth të gjithë jetës studentore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në DVV, syllabuset e lëndëve, vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare dhe laboratorë, detyrave të kursit etj. sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës. Vlerësimi i studentëve është stimulues dhe jo penalizues, duke siguruar që çdo vlerësim të shoqërohet me komentet e duhura. Elementet kryesore të kontrollit të vazhdueshëm përfshijnë provimet, punimet/projektet,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




	dhe nivelin e aktivizimit në seminare apo punë laboratorike, provimet e ndërmjetme, si dhe vlerësimet në bazë të pyetje-përgjigjeve. Rregullorja e programit të lëndës përcakton qartë kategoritë dhe elementet e përdorura në vlerësimin e studentit, të cilat janë: – Pjesëmarrja aktive në procesin mësimor (0-10%) – Provimi i mesëm (20-30%) – Detyrat, kuizet, esetë, projektet individuale apo grupe (20-30%) – Provimi përfundimtar (50%) Vlerësimi i studentëve kryhet në mënyrë të vazhdueshme nga 0-100%, sipas skemës dhe sistemit të përcaktuar të vlerësimit. Metodat e përdorura janë të larmishme dhe përfshijnë të gjitha elementet e përmendura më sipër. <i>Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip)</i> <i>Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni nuk përdor sisteme elektronik të testimit dhe vlerësimit. IAL gjykon që përdorimi i sistemeve elektronike varet nga rritja e numrit të studenteve. <i>Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip)</i> <i>Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Gjatë takimit me studentët, u konfirmua se mënyra e vlerësimit të njohurive u bëhet e ditur nga pedagogu i lëndës javën e parë të mësimi. Mënyrat dhe format e vlerësimit janë të paraqitura edhe në syllabusin përkatës të lëndës si dhe në rregulloret institucionale. Në KU-IKT, vlerësimi përfundimtar i studentëve përmban kombinimin e katër elementëve kryesorë, të cilët janë të përcaktuar qartë si në Rregulloren e Programit të Studimit ashtu edhe në Programin e lëndës dhe përfshijnë: - <i>Pjesëmarrja aktive në procesin mësimor:</i> Ky element përfshin angazhimin e studentëve gjatë leksioneve, seminareve dhe laboratorëve, duke vlerësuar kontributin dhe pjesëmarrjen e tyre aktive, e cila përbën 0-10% të vlerësimit përfundimtar. - <i>Provimi i mesëm:</i> Realizohet në javën e 7-të ose të 8-të të secilit semestër dhe përbën 20-30% të vlerësimit përfundimtar. - <i>Detyrat, kuizet, esetë, projektet individuale apo grupe:</i> Gjatë semestrit, studentët vlerësohen për punët e dorëzuara dhe për projektet e realizuara, të cilat përbëjnë 20-30% të vlerësimit përfundimtar. - <i>Provimi përfundimtar:</i> Zhvillohet në javën e 16-të, pasi ka përfunduar semestri, dhe përbën 50% të vlerësimit përfundimtar. Skema e vlerësimit në KU IKT përmban disa metoda vlerësimi që përputhen me standardet ndërkombëtare dhe janë të përfshira në syllabusin e lëndës. Këto metoda përfshijnë: - Vlerësimi sipas sistemit Amerikan (0-4); - Vlerësimi me gërma (Alpha Grade); - Vlerësimi me përqindje; - Vlerësimi me notë (0-10);




	- Shpjegimet e vlerësimeve CUD: Ky element përfshin shpjegimet dhe interpretimet e ndryshme të vlerësimeve, duke ndihmuar studentët të kuptojnë më mirë rezultatet e tyre. Të gjitha këto elemente dhe metodat e vlerësimit janë të përfshira në silabusin e lëndës. <i>Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloret institucionale. Për të realizuar parimin e transparencës, institucioni udhëzon stafin akademik që gjatë vlerësimit të përdorin komente dhe të japin sqarime të herëpashershme, duke mundësuar që studentët të mësojnë përmes vetëkorrigjimit dhe kuptimit të vlerësimit. Sipas Rregullores së Programit të Studimit (pika 5.2.4), vlerësimi i studentit shënohet në fletën e provimit dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit. Rezultatet dorëzohen brenda dy javësh nga data e provimit, gjatë të cilave profesori është i disponueshëm për të sqaruar çdo ankesë. Stafi akademik i përmbahet programit të lëndës dhe zhvillon takime sqaruese lidhur me njohuritë e dhëna dhe ato të testuara. <i>Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip)</i> <i>Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Gjatë Ditëve të Orientimit, stafi akademik i njësive kryesore, si dhe titullarë të institucionit, japin informacione të plota rreth mënyrës se si studenti duhet t'i qaset informacionit, detyrave të kursit, projekteve, tezës së diplomës etj. Ky orientim i detajuar përfshin udhëzime mbi mënyrën e kërkimit dhe referimit të burimeve të informacionit, si dhe teknikat e duhura të citimit dhe parafrazimit për të shmangur plagjiaturën. Studentët marrin gjithashtu udhëzime të hollësishme për strukturën dhe formatin e detyrave të kursit, eseve, projekteve dhe tezave të diplomës, duke siguruar që ata janë të pajisur me të gjitha njohuritë dhe burimet e nevojshme për të përmbushur kërkesat akademike të institucionit. Për të siguruar integritetin akademik dhe për të parandaluar plagjiaturën, Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) përdor mjete të specializuara për kontrollin e plagjiaturës, duke përfshirë Plagiarism Checker X - Online Plagiarism Checker. Ky mjet ndihmon në identifikimin e çdo përpjekjeje për plagjiaturë në punimet e dorëzuara nga studentët, duke siguruar që të gjitha punimet akademike janë origjinale dhe në përputhje me standardet e larta të integritetit akademik. <i>Evidence 10. Pagesa për blerjen e licensave të Plagiarism Checker</i> <i>Evidence 66. Urdhëri i Rektorit nr 14.1, datë 12.07.2022 për aprovimin e Plagiarism Checker software dhe Rregullores përkatëse</i> <i>Evidence https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2024/02/Plagiarism-checker-guidelines</i>

Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.

Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstaton që vlerësimi kryhet me sistem me pikë me bazë 100, pikë të cilat përkthen në nota me gërmë (F-A) dhe me pikë cilësie me bazë 4 (0-4.00) si në vijim:

Përqindja	Nota e Shprehur në Shkronjë	Pikëzimi	Notat nga 0-10
90-100	A+	4.0	10
85-89	A	3.7	9
80-84	A-	3.5	8
75-79	B+	3.3	
70-74	B	3.0	7
65-69	B-	2.7	
60-64	C+	2.5	6
55-59	C	2.0	
53-54	D+	1.5	5
50-52	D	1.0	
0-49	F	0.0	4
	FNA	0.0	0

Nota kaluese në çdo lëndë është 50 për qind. Kërkohej CGPA (notë mesatare) minimale prej 2.00 në çdo vit akademik (semestri i vjeshtës dhe pranverës) për progres akademik. Rezultatet e provimeve dorëzohen brenda 2 javësh nga data e provimit. Brenda këtyre dy javëve, në kohën e caktuar për tutorim dhe/ose këshillim akademik, profesori pret që studentët të sqarojnë çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që mund të kenë në lidhje me vlerësimin. Pas kësaj periudhe profesori plotëson dhe ia dorëzon raportin përfundimtar sekretarisë mësimore. Pas kalimit të afatit 2 javor dhe hedhjes së rezultateve në sistemin UMS, nota apo vlerësimi është i pandryshueshëm. Por, në të gjitha rastet studenti ka të drejtë të ankohen sipas afateve dhe rregulloreve përkatëse. Studenti njihet me procedurat e ankimit në Guidën e Studentit.

Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)

Evidence 20, Programet e lendeve 2021-2022

Evidence 20, Programet e lendeve 2022-2023

Evidence 20, Programet e lendeve 2023-2024

Evidence 47, Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)

Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.

GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit, në veçanti neni 5. Kriteret e Frekuentimit; neni 6: Provimet; neni 5.2: Provimi përfundimtar; neni 5.2 pika d: Provimi e Vjeshtës; neni 5.3: E drejta për të apeluar rezultatet e provimit; dhe neni 5.5.

Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)




Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas rregullores së sekretarisë mësimore, kur një student ka një ankesë për vlerësimin e marrë, pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim. Përgjegjësi i Departamentit, mund të ngrejë një Komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Nëse pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, atëherë Dekani do të ngrejë Komisionin përkatës. Në rast se studenti nuk është i kënaqur me zgjidhjen e ofruar nga komisioni, ai mund t'i drejtohet zv. Rektorit brenda 15 ditësh nga dhënia e vendimit, me një “Kërkesë për t’u dëgjuar” në një takim të posaçëm. E drejta e studentit për të apeluar për vlerësimin sqarohet gjithashtu në Rregulloren e Programit të Studimit, pika 5.5. Studenti njihet me të drejtën e ankimimit në Guidën e Studentit në kapitullin “Procedura e Ankimimit”, faqet 108-111. Kur një student dëshiron të ankohe ose të paraqesë një ankesë për ndonjë çështje, ai/ajo ka të drejtë të këshillohet nga Zyra e Çështjeve të Studentëve ose Kryesekretarja për procedurat që duhet të ndjekë. Procedurat për ankesat dhe ankesat akademike të studentëve japin më shumë detaje se si KU IKT i konsideron ankimimet dhe ankesat akademike, nga shqyrtimi i hershëm deri te zgjidhja dhe shqyrtimi formal, dhe informacionin se si të dorëzohet secila prej tyre përmes katër fazave: – Faza e parë: Dorëzimi i ankesës nga studenti sipas formatit të miratuar (www.cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/Students-Complaints-Form-updated.docx.pdf) – Faza e dytë: Investigimi zyrtar – Faza e tretë: Vendimi i institucionit – Faza e katërt: Feedback-u i ankesës së studentit (www.cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/Students-Complaints-Feed-Back.pdf) Në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, Cikli I, qartësohen afatet dhe procedurat më tej: studenti ka të drejtë të përmirësojë, çdo vit akademik, 3 (tre) nota në sezonin e riprovimeve, duke bërë regjistrimin përkatës në Sekretarinë Mësimore. <i>Evidence 18.7 “Rregullore e Sekretarisë Mësimore – Cikli i Parë” (shqip – anglisht)</i> <i>Evidence https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/Students-Complaints-Form-updated.docx.pdf</i> <i>Evidence https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/Students-Complaints-Feed-Back.pdf</i> <i>Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit) pdf</i>			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar Instituti Kanadez i Teknologjisë ka të përcaktuar në aktet rregullatore të gjitha procedurat që duhet të ndiqen si nga stafi akademik, ashtu edhe nga studentët në kuadër të transparencës të vlerësimit të dijeve.</i> <i>Studentët kanë të gjitha mekanizmat për tu informuar, ankimuar dhe marrë përgjigje të plotë rreth çdo paqartësie që mund të kenë në lidhje me vlerësimet, dijet e marra dhe jetën e tyre studentore në tërësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ, bazuar në takimin në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë teorike në fushën e inxhinierisë së telekomunikacionit dhe përmbyllet me diplomën/provimin e formimit. Syllabuset e lëndëve/modulëve paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse. Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime dhe leksione të hapura. Staf i akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtëkurrikulare. Kjo kurrikul parapërgatit studentët për thellimin e studimeve në ciklin master. <i>Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2022-2023</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2023-24</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2021 - 2022</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit siguron aftësi specifike në fushat teknologjike dhe inxhinierike. Plani mësimor për këtë program përfshin lëndë karakterizuese në teknologjinë e informacionit dhe lëndë plotësuese për aftësimin në gjuhë të huaj, formimin bazë dhe aftësi menaxhuese. Programi përmban lëndë kryesore që mbulojnë tema thelbësore në inxhinierinë e telekomunikacionit, si Bazat e Telekomunikacionit, Komunikimi Wireless, Sistemet e Komunikimit Digjital, dhe Antena dhe Përhapja e Valëve. Për të përmirësuar aftësitë e përgjithshme dhe ndërdisiplinore të studentëve, programi përfshin lëndë si Gjuhë e Huaj I dhe II, Shkrim Akademik I dhe II, Metodatat Kërkimore në Shkencat e Aplikuara, dhe Administrim dhe Menaxhim i Rrjetave. Studentët zhvillojnë aftësi menaxhuese dhe ndërdisiplinore përmes lëndëve si Menaxhimi i Projekteve dhe Menaxhimi i Sigurisë. Departamenti ofron shërbime shtesë përveç procesit mësimor, duke përfshirë konsultime dhe leksione të hapura. Staf i akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtëkurrikulare, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive dhe kompetencave të tyre. <i>Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2022-2023</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2023-24</i> <i>Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2021 - 2022</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	<i>Evidence 20, Programet e lendeve 2021-2022</i> <i>Evidence 20, Programet e lendeve 2022-2023</i> <i>Evidence 20, Programet e lendeve 2023-2024</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kompetencat dhe aftësitë që duhet të fitojë studenti janë qartë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit. Staf akademik është udhëzuar të përshtasë këto kompetenca në programet e lëndëve, duke siguruar që çdo lëndë mbulon objektivat dhe aftësitë specifike që studenti duhet të fitojë dhe që studentët të kenë akses të vazhdueshëm në këshillim akademik. Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se aftësitë e fituara nga studentët analizohen dhe shqyrtohen në përfundim të çdo lënde, ku personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. Këto kompetenca janë përshtatur nga Fakulteti i Inxhinierisë dhe njësia bazë, dhe janë të përfshira në programin e studimit dhe grup-lëndët e kategorive nga A-E. <i>Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i> <i>Evidence 11. Vendi i Këshillit të Fakultetit për miratimin e tutoriatit studentor për këshillimin akademik</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia në këtë program realizohet mbi bazë kompetencash, duke u dhënë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Plani mësimor është hartuar me synimin që ngarkesa mësimore e studentëve të jetë e balancuar. Orët e dedikuara për seminare dhe ushtrime, laboratorë dhe praktikë mësimore zënë përafërsisht 50% të tij, po aq sa zënë dhe orët teorike. Kjo qasje ndihmon studentët të fitojnë një përvojë të plotë dhe integrale që përfshin si njohuritë teorike, ashtu edhe aftësitë praktike. KU IKT, në "Strategjitë e Mësimdhënies" (Libri i Rregulloreve Institucionale), udhëzon stafin akademik që të mbështesë konceptet e reja lidhur me teknikat pedagogjike dhe metodikën alternative të mësimdhënies. Lektorët prezantojnë dhe përdorin një shumëllojshmëri metodash dhe burimesh të mësimdhënies dhe të nxënës, si brenda dhe jashtë klasës, për të motivuar, sfiduar dhe përfshirë studentët. Metodot e përdorura përfshijnë teknika inteligjente të pyetjeve, veprimtari praktike, sesione interaktive në seminare të kombinuara me supervizim, përdorimin e metodave të ndryshme ndërvepruese në klasë, udhëtime dhe vizita në terren, ekspertë të ftuar, punë në grup të bazuar në raste studimore, dhe detyra të bazuara në kërkim dhe hulumtim. Këto praktika ndihmojnë në krijimin e një trekëndëshi mësimor efektiv: student-pedagog-klasë. Gjithashtu, përdorimi i teknikave moderne të mësimdhënies përmes platformave si Google Classroom dhe CISCO Academy, si dhe përdorimi i literaturës më të fundit prej McGrawHill Education, krijojnë klimë të përshtatshme për bashkëpunimin staf-student dhe rrisin mundësinë e mobiliteteve studentore. Institucioni është siguruar që të garantojë mbarrëvajtjen e procesit mësimor duke mbështetur këtë gjë përmes marrëveshjeve për shkëmbim stafi dhe studentësh në kuadër të programeve Erasmus dhe CEEPUS, sigurimin e praktikave mësimore në institucione publike dhe private, dhe bashkëpunimin me institucione homologe për realizimin e konferencave të përbashkëta




	shkencore. Një listë e marrëveshjeve për Fakultetin e Inxhinierisë gjendet në Shtojcë, tabela nr. 5.1-5.2. Megjithatë, është vërejtur se, ndonëse KU IKT ka rreth 20 marrëveshje mobilitetesh të nënshkruara me universitete të ndryshme perëndimore dhe është pjesë e CEEPUS prej vitit 2016-2017, nuk ka pasur studentë nga ky program studimi që kanë përfituar nga mobilitetet Erasmus (Tabela 20). GVJ <u>sugjeron</u> që IAL të bëjë më shumë përpjekje për të ofruar mundësi mobiliteti Erasmus+ për studentët e programit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni. Në përfundim, ndërsa programi Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni përmbush disa nga kriteret e mësimdhënies dhe mbështetjes akademike, ka fusha të rëndësishme që kërkojnë përmirësime. Për të arritur një përmbushje të plotë të kriterëve, është e nevojshme të përmirësohen mundësitë e mobilitetit për studentët dhe të pajisen laboratorët me teknologjinë e nevojshme për të mbështetur një edukim të avancuar në fushën e telekomunikacionit. <i>Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip)</i> <i>Evidence Aneksi nr 1 Tabelat përmbledhese - shqip</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Përgjatë vitit akademik, njësia bazë dhe ajo kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, organizon në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime, orë informuese etj. për studentët e saj. Këto orë mund të drejtohen nga personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. Këto aktivitete realizohen jashtë strukturës së programit të studimit dhe në orare që nuk bien ndesh me procesin mësimor. <i>Evidence 18. Raport i zyrës së çështjeve studentore dhe karrieres - Student Affairs and Career Office annual Report - december 2021</i> <i>Evidence 76. Katalogu i Veprimtarive 2019-2020</i> <i>Evidence 77. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022</i> <i>Evidence 78. Katalogu i Veprimtarive 2022-2024</i>			
Konkluzione	Njësia bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, janë të angazhuar në rritjen e cilësisë në tërësi të ofertës akademike duke realizuar në mënyrë të vazhduar takime, seminare, workshop-e, në kuadër të bashkëpunimeve dhe në motivimin e studentëve drejt tregut të punës. GVJ <u>sugjeron</u> që IAL të bëjë më shumë përpjekje për të ofruar mundësi mobiliteti Erasmus+ për studentët e programit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	– Guida e Studentit. Dokumente të tjera që lidhen me procesin e diplomës dhe që u dërgohen studentëve me email në afate të caktuara kohore gjatë vitit janë: – Formatit për caktimin e temës së diplomës. – Afatet për mbrojtjen e temës. – Rregullorja për punimin e diplomës. Studentët kanë gjithashtu një udhëheqës për tezën e diplomës. Në fillim të vitit akademik, në tetor, çdo departament organizon një takim për të konsultuar tema të ndryshme të cilat mund të shërbejnë si fusha studimi për tezat në nivel diplome, si dhe për të identifikuar drejtuesit e mundshëm të tezave. Miratimi i temave të tezës nga drejtuesit e tezave bëhet jo më vonë se java e 14 (katërmëdhjetë) e semestrit të parë, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi. <i>Evidence 13. "Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës" (shqip)</i> <i>Evidence 13.1 Rregullorja mbi Punimin e Diplomes (shqip) ne anglisht gjendet tek "Libri i Rregulloreve Institucionale" fq 62-73</i> <i>Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)</i> <i>Evidence https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2024/02/Plagiarism-checker-guidelines</i> <i>Evidence "Rregullore e Sekretarisë Mësimore – Cikli i Parë" (shqip – anglisht)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Dekani i Fakultetit sipas nenit 13 të rregullores së Fakultetit miraton komisionin e posaçëm për mbrojtjen e diplomës. Ky komision merr parasysh të dhëna të mbledhura dhe të raportuara nga sekretaria e fakultetit për tri vitet akademike për rezultatet e studentëve që do të diplomohen. Në vlerësimin përfundimtar të diplomës, komisioni përdor si kriter orientues ecurinë e studentit dhe rezultatet e tri viteve të fundit. Për vlerësimin e tezës, komisioni merr parasysh kriteret e mëposhtme: – Vlerësohet aftësia e studentit për të analizuar në mënyrë kritike temën e diskutuar, duke marrë parasysh njohuritë dhe përvojën e tij. – Përdorimi i metodologjisë shkencore dhe instrumenteve të kërkimit: – Teza duhet të paraqesë ide dhe kontribute origjinale në fushën e studimit. – Vlerësohet rëndësia dhe ndikimi i mundshëm i tezës në fushën përkatëse dhe aplikimet praktike të saj. – Teza duhet të respektojë stilin shkencor të të shkruarit dhe rregullat e drejtshkrimit, duke demonstruar një shkrim të qartë dhe të strukturuar mirë. – Paraqitje e qartë dhe koherente e tezës: – Teza duhet të përmbushë kërkesat e formatimit dhe të ketë një paraqitje të qartë dhe koherente. – Vlerësimi i tezës bazohet në një sistem pikëzimi, i cili më pas konvertohet në notë përfundimtare. Njohuritë në tërësi të fituara gjatë këtij programi studimi testohen në projekt diplome që studenti realizon nën udhëheqjen e pedagogut. <i>Evidence 8 "Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë" (shqip)</i>




Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Institucioni miraton çdo vit Planin Kalendarik Vjetor, i cili përfshin sezonet e diplomimit sipas periudhave përkatëse. Ky plan kalendarik miratohet me Vendim Senati dhe shpallet në faqen zyrtare të internetit të institucionit për të dy ciklet e studimit (https://cit.edu.al/academic-calendar/). Për mbrojtjen e diplomës, institucioni ka hartuar rregullore dhe manualë specifikë, duke përfshirë: – Libri i Rregulloreve Institucionale mbi punimin e diplomës; – Manuali i Punimit të Diplomës; – Rregullorja për Kontrollin e Plagjiaturës; – Procedurat e Rregulloreve të Programit të Studimit dhe Rregullorja e Sekretarisë Mësimore për Ciklin e Parë; – Guida e Studentit; Në Rregulloren e Programit të Studimit, pika 5.1 dhe pika 8, përcaktohen kriteret dhe procedurat për diplomim. – Nota kaluese në çdo lëndë është 50%; – CGPA minimale prej 2.00 kërkohet në çdo vit akademik për përparim dhe diplomim; Pedagogët kryesorë zhvillojnë sesione sipas një kalendarit takimesh për të orientuar temat e studentëve. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit dhe pa kryer të gjitha detyrimet e programit të studimit. Njësia bazë ofron tre sezone për mbrojtjen e tezës: java e tretë e janarit, java e tretë e korrikut dhe java e tretë e shtatorit. Një komisioni i posaçëm mblidhet për mbrojtjen e temës së diplomës dhe konsideron progresin e studentit dhe rezultatet e viteve të fundit si kriter orientues në vlerësimin përfundimtar të punimit të diplomës. Sekretaria mësimore shpërndan Rregulloren dhe Manualin e Diplomës. Institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme që lidhen me mbrojtjen e diplomës, të cilat janë të miratuara dhe të shpallura në mënyrë të rregullt. Dokumentet si Libri i Rregulloreve Institucionale, Manuali i Punimit të Diplomës, Rregullorja për Kontrollin e Plagjiaturës dhe Guida e Studentit ofrojnë udhëzime që procesi i diplomimit është i strukturuar dhe i organizuar mirë, duke përfshirë sezonet e caktuara për mbrojtjen e tezës dhe kriteret e nevojshme për përgatitjen dhe mbrojtjen e saj. <i>Evidence 13. "Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës" (shqip)</i> <i>Evidence 13.1 Rregullorja mbi Punimin e Diplomes (shqip) në anglisht gjendet tek "Libri i Rregulloreve Institucionale" fq 62-73</i> <i>Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)</i> <i>Evidence https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2024/02/Plagiarism-checker-guidelines</i> <i>Evidence "Rregullore e Sekretarisë Mësimore – Cikli i Parë" (shqip – anglisht)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Të gjitha dokumentet përkatëse u dërgohen studentëve nga sekretaria dhe përgjegjësi i departamentit që ofron programin e studimit. Dokumentet që u dërgohen studentëve përfshijnë: – Manuali i Punimit të Diplomës. – Rregullorja për Kontrollin e Plagjiaturës.




	<i>Evidence 13. "Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës" (shqip)</i> <i>Evidence 13.1 Rregullorja mbi Punimin e Diplomes (shqip) ne anglisht gjendet tek "Libri i Rregulloreve Institucionale" fq 62-73</i> <i>Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)</i> <i>Evidence https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2024/02/Plagiarism-checker-guidelines</i> <i>Evidence "Rregullore e Sekretarisë Mësimore – Cikli i Parë" (shqip – anglisht)</i> <i>Evidence 18.6 "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni" (shqip)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tezës së diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik. GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, përpunimin e tyre, si dhe paraqitjen dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve, origjinalitetin e tyre dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për tu paraqitur para komisionit. <i>Evidence 69. Format i përcaktimit të temës së diplomës</i> <i>Evidence 11. Vendimi Këshillit të Fakultetit për miratimin e tutoriatit studentor për keshillimin akademik</i> <i>Evidence 13. "Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës" (shqip)</i> <i>Evidence 13.1 Rregullorja mbi Punimin e Diplomes (shqip) ne anglisht gjendet tek "Libri i Rregulloreve Institucionale" fq 62-73</i> <i>Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në shërbim të studentëve janë pesë laboratorë të dedikuar për programet mësimore dhe për zhvillimin e testimeve apo eksperimenteve të ndryshme. Të gjithë laboratorët janë të hapur për studentët, të cilët mund të kryejnë testime, detyra laboratorike dhe projekte të ndryshme, përveç kohës kur laboratorët janë të zënë me mësim. Studentët mund të kërkojnë asistencën e stafit akademik sipas profilit të detyrës së tyre. Për të mbështetur aspektin teorik të temës së diplomës, studentët kanë mundësi të përdorin tekstet dhe literaturën në Bibliotekën e institucionit, si dhe burimet online që ofrohen nga O'Reilly dhe McGraw-Hill Education. <i>Evidence 11. Vendimi Këshillit të Fakultetit për miratimin e tutoriatit studentor për keshillimin akademik</i> <i>Evidence 13. "Manuali i Punimit të Tezës së Diplomës" (shqip)</i> <i>Evidence 13.1 Rregullorja mbi Punimin e Diplomes (shqip) ne anglisht gjendet tek "Libri i Rregulloreve Institucionale" fq 62-73</i> <i>Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)</i> <i>Evidence 72. Marrëveshje IKT- McGrawHill Education</i> <i>Evidence 80. Marrëveshja IKT - TEXO per O'Reilly</i>




Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet sipas një sistemi pikëzimi. Vlerësimi i tezës bazohet në një sistem pikëzimi, i cili më pas kthehet në notë. Për çdo kandidat, Kryetari i Komisionit plotëson formularin përkatës dhe llogarit pikët e dhëna nga çdo anëtar i Komisionit të Vlerësimit dhe e ndan atë sipas numrit të vlerësuesve përpara se t'i kthej rezultatet në notë përfundimtare në përputhje me sistemin e vlerësimit në fuqi. Në rastet kur mbikëqyrësi është anëtar i Komisionit të Vlerësimit, vlerësimi i tij llogaritet vetëm një herë. Rezultati përfundimtar regjistrohet dhe bëhet publik në fund të çdo seance në prani të kandidatëve. <i>Evidence 6. "Rregullore Institucionale e KU IKT" (shqip)</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 kredite ECTS, zyrat administrative përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Sekretaria mësimore pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e saj sipas formateve të aprovuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Studenti ka të drejtë të tërheqë një kopje të programit në çdo kohë që ai e sheh të arsyeshme. <i>Evidence 17. Miratimi i formës së diplomes për BSc në Inzhinieri Telekomunikacioni Urdhër nr. 421, datë 15.11.2023 Prot. 40829 të MAS-QSIIA</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në RVB, Rregulloren e Arkivit dhe vizitën në institucion, konstatohet se të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, vihet re një organizimi i arkivës dhe i materialeve për çdo student lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë në çdo moment. Kjo procedurë lehtëson punën e sekretarisë mësimore për hartimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të kërkohen nga studentët apo ish student në çdo kohë. <i>Evidence 18.8 Rregullore e Arkivit</i>			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar IKT ka të përcaktuar qartë procedurat e mbylljes së studimeve, mbrojtjen e diplomës apo të provimit të formimit.</i> <i>IAL pajis studentët me diplomën sipas standardit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin e saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	-----------------------------------




IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																								
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Për të mbuluar lëndët mësimore të programit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” është angazhuar staf akademik me përgatitje specifike në atë fushë. Fakulteti i Inxhinierisë gjatë vitit akademik 2023-2024 ka patur 22 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë me kualifikimet si më poshtë: – 3 Profesorë – 3 Profesor i Asociuar; – 6 Doktorë shkencash; – 10 MSc. (nga të cilët, 4 Dr. në proces). Stafi akademik i Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit (sipas Tabela 2) përbëhet nga 7 anëtarë personel akademik efektiv, me kualifikimet: – 2 Profesor i Asociuar – 2 Doktor – 3 Master (nga të cilët 1 Dr. në proces) Në tre vitet e fundit akademike (sipas Tabela 6) kemi këtë paraqitje të angazhimit të stafit akademik në këtë program studimi sipas kualifikimeve. <table><tr><th></th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2021-2022</th></tr><tr><th></th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>3</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.Asoc.Dr.</td><td>3</td><td>1</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>6</td><td>-</td><td>7</td><td>1</td><td>10</td><td>-</td></tr><tr><td>MSc (Dr. në proces)</td><td>4</td><td>1</td><td>4</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>MSc</td><td>6</td><td>-</td><td>6</td><td>-</td><td>5</td><td>-</td></tr><tr><td>Total</td><td>22</td><td>2</td><td>21</td><td>1</td><td>20</td><td>0</td></tr></table> Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni është i mbuluar në masën 54% nga staf akademik me të paktën gradën shkencore Doktor (sipas Tabela 12). Kujtojmë se për zhvillimin e leksioneve në auditor, personeli akademik duhet të jetë i kategorisë “lektor”, pra të ketë së paku gradën shkencore “Doktor”, ndërsa në zhvillimin e aktiviteteve didaktike si seminare, laborator etj, personeli akademik që angazhohet duhet të ketë së paku formimin e një cikli më të lartë se ai programit të studimit ku angazhohet. Në rastin e këtij programi studimit, duhet të jetë së paku me kualifikimin “Master i Shkencave”. Bazuar në të dhënat në Tabelën 12, GVJ konstaton që disa nga lëndët zhvillohen në masën 100% të ngarkesës mësimore (Leksione, Seminare dhe Laboratore) nga staf akademik me gradën shkencore Master. Për përmirësimin e cilësisë së		2023-2024		2022-2023		2021-2022			PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	3	-	1	-	1	-	Prof.Asoc.Dr.	3	1	3	-	3	-	Dr./PhD	6	-	7	1	10	-	MSc (Dr. në proces)	4	1	4	-	1	-	MSc	6	-	6	-	5	-	Total	22	2	21	1	20	0
	2023-2024		2022-2023		2021-2022																																																				
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																			
Prof.Dr.	3	-	1	-	1	-																																																			
Prof.Asoc.Dr.	3	1	3	-	3	-																																																			
Dr./PhD	6	-	7	1	10	-																																																			
MSc (Dr. në proces)	4	1	4	-	1	-																																																			
MSc	6	-	6	-	5	-																																																			
Total	22	2	21	1	20	0																																																			

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




	mësimdhënies, GVJ <u>sugjeron</u> që IKT duhet të bëjë përpjekje që të paktën leksionet të zhvillohen nga pedagogë me të paktën gradën shkencore Doktor. [Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2023-24] [Evidence 21. CV e stafit akademik të programit të studimit] [Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024] [Evidence 22.1 Prezantimi i Stafit të Fakultetit të Inxhinierisë] [Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip] [Evidence shtese: 2. Lista e stafit akademik të njesise kryesore-fakultetit]
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Vërejmë që garkesa e personelit akademik, është përcaktuar në respekt të lirisë akademike dhe në përputhje me ekspertizën përkatëse të stafit akademik. Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit planifikon çdo vit ngarkesën mësimore për të gjithë anëtarët e personelit akademik, mbështetur në normat e ngarkesës mësimore të përcaktuara në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet cilësore të IKT. Me vendim të Senatit Akademik, IKT ka miratuar ngarkesën mësimore për stafin akademik si më poshtë: – Rektor: 120 – 210 orë – Dekan: 180 – 240 orë – Përgjegjës departamenti: 240 – 300 orë – Kategoria Profesor: 180 – 300 orë – Kategoria Lektor: 240 – 320 orë – Kategoria Asistent Lektor: 270 - 360 – Stafi PAK: 120 orë Ngarkesa mësimore e personelit akademik është me përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Fakulteti i Inxhinierisë ka angazhuar në këtë program studimi mesatarisht një staf me kohë të plotë që mbulon 95-100% të ngarkesës mësimore. 54% e ngarkesës mësimore të programit të studimit është mbukuar nga staf akademik me të paktën gradën shkencore Doktor. [Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip] [Evidence 16. Plani mesimor i programit të studimit Bsc në Inxh. Telekom. 2023-24] [Evidence 21. CV e stafit akademik të programit të studimit] [Evidence shtese: 2. Lista e stafit akademik të njesise kryesore-fakultetit] [Evidence shtese 11. VSA nr. 15 dt 28.09.2023 për limitet e ngarkesës mesimore 2023-2024, pika 11]
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi, GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi. Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë në Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit ka një kontratë pune me afat të pacaktuar kur është i kategorisë lektor dhe profesor dhe me afat të caktuar për kategorinë asistent lektor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe statutit të IAL. Të dhënat e personelit akademik mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga zyra e Burimeve Njerëzore e cila krijon Dosjen Individuale të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme ku depozitohet i gjithë informacioni së





	bashku me kontratat e punës dhe sigurimet shoqërore dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. <i>[Evidence 1.1 Statuti i KU IKT 2023 i amenduar]</i> <i>[Evidence 55. Kontrate pune staf me kohë të plotë]</i> <i>[Evidence 56. Kontrate pune staf me kohë të pjesshme]</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi. mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Rekrutimi i personelit akademik në IKT realizohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi, me rregulloren dhe statutin e institucionit. IAL garanton cilësinë e personelit akademik dhe zbaton procedura të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e personelit akademik. Zyra e Burimeve Njerezore është përgjegjëse për konkurset për marrjen dhe pranimin e punonjësve në punë, plotësimin e tyre me librezat e punës si dhe për plotësimin e dosjes personale me dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës të institucionit. Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik kryhet me konkurim, përmes thirrjeve të hapura sipas kritereve të përcaktuara nga njësia bazë. Dokumentacioni mbi rekrutimin dhe procedurat gjendet në Librin e Rregulloreve Institucionale, Kreu VIII- Burimet Njerezore dhe përmban rregullore, procedura dhe udhëzime mbi: - Rekrutimin e stafit - rregulloren që trajton lejet vjetore dhe të tjera - ngritjen dhe funksionimin e komitetit të shëndetit dhe sigurisë - rregulloren e funksionimit të administratës - organizimi zyrtar i komunikimit mes stafit të institucionit etj. Dosjet e kandidatëve vlerëson në dy faza: përmes vlerësimit të dosjes dhe përmes intervistës. Seleksionimi paraprak realizohet nga Zyra e Burimeve Njerezore, e cila i kalon Këshillit të Fakultetit kandidaturat që plotësojnë kriteret e konkurrimit dhe që kanë profil akademik në përputhje me nevojat e përcaktuara nga secili Departament për personel të ri. Departamentet përzgjedhin kandidatët që do të kalojnë në fazën e intervistës. Institucioni ka paraqitur evidencë në lidhje me procedurën e rekrutimit dhe vlerësimit të stafit akademik. Procedura që ndjek IKT është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. <i>[Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip)]</i> <i>[Evidence 38. Burimet Njerezore – Check Lista e Dosjes së personelit]</i> <i>[Evidence 39. Burimet Njerezore – Hapja e një pozicioni pune]</i> <i>[Evidence 40. Burimet Njerezore – Vlerësimi i Kandidatëve]</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në vizitën në institucion, GVJ konstaton se zhvillimi i seancave laboratorike mbështetet nga staf ndihmës akademik (laborant). IKT ka angazhuar 2 (dy) staf ndihmes akademik përgjegjes për laboratorin i cili kontribuon në mirëmbajtjen dhe ndihmon stafin akademik gjatë zhvillimit të orëve laboratorike. Përveç stafit ndihmës akademik, për mirëmbajtjen e laboratorëve angazhohet edhe Zyra e IT, ashtu dhe stafi akademik me eksperiencë. <i>[Evidence Aneksi nr.1 Tabelat përmbledhese - shqip]</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në	Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi takim me përfaqësuesen e Zyrës së Burimeve Njerezore. Gjatë këtij takimi dhe në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni disponon dokumentacion të

programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi, Këto të dhëna ruhen në: – Njësine kryesore dhe bazë të programit të studimit: këto të dhëna kanë të bëjnë me programet e lëndës në të cilën stafi akademik është angazhuar në program, vendime këshillash, komitetesh, kërkimi shkencor, aplikimin për projekte, mobilitete; – Sekretarinë e Fakultetit: të dhëna që kanë të bëjnë me procesin mësimor të ndjekur prej personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, si: procesverbale, dosja e studentit me dokumentacionin e regjistrimit; projekte dhe detyra kursi të dorëzuara prej studentëve që janë pjesë e dosjes së studentit; praktika mësimore; diploma, etj; – Në zyrën e Burimeve Njerëzore: që përfshin: diplomat, çertifikat e ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat e punës, librezë shëndetsore, dëshmia e anglishtes, kërkesa e punësimit etj; – Sistemin e ASCAL: Të dhënat që hidhen prej Koordinatorit të Institucionit në sistemin AMS. I gjithë informacioni administrohet duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave personale dhe arkivohen konform akteve rregullore institucionale. GVJ përmes dokumentacionit të paraqitur nga IKT dhe takimeve të zhvilluara konstaton korrektësinë në zbatimin e procedurës së administrimit të të dhënave të personelit akademik dhe ndihmës-akademik të angazhuar në këtë program studimi. <i>[Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip)]</i> <i>[Evidence 38. Burimet Njerëzore – Check Lista e Dosjes së personelit]</i> <i>[Evidence 39. Burimet Njerëzore – Hapja e një pozicioni pune]</i> <i>[Evidence 40. Burimet Njerëzore – Vlerësimi i Kandidatëve]</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Bashkëpunimet e IKT me industrinë, biznesin, dhe institucione të tjera të arsimit të lartë mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara. Fakulteti i Inxhinierisë mbështetet në këto marrëveshje bashkëpunimi për të përmbushur objektivat e lëndëve praktike të planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni. Praktika mësimore zhvillohet në vitin e 3-të, është pjesë e planit mësimor me 6 kredite ECTS dhe bazohet në bashkëpunime me kompanitë lider të ICT në vend si: Vodafone Albania, Digital Academy Albania⁵²⁶, GIZ, Credins Bank⁵²⁷, Luftansa Industry Solution⁵²⁸, Balfin, IETT⁵²⁹ UBA Bank⁵³⁰, kjo ka lehtësuar mjaft realizimin e praktikave për studentët të cilët realizojnë praktikën pranë këtyre kompanive duke u angazhuar në sisteme reale. IKT organizon edhe trajnime/workshope profesionale që mbështeten nga bizneset partnere me të cilat bashkëpunon institucioni. Institucioni cakton personel akademik të brendshëm për ndjekjen si të praktikave mësimore ashtu dhe temave të diplomave. GVJ gjatë vizitës në institucion, zhvilloi takim me përfaqësues të Zyrës së Shërbimit të Studentëve dhe Karrierës e cila ndër të tjera kishte në kompetencat e saj parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënien e informacionit dhe asistencës së nevojshme për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave




	profesionale/internshipeve të ofruara nga institucionet partnere. Zyra e Shërbimit të Studentëve dhe Karrierës përgatit çdo vit një raport në lidhje me çështjet studentore dhe të karrierës. Ky raport i është vënë në dispozicion edhe GVJ. [Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale"(shqip)] [Evidence 15.1 Raport i Zyrës së çështjeve studentore dhe Karrierës (shqip – anglish)] [Evidence 20.1 Manuali i praktikës Mesimore Bachelor (shqip)] [Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)] [Evidence 49. Informimi i studentëve për mundësitë e punësimit dhe praktikat]		
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Ky program studimi ka të parashikuar lëndën e Internship/Praktikës Profesionale e cila realizohet në vitin e tretë të studimeve Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni në përfundim të së cilës studenti fiton 6 kredite ECTS. Praktika profesionale realizohet si aktivitet i mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit që IKT ka me institucione publike apo private. Njësia bazë cakton një pedagog udhëheqës që asiston studentin dhe garanton cilësinë e rezultateve duke qënë i pranishëm në komisionin e praktikës profesionale. Manuali i Praktikës Mësimore prashikon që studenti, pasi të ketë dorëzuar formularin e aplikimit dhe të ketë marrë miratimin, të zhvillojë praktikën mësimore brenda afateve të përcaktuara. Për vlerësimin e tij ndiqen 3 kriterë: – Vetvlerësimi i studentit, i cili prezantohet përpara komisionit dhe zë 30% të vlerësimit; – Vlerësimi i pedagogut supervizues, i cili zë 70% të vlerësimit të praktikës mësimore; – Vlerësimi i personit përgjegjës për zhvillimin e praktikës mësimore në vendin ku paraqitet student. [Evidence 20.1 Manuali i praktikës Mesimore Bachelor (shqip)] [Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale"(shqip)]		
Konkluzione	- IAL dëshmon njëtrajtshmëri të numrit të personelit akademik në tre vitet e fundit. - Programi i studimit Bachelor në Informatikë është i mbuluar në masën 95%-100% nga staf akademik i brendshëm. - Procedura që ndjek Instituti Kanadez i Teknologjisë për rekrutimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit për pozicionin e punës. - Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" mbulohet në masën 54% nga staf akademik me të paktën gradën shkencore Doktor. GVJ <u>sugjeron</u> që IKT të bëjë përpjekje që leksionet të zhvillohen nga pedagogë me të paktën gradën shkencore Doktor (Standardi IV.1, Kriteri 1).		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X




Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Procesi mësimor në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni zhvillohet në godinen e IKT në Rr. Xhanfize Keko, Kompleksi Xhura, nr.12 në Tiranë, në një sipërfaqe prej 2715 m² nga të cilat, 2400 m² janë ambiente në shërbim të procesit mësimor dhe 300 m² parkim. Në shërbim të programit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” janë 2 klasa me një sipërfaqe totale prej 122 m², të cilat janë për zhvillimin e leksioneve, seminare dhe ushtrime, 1 laborator me sipërfaqe 90 m² si dhe një auditor i madh 140m², me kapacitet 130 persona. GVJ gjatë vizitës në institucion vizitoi ambientet si salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset ndihmëse ku zhvillon mësimin programi Bachelor “Inxhinieri Telekomunikacioni” dhe konstaton që godina e IKT është funksionale për zhvillimin e aktivitetit mësimor. <i>[Evidence 32. Planimetritë e KU IKT]</i> <i>[Evidence 33. Kontrata e Qerasë]</i> <i>[Evidence Aneksi nr.3 Infrastruktura ne shërbim ne fakultetit te inxhinierise dhe dep.te inxhinierise elektronike dhe telekomunikacioni - (shqip)]</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që ambientet ku zhvillon mësim IKT janë të pajisura me mjete elektronike që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies. Konkretisht, IKT ka 5 Laboratorë Kompjuterikë me sistem operativ Windows 10 ose Windows 11 të instaluar me licensat përkatëse prej Microsoft dhe të pajisura me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më modern të procesit mësimor (tabelë smart, videoprojektor dhe shërbim interneti, etj). Çdo laborator është i pajisur me 45 poste pune të pajisura me PC me programe software të përshtatshme sipas planit mësimor. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga departamenti IT sipas kërkesave të pedagogëve të lëndëve. <i>[Evidence Aneksi nr.3 Infrastruktura ne shërbim ne fakultetit te inxhinierise dhe dep te inxhinierise elektronike dhe telekomunikacioni - (shqip)]</i> <i>[Evidence 9. Lista e pajisjeve laboratorike dhe softuereve sipas grup lendeve te programit Bachelor ne Inxhinieri Telekomunikacioni]</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	IKT vë në dispozicion të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” 2 (dy) laboratorë të dedikuar të cilët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të lëndëve. Laboratorët mbështesin lëndët përkatëse të cilat mbulohen nga stafi akademik i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni”. Secili laborator është i pajisur me 20-30 PC që kanë të instaluar një antivirus, Microsoft Security Essentials, i cili mundëson sigurimin e dokumenteve dhe të dhënave të tjera prej infektimit nga viruse të ndryshme. Laboratorët mund të aksesohen në çdo moment gjatë gjithë javës (e hënë – shtunë) nga ora 9:00 deri në 21:00.

	IKT disponon licensë të CISCO të cilën e përdor për kombinimin e lëndëve me kurrikulat e CISCO Academy. Për lëndët specifike, karakterizuese, IKT ka vendosur në funksion të programit të studimit këto 2 laboratorë të pajisura me: - Antenas, RFID, Spectrum Analyzer, Ni-MyDaq, NI LabVIEW and NI ELVISmx Express Vis, Frequency controllers - Cisco Packet Tracer, Computers, Routers, Switches, Modems - Microcontrollers, Arduino different types, Sensors, Power suppliers, Displays, Robotics kits, Camera sensors, Ni-MyDaq - Cisco Academy, Cisco Packet Tracer, KaliLinux, Hac5 kits GVJ vizitoi ambientet e laboratorëve të IKT dhe u njoh nga afer me pajisjet teknike në mbështetje të mësimdhënies dhe praktikave profesionale dhe sugjeron që IAL të ketë në vëmendje pëditësimin e vazhdueshëm të laboratorëve të informatikës në mënyrë që të reflektojnë zhvillimet e shpejta teknologjike. <i>[Evidence Aneksi nr.3 Infrastruktura ne sherbim ne fakultetit te inxhinierise dhe dep.te inxhinierise elektronike dhe telekomunikacioni - (skanuar, shqip)]</i> <i>[Evidence shtese 5.2 Vendim departamenti per blerjen e licenses se CISCO - ETF Decision no.2]</i> <i>[Evidence shtese 9. Lista e pajisjeve laboratorike dhe softuereve sipas grup lendeve te programit Bachelor ne Inxhinieri Telekomunikacioni]</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në bazë të specifikës së programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni”, IKT vë në shërbim të studentëve 2 (dy) laboratorë të cilët janë të pajisur me software dhe hardware që mbështesin studentët në aftësimin e tyre praktik. Ndër dy laboratorët e vënë në dispozicion për këtë program studimi, më i rëndësishmi është Laboratori nr. 5 i përshtatur që të përdoret kryesisht për lëndët laboratorike të inxhinierisë elektronike dhe telekomunikacionit. IKT ka vënë në dispozicion të GVJ listën e pajisjeve në funksion të grup lëndëve të programit të studimit. <i>[Evidence Aneksi nr.3 Infrastruktura ne sherbim ne fakultetit te inxhinierise dhe dep.te inxhinierise elektronike dhe telekomunikacioni - (skanuar, shqip)]</i>			
Konkluzione	IKT vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor të programit të studimit dhe për formimin praktik të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të	Literatura e bazë dhe ndihmëse e kurseve ofrohet në gjuhën e programit angleze. Në disa raste literatura bazë shoqërohet edhe me një cikël leksionesh të përgatitur nga titullari/lektorët e lëndës. Literatura bazë është e evidentuar

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	qartë në syllabusin e lëndës dhe i vihet në dispozicion studentëve në format elektronik nga pedagogu i lëndës dhe/ose në format fizik në bibliotekën e IKT. Literatura është kryesisht e viteve të fundit dhe e përshtatshme për të dhënë njohuritë e kërkuara suplementare për këtë program studimi. IKT ka marrëveshje me një kompani globale që ofron literaturë akademike siç është platforma McGraw-Hill Education që aksesohet nga çdo pajisje smart (telefon, tablet, laptop etj.) dhe platforma O'Reilly që aksesohet në të gjithë institucionin dhe në laboratorë. Gjithashtu, IKT dëshmon që përveç bibliotekës elektronike disponon edhe një sërë titujsh fizikë dhe e pasuron këtë fond në mënyrë të përvitshme sipas kërkesave të departamenteve. Platformat online dhe fondi i librave fizikë shfrytëzohen nga stafi akademik, gjë e cila mundëson që në shërbim të procesit të mësimdhënies të përdoret një literaturë të pasur dhe të përditësuar. GVJ mendon që IKT i kushton rëndësi krijimit të mundësive për shfrytëzim të literaturës më të fundit, përdorimit të saj gjatë mësimit, kërkimit shkencor, etj. në shërbim të realizimit të qëllimeve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni. <i>[Evidence https://IKT.edu.al/library-2/]</i> <i>[Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024]</i> <i>[Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023]</i> <i>[Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022]</i> <i>[Evidence 72. Marrëveshje IKT- McGrawHill Education]</i> <i>[Evidence 80. Marrëveshja IKT - TEXO per O'Reilly]</i> <i>[Evidence shtese 3. Te dhena mbështetese per biblioteken mbi blerjet e librave 2016- 2023]</i> <i>[Evidence shtese 5.1 Vendim departamenti ku jane miratuar kerkesat per tu perfshire ne buxhet - ETE Decision no.1]</i> <i>[Evidence shtese 7. Lista e librave ne dispozicion te programit te studimit]</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse për lëndët bëhet përpara çdo fillim viti akademik nga titullari i lëndës. Bazuar në rregulloren institucionale të IKT, Neni 55, është përgjegjësi i grup-lëndëve i cili në kompetencat e tij ka edeh përcaktimin e materialeve të nevojshme bibliografike dhe informatike në lëndët përkatëse. Programet e studimit analizohen dhe përditësohen rregullisht duke përmirësuar përmbajtjen e programit dhe literaturën. IKT ka vënë në dispozicion të GVJ, programet mësimore të 3 (tre) viteve të fundit. Ajo që është përditësuar më shpesh është literatura elektronike që aksesohet prej stafit akademik të IKT, nga bashkëpunimi me McGraw Hill Education. GVJ kontaton që literatura është përditësuar çdo vit dhe është kryesisht e viteve të fundit. <i>[Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024]</i> <i>[Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023]</i> <i>[Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022]</i> <i>[Evidence 72. Marrëveshje IKT- McGrawHill Education]</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në IKT, GVJ vizitoi ambientet e Bibliotekës, e cila arkivon, digjitalizon dhe mirëmban pasurinë akademike, kulturore e shkencore të Institucionit. Ajo ndodhet në katin e dytë dhe është në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, e studiuesve. Biblioteka fizike ka rreth 5000 tituj, revista, manualë etj. Nga të cilat 371 revista, me rreth 28 tituj në gjuhën shqipe




	dhe me një sektor të veçantë të gjuhës së huaj, si frëngjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht. Të gjithë titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databazën e Bibliotekës dhe çdokush, në çdo kohë mund të ketë akses tek titujt që janë gjendje. Organizimi i fondit të librave është realizuar sipas 'Fondit të hapur' nëpërmjet sistemit KOHA ku studenti ka mundësi të përzgjedhë librat vetë librat e sistemuar në raftë sipas Sistemit Decimal. Në faqen zyrtare të institucionit ka një session në lidhje me Bibliotekën ku jepen të dhënat kryesore lidhur me libraritë me akses të hapur elektronik; përdorimin e McGrawHill Education; përdorimin e platformës O'Reilly; Rregulloren e Bibliotekës; rregulloren për marrjen e librave dhe dorëzimin e tyre; orarin e bibliotekës, etj duke garantuar kështu shfrytëzimin në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. [Evidence https://IKT.edu.al/library-2/] [Evidence shtese 3. Të dhëna mbështetëse për bibliotekën mbi blerjet e librave 2016-2023] [Evidence shtese 7. Lista e librave në dispozicion të programit të studimit]
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka fizike e IKT ka rreth 5000 tituj, revista, manualë etj. Nga të cilat 371 revista, me rreth 28 tituj në gjuhën shqipe dhe me një sektor të veçantë të gjuhës së huaj, si frëngjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht. Në shërbim të Fakulteti të Inxhinierisë është vënë në dispozicion një literaturë e cila përbëhet nga: – Literatura fizike - 2.231 libra – Virtuale e McGrawHill - 6.988 libra – Virtuale e O'Reilly - 44.545 libra Në shërbim të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni disponohet një literaturë e cila përbëhet nga: – Literatura fizike - 394 libra – Virtuale e McGrawHill - 1.677 libra – Virtuale e O'Reilly - 4.839 libra Për pasurimin e bibliotekës është nënshkruar edhe një marrëveshje me "Agjencinë e Abonimit të Shtypit". Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje IKT siguron periodikët më të njohur ndërkombëtarë në fushën e ekonomisë dhe të inxhinierisë. Institucioni merr rregullisht numrat më të fundit të revistave dhe periodikëve të këtyre fushave dhe pasuron bibliotekën me to. [Evidence 72. Marrëveshje IKT- McGrawHill Education] [Evidence 80. Marrëveshja IKT - TEXO për O'Reilly] [Evidence 81. Marrëveshja IKT - Agjencia e Abonimit të Shtypit 15.09.2021] [Evidence Aneksi nr.2 Aktiviteti shkencor i organizuar në 5 vitet e fundit 2018-2023 - (skanuar, shqip), pika 13 BIBLIOTEKA]
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit, përveç literaturës fizike mbështetet dhe në literaturën elektronike të siguruar prej marrëveshjes me McGrawHill Education, O'Reilly dhe CISCO. Kjo literature, sidomos ajo në Bibliotekën O'Reilly përfshin një databazë të pasur nga shtëpitë botuese më të njohura si Wiley, McGrawHill, CISCO Press, Pearson, O'Reilly Media, CRC Press etj. Kjo literaturë është e aksesueshme falas nga të gjithë studentët dhe stafi akademik si për procesin mësimor, ashtu dhe për punime shkencore ose për lexim për rritje profesionale. Platforma McGraw-Hill Education aksesohet nga çdo

	pajisje smart (telefon, tablet, laptop etj.) ndërsa platforma O'Reilly aksesohet në të gjithë institucionin, në bibliotekë dhe në laboratorë. Në faqen zyrtare të saj, IKT ka një session në lidhje me Bibliotekën ku jepen të dhëna të detajuara lidhur me shfrytëzimin e librarive me akses të hapur në dispozicion të stafit dhe studentëve të IKT. [Evidence 72. Marrëveshje IKT- McGrawHill Education] [Evidence 80. Marrëveshja IKT - TEXO per O'Reilly] [Evidence https://ikt.edu.al/library-2]
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike. që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka ka 26 vende leximi, nga të cilat 6 janë të pajisura me kompjuter. Përgjegjësi i Bibliotekës raporton periodikisht për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës, përdorimin e saj, zhvillon anketime dhe takime me studentët, angazhohet për përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët. [Evidence Aneksi nr.2 Aktiviteti shkencor i organizuar ne 5 vitet e fundit 2018-2023 - (skanuar, shqip), pika 13 BIBLIOTEKA]
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre. në përgjigje edhe të nevojave. numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë vizitës në institucion, por edhe gjatë shqyrtimit të Dosjes së Vetë-Vlerësimit, GVJ u njoh me orarin e funksionimit të Bibliotekës së IKT si më poshtë: ▪ E Hënë - E Premte: ora 09:00-13:00 dhe 14:00-18:00 ▪ E Shtunë: 08:00 -15:00. Përgjegjësi i Bibliotekës është prezent gjatë këtyre orareve të shërbimit të cilat janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe i përgjigjen nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. [Evidence Aneksi nr.2 Aktiviteti shkencor i organizuar ne 5 vitet e fundit 2018-2023 - (skanuar, shqip), pika 13 BIBLIOTEKA] [Evidence RVB e Bachelor ne Inzhinieri Telekomunikacioni - (skanuar, shqip)]
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit. shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online. cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore bazuar në kërkesat e faulteteve të IKT. Biblioteka në bazë të kërkesës që vjen prej Fakulteteve dhe kryesisht njësisve bazë ka kryer blerje të ndryshme gjatë viteve, të cilat kanë pasuruar bibliotekën me fonde librash në fushat e programeve të studimit që ofron IKT. Përgjegjësi i Bibliotekës raporton periodikisht për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës, përdorimin e saj, zhvillon anketime dhe takime me studentët, angazhohet për përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët. [Evidence 79. Raport i Librarise per përdorimin dhe aksesin e stafit dhe studenteve - dhjetor 2023] [Evidence 43. Te dhena mbeshetese per biblioteken mbi blerjet e librave 2016- 2023]
Konkluzione	- Biblioteka u përgjigjet nevojave të programeve të studimit me stafin e bibliotekës, ambiente infrastrukture dhe fond librash ekzistues fizik dhe elektronik të pasur. - Literatura në dispozicion të programeve të studimit është e viteve të fundit dhe është përzgjedhur nga shtëpi botuese dhe autorë të spikatur të fushave përkatëse. Kjo literaturë është përfshirë edhe në fondin e bibliotekës.




	- IAL dëshmon që planifikon periodikisht buxhet për pasurimin e literaturës me botime të viteve të fundit në funksion të programit të studimit dhe fondin e nevojshëm të literaturës në bibliotekë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar ne RVB, GVJ konstatoi që Fakulteti i Inxhinierise në IKT ka zhvilluar dhe implementuar një sistem të brendshëm të menaxhimit të institucionit të cilit i referohet si University Management System (UMS). Ky system është implementuar dhe mirëmbahet nga departamenti IT i IKT që prej vitit 2016. Ky sistem përdoret për organizimin dhe administrimin e të gjitha proceseve mësimore të të dy fakulteteve dhe të programeve që ata ofrojnë. Sistemi është i bazuar në një aplikacion online, që aksesohet nga studentët, stafi administrativ dhe akademik nëpërmjet një username-i dhe password të gjeneruar nga departamenti i IT. Sistemi aksesohet online nga faqja e internetit të IKT ku studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj. Në këtë mënyre IKT administron në kohë reale të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim. [Evidence https://ums.IKT.edu.al/index.php?signln=1] [Evidence shites 4. Foto Evidenca te sistemit UMS]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i menaxhimit të informacionit në IKT përdoret në pëpëthje me statutin e IKT-së dhe Rregulloren Institucionale dhe Rregulloren e Njësisë Kryesore dhe aksesohen nga studentët, pedagogët, financa dhe sekretaria respektivisht sipas roleve që ato kanë në institucion. Sistemi i menaxhimit UMS mund të aksesohet nëpërmjet faqes së internetit të institucionit duke përdorur adresën zyrtare nga institucioni. Çdo përdorues/rol ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në IKT. Sistemi ka të integruar platforma si Google Classroom dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Personeli akademik ka akses te regjistrat e lëndëve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj, ndërsa sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj. [Evidence https://ums.IKT.edu.al/index.php?signln=1] [Evidence shites 4. Foto Evidenca te sistemit UMS]


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




	<i>[Evidence shites 4. Evidenca te raporteve te prodhuara prej sistemit UMS]</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi UMS aksesohet online nga faqja e internetit të IKT ku studentët kanë akses në programin mësimor, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, mungesat, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj. Personeli akademik ka akses te regjistrat e lëndëve që mbulon, mungesat në kohë reale, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj, ndërsa sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në programet e studimeve, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj. <i>[Evidence Shenime nga vizita]</i> <i>[Evidence shites 4. Foto Evidenca te sistemit UMS]</i> <i>[Evidence shites 4. Evidenca te raporteve te prodhuara prej sistemit UMS]</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Studentët, stafi akademik dhe administrativ janë të pajisuar me një adresë email të institucionit. Ndërveprimi mes institucionit dhe studentit zhvillohet përmes komunikimit me këtë adrese e-mail nëpërmjet së cilës studentit i jepet mundësi të përdorë Bibliotekën, literaturën mësimore, Class Roomin Virtual, Sistemin e Menaxhimit UMS, si dhe të aksesojë pyetësorët e insitucionit. Sistemi UMS ka të integruar platformën Google Classroom për komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. <i>[Evidence Shenime nga vizita]</i> <i>[Evidence shites 4. Foto Evidenca te sistemit UMS]</i> <i>[Evidence shites 4. Evidenca te raporteve te prodhuara prej sistemit UMS]</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit UMS garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe u mundëson studentëve informacion mbi vlerësimet, mungesat, provimet etj. Ndërkaq sistemi prodhon edhe raportime individuale ose të përgjithshme me të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët e institucionit. <i>[Evidence Shenime nga vizita]</i> <i>[Evidence shites 4. Evidenca te raporteve te prodhuara prej sistemit UMS]</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të IKT [www.IKT.edu.al] meret informacion në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Në faqe gjenden informacione në lidhje me programet e studimit, personelin akademik, kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfitimn e bursave të studimit dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga IKT. Përtej faqes web IKT përdor edhe rrjete sociale si Facebook, ku publikon njoftime dhe foto të aktiviteteve, mundësi praktikash mësimore, bashkëpunime, mobilitete, etj. Pavarësisht që GVJ e gjen faqen zyrtare web të IKT të pasur me informacion, konstaton që rregulloret institucionale nuk gjenden të publikuara në faqen online. GVJ <u>sugjeron</u> IAL të publikojë në faqen e vet zyrtare të gjitha rregulloret institucionale në mënyrë që të jenë më lehtë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit, dhe jo vetëm studentët e këtij institucioni. <i>[Evidence Shenime nga vizita]</i> <i>[Evidence https://IKT.edu.al/]</i>
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë, Instituti Kanadez i Teknologjisë, disponon sistem të brendshëm të menaxhimit institucional i cili është zhvilluar dhe</i>




	mirëmbahet nga departamenti i IT dhe studentët. Sistemi i menaxhimit online aksesohet nëpërmjet adresës email zyrtare dhe është në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik e administrativ për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni". Faqja zyrtare web e IKT është e pasur me informacion, megjithatë GVJ sugjeron IAL të publikojë edhe rregulloret institucionale në mënyrë që të jenë më lehtë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit, dhe jo vetëm studentët e këtij institucioni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në statutin e institucionit, Neni 1 dhe Neni 30, Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" është person juridik fitimprurës. Kolegji në funksionimin e tij bazohet edhe në legjislacionin tregtar me veprimtari të rregulluar sipas Statutit. Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" gëzon liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit. Bordi i administrimit është organi më i lartë kolegjal administrative i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të pasurive të lujatshme dhe të paluajtshme të tij. Bordi i Administrimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të punësuar me kohë të pjesshme me një mandat 4-vjecar. 2 anëtarë përzgjidhen nga Senati Akademik dhe 3 anëtarë emërohen nga themeluesit e kolegjit. Bordi i Administrimit cakton Administratorin e institucionit, i cili është autoriteti më i lartë administrative dhe përfaqësues ligjor i institucionit. IKT çdo vit kryen Audit Financiar nga ku kontrollohen të gjitha llogaritë kontabël. Kontrolli është i përqendruar nëse janë zbatuar "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit" dhe legjislacioni në fuqi. ai harton një raport financiar për të gjithë veprimtarinë institucionale të ndarë në dy njësi kryesore të cilat përfshijnë edhe programet e ofruara duke nxjerrë kostot dhe mbështetjen financiare kur është e domosdoshme. Një raport i tillë përpunohet çdo vit prej Zyrës së Financës dhe i bashkëngjitet Raportit Vjetor Institucional që dorëzohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. [Evidence 1.1 Statuti i KU IKT 2023 i amenduar] [Evidence shtese 1. Organigrama e miratuar prej MAS - Dergohet urdhri për njohje dhe zbatim] [Evidence 46. Raport i Audituesit të pavarur] [Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT për MAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)] [Evidence shtese 7. Vendim i Bordit të Administrimit nr. 4, date 29.05.2020 për miratimin e rregullores financiare] [Evidence shtese 6.1 Raporti Vjetor i Fakultetit të Inxhinierise - me te dhenat e mbledhura prej departamenteve]

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (0) 222-13423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	IKT financohet nga: – Tarifat e studimit që paguhet nga ana e studenteve; – Financim nga ana e Ortakut; – Donacione të ndryshme që merren nga ana e IKT; – Angazhim në Projekte. IKT operon mbi bazën e Rregullores financiare të miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit mbi të cilën zhvillohet aktiviteti financiar i institucionit. Bazuar në Miratimin e Buxhetit, GVJ kontaton që ai përmban të gjithë elementët në kategoritë të ardhura dhe shpenzime, si financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve. Në mënyrë të përgjithshme, IKT gjeneralizon për secilin program, shpenzimet korrente për funksionimin e programit; procesit të mësimdhënies, pagat, shpenzime mirëmbajtje, konferenca, publikime etj. Në dispozicion të GVJ është vënë edhe raporti financiar në lidhje me koston për student të lidhur me programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni”. <i>[Evidence 65. Vendim i Bordit të Administrimit nr. 3.1, date 29.05.2020 për miratimin i Projekt Buxhetit dhe Buxhetit të KU IKT 2020-2025]</i> <i>[Evidence shtese 6. Plani i financimit - Fakulteti i Inxhinierise 2019-20 - 2024-25 (tabela e faqes së fundit)]</i> <i>[Evidence shtese 7. Vendim i Bordit të Administrimit nr. 4, date 29.05.2020 për miratimin e rregullores financiare]</i> <i>[Evidence shtese 13. Kosto për student të lidhur me këtë program studimi dhe përqindja që mbulohet nga të ardhurat nga studentet dhe institucioni]</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	IKT angazhon audit të pavarur për të kryer auditimin e pasqyrave financiare të çdo viti fiskal. Raporti i lëshuar nga Auditimi i pavarur paraqet opinionin e tij në lidhje me të gjitha aspektet materiale, pozicionin dhe performancën financiare, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligjeve në fuqi. <i>[Evidence 46. Raport i Audituesit të pavarur]</i> <i>[Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT për MAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)]</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Të dhëna financiare lidhur me njësinë bazë, fakultetin apo dhe institucionin në përgjithësi, diskutohen Këshillin e Fakultetit, Senatit Akademik, Rektorat, dhe nga këto të dhëna hartohen raporte vjetore të cilat prezantohen në organet kolegjiale, miratohen dhe dërgohen në MAS. Në njësinë bazë bëhen diskutime dhe raportime rreth angazhimit të njësisë për zbatimin e buxhetit të saj lidhur me: – Kërkimin shkencor dhe publikimet – Organizimin e konferencave – Aplikimin për projekte dhe ndjekjen e tyre – Angazhimin e personelit akademik me kohë të pjesshme – Realizimin e aktiviteteve të ndryshme Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik, GVJ konstatoi se personeli akademik ishte i informuar rreth mundësive të

	mbështetjes financiare institucionale për avancimin e tyre akademik, si mbështetje për pjesëmarrje në konferenca apo për botime në revista. [Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT perMAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)] [Evidence Shenimie nga vizita]			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapitalit financiar të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Edhe pse numri i studentëve në tre vitet e fundit për programin Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni ka qenë në rënie, IKT dëshmon se garanton qëndrueshmëri financiare për programin dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës. Nga takimi që GVJ pati me titullaret e institucionit, situata për numrin e studentëve të këtij programi studimi në vitin e ardhshëm akademik shihet më optimiste. Institucioni vitet e fundit përparësi i ka dhënë edhe aplikimit për projekte shkencore dhe kërkimore. Institucioni ka aplikuar për projekte të ndryshme, disa prej të cilëve i ka fituar në partneritet me institucionet të tjera dhe disa nuk janë fituar. [Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT perMAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)] [Evidence Aneksi nr.2 Aktiviteti shkencor i organizuar në 5 vitet e fundit 2018-2023 - (shqip)] [Evidence shtese 13. Kosto për student të lidhur me këtë program studimi dhe përqindja që mbulohet nga të ardhurat nga studentet dhe institucioni] [Evidence Shenimie nga vizita]			
Konkluzione	Instituti Kanadez i Teknologjisë rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare (kryesisht financimin nga të ardhurat nga studentët) për të realizuar objektivat e tij. Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në këtë program studimi paraqet rënie në tre vitet e fundit. GVJ rekomandon që Instituti Kanadez i Teknologjisë të shtojë angazhimin dhe aplikimet për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat përveç se mbështetjes në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në programin e studimit, do të ndihmonin në diversifikimin e të ardhurave financiare të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga dokumentacioni që i është vënë në dispozicion GVJ, konstatohet se institucioni ka të përcaktuara procedurat që duhet të ndiqen për pranimin e studentëve në programin Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit të studimit. Në aktet rregullatore: Statuti i IKT, Rregullorja e Fakultetit të Inxhinierisë, Rregullorja e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit dhe Rregullorja e programit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” përshkruhet procesi i regjistrimit të studentëve, i zhvillimit të procesit mësimor, i transferimit të studimeve, njohjes dhe njehsimit të diplomave, procedura e ankimimit dhe diplomimit të tyre. GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019. Të gjitha rregulloret e printuara ruhen në Bibliotekën e IKT nga ku studentët mund t’i konsultojnë. [Evidence 6. “Rregullore Institucionale e KU IKT” (shqip)] [Evidence 8. “Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë” (shqip)] [Evidence 9. “Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit” (shqip)] [Evidence 10. “Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni” (shqip)]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton zbatimin e procedurave që garantojnë barazinë për çdo student. Procedura dhe kriteret specifike bëhen publike sipas akteve rregullatore të hartuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe të miratuara në njësinë bazë, atë kryesore dhe në Senatin Akademik të IKT. Rregullorja e Fakultetit të Inxhinierisë përmban procedurat dhe praktikën e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të studimeve, gjë që garanton procedura transparente dhe trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve. Dokumentet institucionale përcaktojnë qartë të drejtat dhe detyrimet për stafin mësimor dhe studentët duke mos cënuar lirinë përkatëse të tyre. IKT është transparent me procedurat e regjistrimit, të cilat publikohen në faqen zyrtare si dhe broshura të ndryshme. Metodën e vlerësimit të dijeve shpejgohet në Guidën e Studentit. [Evidence 18. Kriteret e Pranimit të studentëve 2023 - 2024] [Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)]
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni	Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit propozon për çdo vit akademik kriteret e pranimit të studentëve në programin mësimor, miratimi i të cilës bëhet nga Fakulteti dhe Senati Akademik dhe vijon me MASR. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve bëhen publike në faqen zyrtare të IKT si edhe në portalin U-Albania. Për çdo vit

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	akademik, për kuotat e programit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni parashikohen kuota të veçanta për studentë të huaj, nga trojet, me statusin e jetimit, me aftësi të kufizuara dhe nga komunitetet Romë dhe Egjiptiane. GVJ konstaton se procedurat e hartimit dhe miratimit të kriterëve specifike për pranimin e studentëve në këtë program studimi është e mirëpërcaktuar në aktet rregullatore institucionale të IKT. <i>[Evidence 18. Kriteret e Pranimit të studentëve 2023 - 2024]</i> <i>[Evidence 34. Raport i verifikimit të kapaIKTëve pritese sipa kuotave të deklaruara nga KU IKT për vitin akademik 2023-2024]</i> <i>[Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)]</i> <i>[Evidence https://IKT.edu.al/admissions-3/]</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se IKT vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është qartësisht i shprehur në rregulloret e institucionit. Për sa i përket kriterëve dhe procedurave të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, ato janë të shprehura në rregulloren e IAL dhe rregulloren e njësisë kryesore. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të qarta dhe të mirëpërcaktuara në rregulloret e institucionit. Gjithashtu, këto rregullore edhe pse janë në dispozicion të të gjithë të interesuarve në format elektronik dhe në hard copy brenda institucionit, ato nuk janë publike dhe të aksesueshme në faqen zyrtare online të IKT. GVJ <u>sugjeron</u> bërjen publike online të rregulloreve institucionale në faqen zyrtare të IAL në mënyrë që të jenë më lehtë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit, dhe jo vetëm studentët e këtij institucioni. <i>[Evidence 34. Raport i verifikimit të kapaIKTëve pritese sipa kuotave të deklaruara nga KU IKT për vitin akademik 2023-2024]</i> <i>[Evidence 18. Kriteret e Pranimit të studentëve 2023 - 2024]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Kandidatët për studentë dhe gjithë të interesuarit kanë disa mundësi alternative për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen në IKT. Kriteret për pranimin në programet e ciklit të parë dhe të dytë në IKT publikohen në faqen e internetit dhe janë publike. IKT në mënyrë periodike organizon “Open Week” (Ditë të Hapura) në të cilat stafi akademik takohet me kandidatët virtualisht ose në institucion dhe u shpjegon kriteret, procedurat, tarifën dhe mundësitë e regjistrimit në programet që të interesuarit shfaqin interes, mundësitë e mobiliteteve etj. Gjithashtu, IKT merr pjesë në ture nëpër gjimnaze të ndryshme në vend dhe në Panairin e Arsimit, Edukimit dhe Punës “Work and Study” ku prezanton programet e studimit që ofron së bashku me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta. Në këto takime informimi IKT paraqitet me material promovues të përgjithshëm si: guida për studentët e rinj dhe material të vecante në lidhje me programet e studimit sic është programi Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni. <i>[Evidence https://IKT.edu.al/work-and-study-fair-2023-albania/]</i> <i>[Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)]</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43 423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	<i>[Evidence 78. Katalogu i Veprimtarive 2022-2024]</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Për çdo vit akademik, në kuotat e programit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” parashikohen edhe kuota të veçanta për kandidatët e huaj dhe ata nga trojet shqiptare. Kriteret përzgjedhëse janë të njëjta si për kandidatët e tjerë por kuotat janë të dedikuara dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare të IKT, në rrjetet sociale, si edhe në portalin U-Albania. Bazuar në vendimin e Bordit të Administrimit të KU IKT për përcaktimin e tarifave të studimit për vitin akademik 2023-2024, përcaktohen dhe mundësitë që institucioni ofron për kandidatët për studentë me vështirësi financiare, ata me pamundësi të ndryshme, jetimët, familjet në nevojë, kandidatët që vijnë prej familjeve të stafit, studentët nga trojet, etj. <i>[Evidence 62. Vendim nr. 3 BA per tarifat e studimit 2023-2024]</i> <i>[Evidence 18. Kriteret e Pranimit të studentëve 2023 - 2024]</i> <i>[Evidence 34. Raport i verifikimit të kapakTeteve pritese sipa kuotave të deklaruara nga KU IKT për vitin akademik 2023-2024]</i> <i>[Evidence https://ualbania.al/pages/kriteret.html]</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Për çdo vit akademik, në kuotat e programit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” parashikohen edhe kuota të veçanta për aplikantë të huaj. Në kuotat e parashikuara për vitin akademik 2024-2025 programi Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” ka parashikuar gjithësej 20 kuota nga të cilat 1 kuotë për studentë të huaj, 1 kuotë për transferim studmiesh dhe 1 kuotë nga trojet (Kosovë). Kriteret përzgjedhëse janë të njëjta si për kandidatët e tjerë por kuotat janë të dedikuara dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e gjuhës angleze sipas standardeve institucionale të IKT. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare të IKT, në rrjetet sociale si edhe në portalin U-Albania. <i>[Evidence 34. Raport i verifikimit të kapakTeteve pritese sipa kuotave të deklaruara nga KU IKT për vitin akademik 2023-2024]</i> <i>[Evidence 62. Vendim nr. 3 BA per tarifat e studimit 2023-2024]</i> <i>[Evidence 18. Kriteret e Pranimit të studentëve 2023 - 2024]</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Bazuar në vendimin e Bordit të Administrimit IKT ka përcaktuar mundësitë që institucioni ofron për studentët me vështirësi financiare, ata me pamundësi të ndryshme, jetimët, familjet në nevojë, kandidatët që vijnë prej familjeve të stafit etj. Prane IKT funksionon një Komitet Bursash, i cili trajton të gjitha aplikimet për bursë sipas programeve të studimit. Dhënia e bursave mbështetet në numrin e përcaktuar të tyre për: – Studentët/kandidatët me rezultate të larta akademike – Studentët/kandidatët që vijnë nga kategori në nevojë, jetimët – Studentët që angazhohen në klubet studentore ose projekte – Studentët/kandidatët që vijnë nga trojet shqiptare – Ata që regjistrohen herët (early bird) – Ata që vijnë nga familjarë të stafit




	[Evidence https://IKT.edu.al/organization-2/] [Evidence 62.Vendim nr. 3 BA per tarifa e studimit 2023-2024] [Evidence shites 17. Lista e studente me bursa per programin e studimit]			
Konkluzione	IKT harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme institucionale. Fakulteti i Inxhinierisë, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. GVJ <u>sugjeron</u> përditësimin e faqes zyrtare të Institutit Kanadez të Teknologjisë dhe plotësimin edhe me një sesion Legjislacioni, ku të ngarkohen të gjithë rregulloret dhe udhëzuesit institucionale në lidhje me programet e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se IKT dhe Fakulteti i Inxhinierisë vënë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. IKT ka përgatitur guidën e studentit e cila përmban informacion të përmbledhur për studentët nga dokumentat institucionale të miratuar të IKT si: Statuti, Rregullorja Institucionale, Rregullorja e Programit të Studimit, Rregullorja e Sekretarisë Mësimore për Ciklin e Parë, Libri i Rregulloreve Institucionale. Ky dokument përmbledh informacionet që duhet të dijë studenti si: regjistrimi, kriteret e pranimit, tarifat, bursat dhe pagesat e ndryshme, pezullimi i studimeve, çrregjistrimi nga institucioni, pjesëmarrja në mësim dhe lajmërimi përpara përmbushjes së limit të mungesave, ndjekja e lëndëve sipas viteve akademike, vlerësimi sipas tabelës së miratuar, kalueshmëria, të drejtat për t'u ankuar lidhur me notën ose vlerësimin, procedurat që duhet të ndjekë për ankimimin, provimi përfundimtar si dhe testime të tjera. Në fillim të çdo semestri dhe përpara sezonit të praktikës mësimore dhe diplomimeve, zhvillohen sesione konsultime me studentët. Në bazë të Rregulloreve të Tutoriatit dhe Këshillimit Akademik, çdo student ka këshilluesin e tij, i cili çdo javë përcakton një orar për takime me studentët.
	[Evidence 1.1 Statuti i KU IKT 2023 i amenduar] [Evidence 6. "Rregullore Institucionale e KU IKT" (shqip)] [Evidence 8. "Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë" (shqip)] [Evidence 15. "Manuali i Këshillimit të Karrierës"] [Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)]




	[Evidence https://IKT.edu.al/informative-session-on-internships-diploma-thesis/] [Evidence https://IKT.edu.al/IKT-orientation-week-2023/] [Evidence https://IKT.edu.al/academic-orientation-advising/] [Dokument shitese 11.Vendimi Keshillit te Fakultetit per miratimin e tutoriatit studentor per keshillimin akademik]
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	IKT ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve për të gjithë ata që gëzojnë statusin e studentit, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij, apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Transferimet lejohen në të njëjtin cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Studentët informohen në lidhje me kriterët dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve përmes Zyrës së Pranimeve (Admission Office) e cila informon edhe në lidhje me programin e studimit ku ata duan të regjistrohen. IKT dhe Fakulteti i Inxhinierisë pranojnë transferime në bazë të kuotave të dorëzuara pranë MAS në fillim të vitit akademik. Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit (të Kurrikulës) i ngritur në rang njësie. GVJ gjeti pasqyrimin e akteve rregullatore për transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimi e lëndëve në Nenin 82 – “Transferime për ciklin e parë të studimeve” të rregullores së IKT dhe në rregulloren e Fakultetit të Inxhinierisë, Neni 33 – “Transferimet e studimeve”. [Evidence 6. “Rregullore Institucionale e KU IKT” (shqip)] [Evidence 8. “Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë” (shqip)] [Evidence https://IKT.edu.al/admissions-3/]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Gjatë vizitës së kryer, GVJ konstatoi që studentët ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të dijeve. Në fillim të çdo lënde apo moduli pedagogu përkatës i prezanton studentëve planin mësimor të lëndës së tij dhe rregullat e avancimit akademik. Vlerësimi i dijeve është i përcaktuar në syllabuset e lëndëve (Grading Scheme dhe Grading System) dhe forma e kontrollit të dijeve është pjesë e përgjegjësisë dhe lirisë akademike të titullarit të lëndës duke respektuar formatin institucional të miratuar të skemës së vlerësimit. Në fillim të vitit akademik studentët informohen me komunikim të drejtpërdrejt në auditor nga pedagogët për lëndën përkatëse dhe elementët e programit të lëndës, përfshirë dhe vlerësimim. Gjithashtu çdo student ka këshilluesin e tij akademik, i cili oranizon periodikisht takime me studentët sipas orareve të paracaktuara. [Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)] [Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024] [Evidence shitese 4. VSA miratimi i skemes se vleresimit] [Dokument shitese 11.Vendimi Keshillit te Fakultetit per miratimin e tutoriatit studentor per keshillimin akademik]
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ në takimin me studentët konstatoi se ata ishin të informuar mbi procedurat e punimit të temës së diplomës nëpërmjet Guidës së Studentit dhe takimeve që njësitë bazë dhe koordinatorët e programit zhvillojnë përpara çdo semestri dhe në vecanti përpara sezonit të praktikës dhe diplomave. Në IKT, diplomimi i studentëve përfundon me përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës. Procedura e diplomimit gjendet e pasqyruar qartë në aktet rregullatore të IKT. Drejtuesi i departamentit, këshilluesi akademik, stafi akademik, Guida e Studentit, faqia ueb e IKT, rrjetet sociale dhe informacioni i dërguar me email janë disa nga burimet e informacionit për studentët në




	lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni". [Evidence 6. "Rregullore Institucionale e KU IKT" (shqip)] [Evidence 8. "Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë" (shqip)] [Evidence 9. "Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit" (shqip)] [Evidence 13.1 Rregullorja mbi Punimin e Diplomes (shqip)] [Evidence 69. Format i percaktimit te temes se diplomes] [Evidence 47. Student Guide-2023-2024 (Guida e Studentit)] [Evidence shtese 11.Vendimi Keshillit te Fakultetit per miratimin e tutoriatit studentor per keshillimin akademik] [Evidence www.IKT.edu.al/]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ nga takimi me studentët, stafin akademik dhe administrativ evidentoj se IKT ofron disa mundësi alternative për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen për ndjekjen e studimeve në IKT. Për periudhën 2022-2024 disa nga mënyrat që janë përdorur për informimin e studentëve janë: guida e studentit, takime informuese për maturantët në të gjithë shqipërinë, shpërndarja e materialeve promovuese në hard copy dhe elektronikisht, organizimi i Open Week në ambientet e IKT, pjesëmarrja në panairin Work and Study, World Education Fair dhe Panairi i Edukimit, organizimi i shkollave verore dhe kompeticione të ndryshme për maturantët, etj. [Evidence 78. Katalogu i Veprimtarive 2022-2024] [Evidence 77. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022] [Evidence 51. Analize e pyetesoreve në panaiire, shkolla verore dhe aplikimet 2022-2023]			
Konkluzione	Instituti Kanadez i Teknologjisë sipas rregulloreve institucionale disponon informacion të plotë në lidhje me përparimin akademik të studentëve. Stafi akademik dhe administrativ i Institutit Kanadez të Teknologjisë janë të angazhuar të kryejnë takime informuese me studentët në fillim të vitit akademik dhe të mbajnë kontakte për takime periodike me studentët përgjatë vitit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët e regjistruar në këtë program studimi informohen në mënyrë të vazhduar rreth strukturës, organizimit dhe të gjitha aspektet e aktiviteteve akademike të lidhura me avancimin e tyre akademik. Informacionin fillestar mbi kohëzgjatjen e programit të studimit dhe strukturën e tij studentët e marrin paraprakisht në ditët informuese dhe në guiden e studentit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




	Informacione më të detajuara paraqiten në faqen web institucionale [www.IKT.edu.al] ku paraqiten programet e studimit dhe struktura e vitit akademik. Studentët, në mënyrë të vazhduar informohen nga stafi akademik i angazhuar në procesin e këshillimit akademik rreth të gjitha aspekteve të jetës akademike/studentore në funksion të këtij programi studimi. Në veçanti, pedagogët që janë kujdestarë me grupet e studentëve të vitit të tretë, udhëzojnë studentët rreth procedurës së zhvillimit të procesit të praktikës mësimore dhe organizimi të punimit të diplomës. Studentët informohen rreth aktiviteteve didaktike specifike të secilës lëndë nga pedagogët e përfshirë në mësimdhënie, ku secili pedagog, në leksionin e parë me studentët, paraqet syllabusin e lëndës duke theksuar literaturën, detyrimet e lëndës si dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. [Evidence shtese 11, Vendimi Keshillit të Fakultetit për miratimin e tutoriatit studentor për keshillimin akademik] [Evidence www.IKT.edu.al] [Evidence https://IKT.edu.al/admissions-3/]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Detajet në lidhje me përmbajtjen e lëndës, temat, shpërndarjen e tyre gjatë semestrit, mënyrë e vlerësimit, detyrimet akademike dhe administrative, jepen në orën e parë të mësimin nga pedagogu i lëndës në të cilën prezantohet edhe plan programi i lëndës. Studenti ka qasje të personalizuar në hapësirën e tij Google Classroom në të cilën pedagogët ngarkojnë ndër të tjera edhe programin e lëndës. IKT ka të publikuar në faqen zyrtare të internetit dokumenta informues si: Manuali i Praktikës mësimore; Manuali i Mobiliteteve; Manuali i Diplomës; IKT Brochures [Evidence www.IKT.edu.al] [Evidence 20, Programet e lendeve 2023-2024]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	IKT merr pjesë në panairët e punësimit ku kompani të ndryshme marrin pjesë duke paraqitur ofertën e tyre të punësimit. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit që vijnë në institucion prej kompanive apo sipërmarrjeve përmes ofertave që ato dërgojnë, duke ua dërguar këto mundësi atyre nëpërmjet postës elektronike zyrtare. E njëjta gjë praktikohet edhe për mundësitë e praktikave mësimore. [Evidence 49, Informimi i studentëve për mundësitë e punësimit dhe praktikat] [Evidence https://IKT.edu.al/career-guidance/]
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në fillim të çdo lënde/moduli, nga pedagogët e lëndëve paraqiten plan-programet e lëndëve, përfshirë aftësitë dhe kompetencat e përfuara me studimin e saj, aktivitetet didaktike të parashikuara si laboratorë, projekte/detyra kursi, praktika etj. Në faqen ueb zyrtare të IKT afishohen informacione të azhuruara si: Kalendari akademik, Orarin mësimor, Guida e Studentit, Informacion mbi infrastrukturën, stafin akademik dhe fushat e tyre të studimit, për dokumentet zyrtare të licensimit dhe akreditimit, Formatet e ndryshme ndihmëse, Formatet e ankesës, Modele të testimeve/provimeve, Mundësitë e mobiliteteve që institucioni ofron, Klubet studentore. Pavarësisht që GJV e gjen faqen zyrtare web të IKT të pasur me informacion, konstaton që rregulloret institucionale nuk gjenden të publikuara në faqen




	online. GVJ <u>sugjeron</u> IAL të publikojë në faqen e vet zyrtare të gjitha rregulloret institucionale në mënyrë që të jenë më lehtë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit, dhe jo vetëm studentët e këtij institucioni. [Evidence https://IKT.edu.al/student/]			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	IKT përdor sistemin e brendshëm të menaxhimit në të cilin regjistrohet dhe arkivohet informacion mbi studentin që nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi i menaxhimit është i zhvilluar nga departamenti i IT dhe studentët e IKT. Studentët e aksesojnë sistemin e menaxhimit UMS përmes emailit zyrtar të institucionit dhe mund të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit në çdo kohë. Institucioni administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetet mësimore të studentëve përmes sistemeve: UMS, Google Drive dhe Google Classroom. GVJ konstaton se informacioni në lidhje me programin e studimit është i arritshëm lehtësisht nga studentët në distancë nëpërmjet ndërfaqes online të sistemit të menaxhimit, por nuk është i aksesueshëm online në faqen zyrtare web. [Evidence https://ums.IKT.edu.al/index.php?signIn=1] [Evidence shtese 4. Foto Evidenca te sistemit UMS]			
Konkluzione	<i>Faqja web zyrtare institucionale dhe Sistemi i menaxhimit që përdor IAL dhe stafi akademik ofrojnë për studentët informacion të plotë e të hollësishëm në lidhje me objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit. Akses i informacionit nëpërmjet sistemit të menaxhimit është i kufizuar sipas të drejtave të përdoruesve dhe studentët kanë akses pasi logohen me kredencialet e tyre institucionale në sistemin online.</i> <i>GVJ <u>sugjeron</u> IAL të publikojë në faqen e vet zyrtare të gjitha rregulloret institucionale në mënyrë që të jenë më lehtë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit, dhe jo vetëm studentët e këtij institucioni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	IKT mban të dhëna statistike vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve. Të gjitha këto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore e IKT e cila disponon regjistrin e diplomimeve sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe i përcejell ato tek drejtuesit e departamenteve dhe në zyrës së shërbimit të studentëve. Përcjell, këto të dhëna mund të aksesohen në bazë rolesh dhe të drejtash të përdoruesve edhe brenda sistemit të menaxhimit të informacionit, UMS. [Evidence shtese 4. Evidenca te raporteve te prodhuara prej sistemit UMS] [Evidence shtese 4. Foto Evidenca te sistemit UMS]

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë, të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në sekretarinë mësimore. GVJ ndërmori një vizitë në sekretarinë mësimore e cila administron të dhënat e studentëve që nga faza e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Të dhënat mbahen në formë të shkruar dhe elektronike në tre regjistra: – Regjistri themeltar i studentëve; – Regjistri i arritjeve akademike; – Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon: – Viti akademik 2021-2022: 13 studentë; – Viti akademik 2022-2023: 8 studentë; – Viti akademik 2023-2024: 4 studentë; Nga takimi me kryesekretaren, GVJ konstaton se regjistrimi i studentëve në procedurën e aplikimit dhe të pranimit është në përputhje me rregulloret institucionale dhe në përputhje me aktet ligjore të përcaktuara nga MASR. Të dhënat e plotësuara për çdo student të regjistruar janë në renditje kohore me datën e regjistrimit të studentëve. Këto të dhëna mbahen edhe në regjistrin elektronik të sistemit UMS. Regjistri themeltar i studentëve është i plotësuar në përputhje me shtojcën Nr.2 të udhëzimit Nr.31 datë 16.09.2014 të MASR “Për pajisjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve”. GVJ verifikoi edhe regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studenteve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe plotësimi i tij është në përputhje me kuadrin ligjor. Sekretaria mësimore është përgjegjëse edhe për administrimin e të dhënave të studentëve që diplomohen. Të dhënat plotësohen në regjistrin e diplomave dhe tërheqja e saj me suplementin e diplomës bëhet nga vetë studenti ose përmes një autorizimi të noterizuar. <i>[Evidence 12. “Rregullore e Sekretarisë Mësimore – Cikli i Parë” (shqip – anglisht)]</i> <i>[Evidence Aneksi nr.1 Tabelat përmbledhese - shqip]</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat e studentëve mbahen në regjistrat bazë që ruhen në mënyrë të përhershme në përputhje me ligjin “Për Arkivat” dhe janë objekt kontrolli dhe në sistemin e menaxhimit të universitetit ku garantohet ruajtja e konfidencialitetit dhe vërtetësia e të dhënave. Procesverbalet e detyrimeve dhe të provimeve të plotësuara elektronikisht në sistem, të printuara dhe firmosura nga pedagogu përgjegjës ruhen edhe në hard copy duke ofruar siguri të lartë. Aksesit i të dhënave statistikore brenda sistemit UMS realizohet konform të drejtave dhe roleve të përdoruesve sipas rregulloreve institucionale dhe sipas organigramës së IAL-së duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Të dhënat statistikore mblidhen dhe përfshihen në raportet që përgatit njësia bazë, sekretaria, dhe fakulteti për strukturat drejtuese. Ato i vihen në dizpozicion NJSBC, Komiteteve të




	Kurrikulave, Njësive të Kërkimit Shkencor CIRD, të cilat i analizojnë dhe japin sugjerimet përkatëse. [Evidence 12.1 Rregullore e Arkivit (shqip)] [Evidence 12. "Rregullore e Sekretarisë Mësimore – Cikli i Parë"(shqip – anglisht)] [Evidence 37. Raporti CIRD Inxhinieri] [Evidence 19.2 Raport për punësimin e studenteve ALUMNI 2017-2022 - Gjurmimi i studenteve ALUMNI prej institucionit] [Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT për MAS 2022-2023. fq. 39-44 (shqip)] [Evidence 29.6 Raport vjetor i NjSBC 2022-2023 - 21.12.2023]																				
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e të gjithë dokumentacionit (sekretaritë mësimore, etj.). Veprimtaria e sekretarisë mësimore të IKT mbështetet në rregulloret institucionale, rregulloren e Fakultetit të Inxhinierive dhe rregulloren e Sekretarisë Mësimore. Dokumentacioni që ruhet në sistemin e menxhimit të IKT është nën mbikqyrje të vazhdueshme nga specialistët e IT, duke garantuar menaxhimin e sigurt të informacionit dhe të të dhënave. Kontrolli dhe verifikimi i informacionit është lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar në IKT. [Evidence 6. "Rregullore Institucionale e KU IKT" (shqip)] [Evidence 12.1 Rregullore e Arkivit (shqip)] [Evidence 12. "Rregullore e Sekretarisë Mësimore – Cikli i Parë"(shqip – anglisht)]																				
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre regjestrave.	Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit, Fakulteti i Inxhinierisë, IKT hartojnë raporte analitike vjetore. Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Çështjeve Studentore dhe Karrierës (Students Affair and Career Office) dhe NJSBC analizojnë gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti ashtu dhe instanca të tjera. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel insitucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik. Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon: <table border="1"><thead><tr><th colspan="4">Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni</th></tr><tr><th>Viti akademik</th><th>2021-2022</th><th>2022-2023</th><th>2023-2024</th></tr></thead><tbody><tr><td>Nota mesatare në hyrje</td><td>7.88</td><td>8.54</td><td>8.63</td></tr></tbody></table> Të dhënat në lidhje me punësimin e tyre për periudhën 2019-2023 <table border="1"><thead><tr><th>Numri total i të diplomuarve</th><th>Të punësuarit në përputhje me diplomën</th><th>Të punësuarit jo në përputhje me diplomën</th><th>Të papërcaktuar</th></tr></thead><tbody><tr><td>22</td><td>13</td><td>nuk ka</td><td>9</td></tr></tbody></table> Zyra e Çështjeve Studentore dhe Karrierës mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Ajo mban të informuar, fton dhe orjenton studentët e diplomuar në takime, trajnime dhe aktivitete brenda dhe jashtë institucionit. Gjithashtu, Zyra e Çështjeve Studentore dhe Karrierës çdo vit akademik	Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni				Viti akademik	2021-2022	2022-2023	2023-2024	Nota mesatare në hyrje	7.88	8.54	8.63	Numri total i të diplomuarve	Të punësuarit në përputhje me diplomën	Të punësuarit jo në përputhje me diplomën	Të papërcaktuar	22	13	nuk ka	9
Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni																					
Viti akademik	2021-2022	2022-2023	2023-2024																		
Nota mesatare në hyrje	7.88	8.54	8.63																		
Numri total i të diplomuarve	Të punësuarit në përputhje me diplomën	Të punësuarit jo në përputhje me diplomën	Të papërcaktuar																		
22	13	nuk ka	9																		




	harten raporte punësimi lidhur me çdo program, duke analizuar shkallën e punësimit, sektorët ku janë të punësuar studentët, institucionet apo bizneset ku janë të punësuar studentët, etj. [Evidence 19.2 Raport per punesimin e studenteve ALUMNI 2017-2022 - Gjurmimi i studenteve ALUMNI prej institucionit] [Evidence 29.7 Raport drejtuar rektorit dhe dekanëve për Pyetësorin mbi punësimin e studentëve 02.02.2021] [Evidence 15. "Manuali i Këshillimit të Karrierës"]			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Sekretaria mësimore mban statistika për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat përpunohen dhe ruhen si në format fizik, rregjistrat themeltar, rregjistrat e lëshimit të diplomave, ashtu dhe në format elektronik. - Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. - Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa NJSBC dhe Zyra e Çështjeve Studentore dhe Karrierës analizojnë gjendjen e punësimit të studentëve. GVJ vlerëson se strukturat e IKT mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Këto të dhëna menaxhohen dhe kontrollohen vazhdimisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Statutin e IKT studentët kanë të drejtë të përfaqësohen dhe të marrin pjesë në vendimarrje në të gjitha organet drejtuese të IAL-së. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: - Senatin Akademik të IKT - Këshillin e Fakulteteve, - Këshillin e Etikës, - Komisionin e Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin - Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Komitetin e Bursave - Komitetin e Përhershëm për Programet dhe Kurrikulat;

	Rendësia që i kushton IKT përfshirjes së studentëve dhe ALUMNI në vendimarrje vihet re qartë edhe nga përgatitja e një dokumenti Strategjia e institucionit për përfshirjen e ALUMNI në vendimarrje. GVJ gjen të publikuar online në faqen zyrtare web të IKT përbërjen e këtyre organeve drejtuese përfshirë edhe emrat e anëtarëve nga kategoria student. Në Raportin Vjetor të KU IKT për MAS, 2022-2023, raportohet edhe për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në të gjitha strukturat e institucionit. [Evidence 1.1 Statuti i KU IKT 2023 i amenduar] [Evidence https://IKT.edu.al/organization-2/] [Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT per MAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)] [Evidence 67. Strategjia e Angazhimit te ALUMNI 2021 - 2025]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	IKT dhe Fakulteti i Inxhinierisë kanë garantuar përfshirjen e përfaqësuesve të studentëve në organet vendimarrëse, këshillat, etj. Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. Sipas rregulloreve institucionale të IKT studentët shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë. Bazuar në Statutin e IKT, neni 99, studentët organizohen dhe përfaqësohen përmes Qeverisë Studentore. Veprimtaria e Qeverisë Studentore financohet nga fondi i caktuar për këte qëllime në buxhetin vjetor të IKT. Qeveria Studentore zhvillon çdo vit akademik takime me përfaqësues të personelit të IKT për të ndarë pikëpamjet, interesat dhe shqetësimet e tyre, dhe prezantuar aktivitetet, programet, politikat dhe projektet për vitin akademik. Këto takime janë reflektuar edhe në Raportin e përgatitur nga Zyra e Çështjeve Studentore dhe Karrierës. [Evidence 1.1 Statuti i KU IKT 2023 i amenduar] [Evidence 29.8 Pyetësor mbi kënaqësinë e studentëve në IKT – 2023] [Evidence 15.1 Raport i Zyrës së çështjeve studentore dhe Karrierës (shqip – english)]
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimarrëse të IKT bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit. Përmes përfshirjes në Komitetin Permanent për Programet dhe Kurrikulat dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, studentët kanë mundësi që të marrin pjesë në procese që kanë të bëjnë me vlerësimin e mësimdhënies, përmirësimin e programeve të studimit, rishikimin e tyre, apo dhe në hapjen e programeve të reja të studimit. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët merret edhe mendimi për elementët që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Përpunimi i të dhënave të këtij pyetësori për çdo program studimi, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Institucioni për të qenë transparent, publikon në faqen e tij zyrtare të internetit statistika të përmbledhura dhe të dhëna e pyetësorëve. GVJ gjatë takimeve në institucion dhe referuar dokumentacionit të paraqitur, vlerëson që elementët e përmirësimit të programit të studimit janë implementuar në trajtën e:




	– përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve; – në përmirësime në kurrikulën e programit të studimit në masen 20% ; – riorganizimin e programit të studimit, pas vlerësimit dhe miratimit në nivelet përkatëse të universitetit dhe miratimit nga MASR. [Evidence 29.2 Vlerësimi i programit BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni nga studentet 2023 - Pyetësor i NJSBC] [Evidence 29. Vlerësimi Institucional nga Studentet] [Evidence 16.1 Njoftim për përditësimin e programeve mesimore të Fakultetit të Inxhinierisë 30.03.2021] [Evidence 73. Relacion për takimin me student dhe Alumni] [Evidence 67. Strategjia e Angazhimit të ALUMNI 2021 – 2025] [Evidence shtese 1. Argumentimi i ndryshimeve 2018 dërguar në MAS bashkë me dokumentet e tjera për riorganizimin e programit] [Evidence https://ikt.edu.al/quality-assurance-unit-2/]
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në rregulloret e IKT, Fakultetit të Inxhinierisë dhe Programit të Studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” janë të përcaktuara qartë mënyrat e vlerësimit të studentëve duke ju mundësuar dhënien e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në IKT vlerësimi përfundimtar i çdo kursi kryhet në mënyrë të vazhduar duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit si më poshtë: – vlerësimi i midterm në mes të semestrit, ku studenti vlerësohet në masën 20% - 30% të pikëve; – frekuentimi dhe aktivizimi në masen 0% - 10% të pikëve; – detyra, projekte, esse, kuize, etj. 20% - 30% të pikëve; – provimi përfundimtar 50%. Çdo pedagog, në përputhje me natyrën e lëndës dhe rëndësinë që ka aspekti aplikativ, përcakton peshën konkrete të secilit komponent në vlerësimin përfundimtar dhe ia prezanton studentëve në fillim të çdo kursi. Në IKT, e drejta e ankimit është e sanksionuar në Rregulloren e Sekretarisë Mesimore, pika 5.6 - Kërkesa për rivlerësim dhe ankime të ndryshme. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën jo më vonë se 14 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve dhe trajtimi i ankesës kryhet sipas një procedure të mirëpërcaktuar në rregullore. [Evidence shtese 4. VSA miratimi i skemes se vleresimit] [Evidence 12. “Rregullore e Sekretarisë Mesimore – Cikli i Parë” (shqip – anglisht)]
Konkluzione	GVJ konstaton se: - IKT garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.




	- Studentët në IKT janë të organizuar në Këshilla Studentore duke mundësuar shprehjen e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit. - Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të IKT si dhe përpunimi i pyetsorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit - Elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar në përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve; dhe në përmirësime në kurrikulën e programit të studimit në masën 20%; riorganizimin e programit të studimit, pas vlerësimit dhe miratimit në nivelet përkatëse të universitetit dhe miratimit nga MASR - Vlerësimi i kontrollit të dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse të cilat garantojnë barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit. Studentëve u njihet e drejta e ankimit. GVJ vlerëson se KU-IKT/Fakulteti i Inxhinierisë/Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit përfshijnë dhe angazhojnë studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Gjithashtu studentët përfshihen në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	IKT ka në organikë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si: - Zyra e Regjistrimeve (Admission Office) - Zyra për Shërbimet ndaj Studentëve & Këshillimin e Karrierës (Student Affairs & Career Office) - Sekretaria mesimore - Tutoriati akademik Detyra e tyre është që të mbështesin studentin dhe të informojnë sipas përcaktimeve ligjore që lidhen ngushtësisht me statusin e studentit. [Evidence 1.1 Statuti i KU IKT 2023 i amenduar, Shtojcë nr.2 Organigrami e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"] [Evidence 6. "Rregullore Institucionale e KU IKT" (shqip)] [Evidence 11.Vendimi Këshillit të Fakultetit për miratimin e tutoriatit studentor për këshillimin akademik]
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve	Përveç Sekretarisë Mësimore, Zyres së regjistrimeve dhe Zyrës së Shërbimeve ndaj Studentëve & Këshillimit të Karrierës të cilat disponojnë dhe vënë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me regjistrimin dhe avancimin akademik të studentëve, për të mundësuar

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të tyre dhe asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, një rol të veçantë në informimin e studentëve luajnë edhe Tutoriati Akademik dhe faqia zyrtare e IKT dhe Sistemi i Menaxhimit UMS. GVJ vlerëson pozitivisht sanksionimin e rolit të Tutoriatit Akademik në rregulloren “Tutoriati dhe Këshillimi Akademik”. Mbi këtë rregullore mbështetet stafi akademik dhe Zyra për Shërbimin ndaj Studentëve dhe Këshillimin e Karrierës. Tutoriati dhe këshillimi akademik zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik në periudha të caktuara që shpallen kryesisht prej Rektoratit. Periudhat kur zhvillohet tutoriati janë në fillim të vitit shkollor dhe përpara sezoneve të provimeve ose të diplomës. [Evidence 11. Vendimi Këshillit të Fakultetit për miratimin e tutoriatit studentor për këshillimin akademik] [Evidence 7. “Libri i Rregulloreve Institucionale” (shqip) “Tutoriati dhe Këshillimi Akademik”, fq. 57-58] [Evidence https://IKT.edu.al/ - Mtv IKT]
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra për Shërbimet ndaj Studentëve & Këshillimin e Karrierës zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit, krijon mundësi punësimi për studentët, organizon aktivitete si trajnime, seminare, workshop-e dhe jep informacion dhe orientim për praktikën profesionale. Përveçse nga Zyra për Shërbimet ndaj Studentëve & Këshillimin e Karrierës, studentët informohen edhe nga sekretaria mësimore, këshilluesit/tutorët akademikë dhe në përgjithësi edhe nga stafi akademik mbi: - programet e studimit, - akreditimin e institucionit - licensimin e programeve, - mundësitë e karrierës dhe punësimit - akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit - marrëveshjet e bashkëpunimit - Organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve, - njohjen e krediteve - kryerjen e praktikës, - zgjedhjen e temës së diplomës dhe udhëheqësit etj. Zyra për Shërbimet ndaj Studentëve & Këshillimin e Karrierës ruan lidhje të ngushta me Qeverinë Studentore dhe bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të ndryshme të propozuara prej studentëve. Gjithashtu në Javën e Orientimit, zyra bashkëbisedon me studentët e viteve të para për t’u prezantuar atyre: institucionin, programet, faqen e internetit, mobilitetet, klubet studentore, stafin dhe zyrat administrative dhe akademike, mundësitë e punësimit në institucion si dhe jashtë tij. [Evidence 15.1 Raport i Zyrës së çështjeve studentore dhe Karrierës (shqip – anglisht)] [Evidence 49. Informimi i studentëve për mundësitë e punësimit dhe praktikat] [Evidence 7. “Libri i Rregulloreve Institucionale” (shqip)]
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit	Specialistët e zyrës së këshillimit të karrierës mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentë edhe pas diplomimit si informacion i nevojshëm për vlerësimin periodik të programeve të studimit të ofruara në IKT. Ato




të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	synojnë përshtatje me zhvillimin ekonomik kombëtar dhe rajonal. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka paraqitur si evidencë analizën e pyetësoreve në lidhje me punësimin e studentëve në të cilin është ndjekur ecuria e studentëve të diplomuar për të cilët janë mbledhur të dhëna rreth: – punësimin të tyre, – punësimin në profil ose jo, – në cilat kompani janë duke punuar Në raportin vjetor të NJSBC theksohet rëndësia që institucioni i kushton ruajtjes dhe forcimit të marrëdhënieve me ALUMNI. Angazhimi serioz i instancave administrative dhe akademike të IKT për ndjekjen e studentëve ALUMNI vihet re edhe në strategjinë që institucioni ka për këtë objektiv të shprehur qartë në Strategjinë e Angazhimit të ALUMNI. [Evidence 19.1 Studimi dhe Analiza e Tregut të punës për programin BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni - Nentor 2022] [Evidence 19.2 Raport për punësimin e studentëve ALUMNI 2017-2022 - Gjurmimi i studentëve ALUMNI prej institucionit] [Evidence 29.6 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023 - 21.12.2023] [Evidence 29.7 Raport drejtuar rektorit dhe dekanëve për Pyetësin mbi punësimin e studentëve 02.02.2021] [Evidence 59. Student Affairs annual Report - december 2021] [Evidence 67. Strategjia e Angazhimit të ALUMNI 2021 - 2025]			
Konkluzione	GVJ konstaton se në IKT funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si Zyra e Regjistrimeve (Admission Office), Zyra për Shërbimet ndaj Studentëve & Këshillimin e Karrierës (Student Affairs & Career Office), Sekretaria mesimore dhe Tutoriati akademik të cilat janë shumë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. IKT ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave. Këto njësi e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Zyra për Shërbimet ndaj Studentëve & Këshillimin e Karrierës i ndjek studentët pas diplomimit, mban të dhëna mbi shkallën e punësimin të studentëve të programit të studimit, dhe informon organet e autoritetet drejtuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Fakulteti i Inxhinierisë e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standardet e vendosura nga IKT dhe ato shtetërore të cilësisë, duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online). Gjithashtu, IKT sanksionon në Rregulloren e Programit të Studimit, pika 11 “Metodat e Mësimdhënies” dhe në Manualin e Stafit Akademik, pika 6.2. “Mësimdhënia”, forma udhëzimi institucional për stafin akademik, si dhe për të ruajtur të njëjtën linjë teknikash e procesesh didaktiko-pedagogjike në institucion. Në mbështetje të kualifikimit të vazhduar të stafit akademik dhe përdorimit të metodave innovative në mësimdhënie IKT organizon trajnime të ndryshme të cilat janë paraqitur në Raportin Vjetor të Fakultetit të Inxhinierisë, ndër to përmendim trajnimin “Training in Teaching and Education”. <i>[Evidence Takimi në institucion]</i> <i>[Evidence 10. “Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni” (shqip)]</i> <i>[Evidence 14. “Manuali i Stafit Akademik (Staff Handbook)” (shqip)]</i> <i>[Evidence shtesë 6.1 Raporti Vjetor i Fakultetit të Inxhinierisë - me të dhënat e mbledhura prej departamenteve]</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” dhe përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo detyrë drejtohet nga përgjegjësi i departamentit. Në rang institucional në funksion të sigurimit të cilësisë në IKT e cila njihet si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit që përmenden në “Manualin e Sigurimit të Cilësisë” përfshijnë: – Raporte vjetore; – Pyetësor për organizimin e lëndës dhe për pedagogun e lëndës; – Anketime të studentëve për institucionin, stafin, mësimin, infrastrukturën; – Vlerësime të programit nga Fakulteti në bashkëpunim me njësitë bazë, NJSBC, studentët dhe Komitetin e Kurrikulave; – Vlerësime stafi nga strukturat drejtuese; – Vetvlerësime të stafit akademik; GVJ u informua se vlerësimi i lektorëve nga studentët realizohet në fund të cdo semestri. Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit dhe Dekanati. Ndërsa në fund të vitit raportohet sërish analiza mësimore e cila integrohet në analizën mësimore kërkimore të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore.




	[Evidence 29.6 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023 - 21.12.2023] [Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT per MAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)] [Evidence 15.1 Raport i Zyrës së çështjeve studentore dhe Karrierës (shqip - anglisht)] [Evidence 37. Raporti CIRD Inxhinieri] [Evidence 37.1 Raportet personale te kerkimit shkencor te stafit akademik 2022-2023] [Evidence 31.2 Pyetësori mbi kënaqësinë e stafit në punë (Staff Satisfaction Survey) dhe raportimi në Rektorat] [Evidence 29.8 Pyetësori mbi kënaqësinë e studentëve në IKT – 2023] [Evidence 29.2 Vlerësimi i programit BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni nga studentët 2023 - Pyetësori i NJSBC] [Evidence 29.1 Model pyetësori për programin BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni - Model Pyetësori i NJSBC]
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe të ankimimeve sanksionohet në rregulloren e institucionit dhe zbatohet nga strukturat përkatëse në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësie bazë. Studentët janë të përfshirë në të gjitha strukturat vendimarrëse të IKT. Në lidhje me vlerësimin e procesit mësimor ata marrin pjesë në anketime ku shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorëve të vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni”. Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, studentëve u jepet një pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Mendimi i tyre degjohet edhe nga stafi akademik. GVJ vlerëson rolin e këshilltarit akademik si për ti informuar studentet rreth akteve rregullatore institucionale, ashtu edhe për të dëgjuar mendimin e tyre, e më pas për ta përcjellë atë në njësinë bazë. Nga takimi me studentët u theksua marrja e mendimit në mënyrë të vazhdueshme gjatë semestrit në lidhje me temat e trajtuara dhe nëse ka nevojë për përmirësime. [Evidence 29.8 Pyetësori mbi kënaqësinë e studentëve në IKT – 2023] [Evidence 29.2 Vlerësimi i programit BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni nga studentët 2023 - Pyetësori i NJSBC] [Evidence 29.1 Model pyetësori për programin BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni - Model Pyetësori i NJSBC] [Dokument shtesë 11.Vendimi Keshillit të Fakultetit për miratimin e tutoriatit studentor për keshillimin akademik]
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	NJSBC përpunon dhe harton raporte dhe relacione të ndryshme të cilat u vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit si: Senati Akademik dhe Dekaneve dhe disa prej tyre publikohen në mënyrë të përmblendhur në faqen zyrtare web të IKT. Aktualisht në faqen e internetit të IKT, në rubrikën që i dedikohet NJSBC gjenden të publikuar: – Rezultatet e pyetësorit të vitit 2019 – Rezultatet e pyetësorit të vitit 2020-2021 – Rezultatet e pyetësorit me studentët ALUMNI 2020-2021 – Rezultatet e pyetësorit të vitit 2021-2022 – Rezultatet e pyetësorit të vitit 2022-2023




	[Evidence https://IKT.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report/] [Evidence https://IKT.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pvetsorit-2020-2021/] [Evidence https://IKT.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey/] [Evidence https://IKT.edu.al/wp-content/uploads/2022/06/Questionnaires-Report-2021-2022-Fall/] [Evidence https://IKT.edu.al/wp-content/uploads/2024/02/Students-satisfaction-survey-2023/]
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në përbushje të misionit të tij, IKT promovon shembuj të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik duke organizuar aktivitete të ndryshme për nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. IKT ka paraqitur të dhëna mbi vlerësimet, promovimet dhe nxitjet inkurajuese në formën e çmimeve për stafin, si Çmim/Çertifikatë Mirënjohjeje, Çmimin e Rektorit, Çmimin e Administratorit, Çmimin e Senatit Akademik dhe Çmimin e Bordit të Administrimit. Gjithashtu, institucioni jep edhe çmime për studentët të cilat janë individuale ose në grup në formën e bursave të studimit ose përfitime financiare të ndryshme. Personeli akademik i IKT ka qenë pjesë e shkëmbimeve të mobiliteteve duke sjellë në institucion përfitime profesionale dhe duke zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve. IKT ka paraqitur si evidencë listën e mobiliteteve ERASMUS+ dhe CEEPUS gjatë periudhës 2016-2024 ku vërehet pjesëmarrje aktive e studentëve dhe stafit akademik. Gjithashtu, IKT mbështet financiarisht avancimin akademik dhe pjesëmarrjen e stafit në konferenca shkencore, publikimin periodikë shkencorë duke nxitur kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Po ashtu stafi akademik publikon pa pagesë në Revistën shkencore të institucionit "IKT Review Journal" 591, e cila është e indeksuar në databaza të ndryshme [Evidence Aneksi nr.2 Aktiviteti shkencor i organizuar në 5 vitet e fundit 2018-2023 - (shqip)] [Evidence 9.4 Katalogu i Veprimtarive 2022-2024] [Evidence 12. Lista e stafit dhe studenteve të këtij programi që kanë kryer mobilitete] [Evidence 37. Raporti CIRD Inxhinieri] [Evidence 70. Forme aplikimi për financim për publikim në reviste shkencore] [Evidence 71. Forme aplikimi për financim për pjesëmarrje në konference] [Evidence shtese 8.1 Evidence për mbështetje financiare për marrjen e titullit shkencor për stafin e departamentit] [Evidence shtese 8.2 Evidence për mbështetje financiare për publikim shkencor të stafit të departamentit] [Evidence shtese 14. Mobilitetet CEEPUS 2016] [Evidence https://cri.IKT.edu.al/]
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit e zhvillon programin e studimit Bachelor në Inxhiniri Telekomunikacioni në përputhje me standardet e vendosura nga IKT dhe ato shtetërore të cilësisë. - NjSBC drejton në nivel institucioni punën për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.




	- <i>Pyetësorët e vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni mundësojnë garantimin e përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve.</i> - <i>NJSBC publikon raporte të analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Struktura përgjegjëse, në nivel institucional, për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në IKT është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila e ka nisur punën në vitin akademik 2012-2013. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të cilësisë në nivel institucional jepen në Statut (neni 28 dhe 29) dhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përcaktohen në Libri i Rregulloreve Institucionale. GVJ konstaton se këto struktura janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. <i>[Evidence 1.1 Statuti i KU IKT 2023 i amenduar]</i> <i>[Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip), pika VII. MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË (NJSBC)]</i> <i>[Evidence 11. "Manualin e Sigurimit të Cilësisë" (IKT QAU Handbook)]</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë të institucionit dhe e programeve të studimit. NJSBC në IKT përbëhet nga Kryetari, një përfaqësues për çdo Fakultet, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ dhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. Funksionimi i NJSBC bazohet në Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Në kuadër të vlerësimit të brendshëm, GVJ konstaton se, GVB është ngritur në përputhje me Statutin e IKT dhe në bashkëpunim me Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka hartuar Raportin e Vetvlerësimit në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe të bazuar në dokumentat që i janë vënë në dispozicion GVJ. <i>[Evidence 11. "Manualin e Sigurimit të Cilësisë" (IKT QAU Handbook)]</i> <i>[Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip), pika VII. MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË (NJSBC)]</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stala», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	<i>[Evidence Shenime nga Vizita ne Institucion]</i> IKT akreditohet periodikisht. Konkretisht, IKT është akredituar institucionalisht në vitin 2017, duke marrë “Certifikatën e Akreditimit” prej Bordit të Akreditimit të ASCAL dhe Agjencisë Britanike QAA, sipas vendimit të këtij bordi Nr. 116, datë 15.12.2017, për një periudhë 5 vjeçare dhe është riakredituar sërish për një periudhë 5-vjeçare me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 06, datë 27.01.2023. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të Institucionit është 26/01/2028. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni është akredituar për herë të parë, për një periudhë 6 vjeçare, me Vendim të Agjencisë së Sigurimit të Cilesisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) Nr. 38, date 13.07.2018 dhe është riorganizuar nga Bachelor në “Inxhinieri Industriale” në Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” sipas miratimit nga MASR përmes shkresës Nr. 8482/I, datë 31.08.2018. <i>[Evidence 1.4 Vendim i Bordit te Akreditimit nr.06, date 27.01.2023]</i> <i>[Evidence 1.5 Vendim i ASCAL Nr. 38, date 13.07.2018 (akreditimin e pare të programit)]</i> <i>[Evidence 1.6 Praktika per riorganizimin e programit dhe shkresa e pranimit nga MAS Nr.8482-I dt 31.08.2018 (riorganizimi i programit, praktika)]</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	NJSBC ka në kompetencat e tij hartimin e raportit vjetor të sigurimit të cilësisë i cili përcillet për miratim në Senatin Akademik të IKT. NJSBC përpunon dhe harton raporte dhe relacione të ndryshme të cilat u vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit si: Senati Akademik dhe Dekaneve dhe disa prej tyre publikohen në mënyrë të përmblendhur në faqen zyrtare web të IKT. IKT për sigurimin, monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit ka hartuar “Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit”. Procesi i vlerësimit të programit përfshin: – Monitorimin dhe rishikimin e programit – Vlerësimin e programit të lëndës – Vlerësimin e mësimdhënies, stafit akademik Ky proces i brendshëm i cilësisë përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese të bazuara në anketime dhe pyetësorë për: – Vlerësimin e stafit akademik nga studentët; – Vlerësimin të lëndës; – Vlerësimin e kënaqësisë së studentëve nga institucioni; – Vlerësimin e kënaqësisë së stafit akademik dhe administrativ ndaj institucionit. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në takimet me stafin akademik, GVB dhe me përfaqësues nga NJSBC, GVJ gjykon që IKT ka identifikuar tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim për monitorimin e standarteve të cilësisë. <i>[Evidence 7. “Libri i Rregulloreve Institucionale” (shqip), pika Kreu II. “Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit”]</i> <i>[Evidence 29.6 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023 - 21.12.2023]</i>




	[Evidence 31.2 Pyetësi mbi kënaqësinë e stafit në punë (Staff Satisfaction Survey) dhe raportimi në Rektorat] [Evidence 29.8 Pyetësor mbi kënaqësinë e studentëve në IKT – 2023] [Evidence 29.2 Vlerësimi i programit BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni nga studentet 2023 - Pyetësi i NJSBC]			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Në IKT, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, garantohet nëpërmjet strukturave të ngritura në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. - NJSBC funksionon në nivel institucional. - NJSBC monitoron cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikqyr proceset e vlerësimit të brendshëm, raportimin në rastet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë etj. - Në mënyrë periodike, NJSBC zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin. - NJSBC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënërit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	IKT përdor mekanizma të ndryshëm për mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen në mënyrë periodike vlerësimin e programit të studimit. Pyetësorët e ndërtuar kanë për qëllim vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të institucionit. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen në mënyrë statistikore dhe kanë shërbyer si bazë të dhënash edhe nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm në hartimin e raportit në kuadër të akreditimit të programeve të studimit. Zyra e Shërbimit të Studentëve dhe Karrierës harton pyetësorë që targetojnë kompanitë dhe ALUMNI-t. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse të cilët në varësi të problematikave marrin masa për përmirësimin e treguesve. Gjithashtu, edhe fakultetet bëjnë përpjekje për të monitoruar programet e studimit që ofrohen. Përveç analizës mësimore të punës vjetore, në një mbledhje të vecantë në departament, në fillim të vitit akademik miratohen syllabuset e lëndëve duke diskutuar dhe argumentuar ndryshimet. IKT ka zhvilluar vlerësimin e programeve të studimit në mënyrë periodike dhe atë të programeve të lëndëve çdo vit. [Evidence 29.2 Vlerësimi i programit BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni nga studentet 2023 - Pyetësi i NJSBC] [Evidence 29.6 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023 - 21.12.2023]




	[Evidence 31.2 Pyetësori mbi kënaqësinë e stafit në punë (Staff Satisfaction Survey) dhe raportimi në Rektorat] [Evidence 29.8 Pyetësor mbi kënaqësinë e studentëve në IKT – 2023]
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet institucionale të vlerësimit të miratuara, përcillen për diskutim në të gjitha strukturat e IAL deri në nivel njësie bazë. Ndër problemet më kryesore të evidentuara kanë qënë, ato lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësim, cilësinë në shpjegim dhe kontroll, etj. Ky proces finalizohet me një sërë masash në funksion të përmirësimit të programeve të studimit dhe cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Bazuar në vlerësimin e programit të studimit prej njësisë bazë dhe fakultetit, programi Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni ka ndryshuar 20% të kurrikulës në mars të vitit 2021. [Evidence RYB e Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni] [Evidence 29.2 Vlerësimi i programit BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni nga studentet 2023 - Pyetësori i NJSBC] [Evidence 29.3 Vlerësimi i stafit akademik të Fakultetit të Inxhinierisë nga strukturat drejtuese] [Evidence 30. Model vetvlerësimi stafi akademik] [Evidence 29.6 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023 - 21.12.2023] [Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT për MAS 2022-2023] [Evidence 16.1 Njoftim për përditësimin e programeve mesimore të Fakultetit të Inxhinierisë 30.03.2021]
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Në IKT përdoren mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Cilësia e mësimdhënies dhe kurrikulës kontrollohet dhe monitorohet nga Drejtuesi i Departamentit i cili mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies, paraqitjen dhe disiplinën në punë dhe realizon analizat vjetore mesimore shkencore të Departamentit të cilat i përcjell në Dekanat. Në formatin e vetëvlerësimit të stafit akademik, strukturat menaxhuese kur e shohin të arsyeshme kanë mundësi të bëjnë komente dhe sugjerime për secilin pjestar të stafit. [Evidence 29.3 Vlerësimi i stafit akademik të Fakultetit të Inxhinierisë nga strukturat drejtuese] [Evidence 30. Model vetvlerësimi stafi akademik] [Evidence 29.8 Pyetësor mbi kënaqësinë e studentëve në IKT – 2023]
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për	NjBCS mbështetur nga njësitë kryesore në IKT, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimi si: - organizon pyetësore drejtuar studenteve për të marrë mendim në lidhje me cilësinë e programit të studimit dhe pedagogun përkatës; - mbledh të dhëna në formë elektronike nga punëdhënësit kryesorë në rajon në lidhje me ALUMNI-t e IKT; - organizon workshop-ve/panaire pune ku mbledh të dhëna në formë elektronike nga punëdhënësit kryesorë për mbështetjen e praktikave profesionale. Gjithashtu, institucioni vlerëson edhe angazhimin administrativ dhe kërkimor shkencor të stafit akademik dhe të studentëve.




vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfituara nga ky program.	[Evidence 19.2 Raport per punesimin e studenteve ALUMNI 2017-2022 - Gjurmimi i studenteve ALUMNI prej institucionit] [Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT per MAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)] [Evidence 29.6 Raport vjetor i NjSBC 2022-2023 - 21.12.2023] [Evidence 29.3 Vlerësimi i stafit akademik të Fakultetit të Inxhinierisë nga strukturat drejtuese] [Evidence 29.8 Pyetësor mbi kënaqësinë e studentëve në IKT – 2023]			
Konkluzione	GVJ konstaton që: - Instituti Kanadez i Teknologjisë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. - Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit në institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ bazuar në dokumentet bazë institucionale (<i>Statuti, Rregullorja e IKT, Libri i Rregulloreve Institucionale, Manualin e Sigurimit të Cilësisë</i>) dhe vizitën në institucion, konstaton që në IKT funksionon sistemi i vlerësimit të brendshëm ku përfshihen aktorë në nivel institucional (<i>Senati Akademik, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Komisioni i Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore, Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore, Këshilli Etikës dhe Njësia e Trajnimit të Biznesit dhe Edukimit të Vazhdueshëm</i>) dhe në nivel Fakulteti (<i>Dekanati, Këshilli i Fakultetit, Tutoriati Akademik</i>) dhe studentët e përfaqësuar nga Këshilli Studentor. Institucioni angazhon vazhdimisht edhe ekspertë të jashtëm që në bashkëpunim me Komisionin e Kurrikulave vlerësojnë programet e studimit në IKT. GVJ konstaton që IKT parashikon dhe garanton përfshirjen në vlerësimin e brendshëm të aktorëve të brendshëm stafit akademik, stafit joakademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionit. [Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip)] [Evidence 11. "Manualin e Sigurimit të Cilësisë" (IKT QAU Handbook)] [Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT per MAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)] [Evidence shtese 8. Vlerësimi i Programeve të Studimit në Përputhje me Objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Fakultetit]
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për	Manualin e Sigurimit të Cilësisë përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43 423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Procedurat dhe rregulloret përkatëse ngarkojnë NJSBC për ndjekjen e sigurimit të cilësisë në institucion si dhe për proceset që kanë të bëjnë me monitorimin, vlerësimin e brendshëm dhe menaxhimin e vlerësimit të jashtëm. Nga ana tjetër procedurat për përmirësimin e cilësisë dhe Manuali i Sigurimit të Cilësisë përcaktojnë njësitë bazë ashtu si dhe Komitetet e Kurrikulave për vlerësimin e programeve të studimit. Studentët dhe Ekspertë të jashtëm janë gjithashtu palë të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>[Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip)]</i> <i>[Evidence 11. "Manualin e Sigurimit të Cilësisë" (IKT QAU Handbook)]</i> <i>[Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT per MAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)]</i> <i>[Evidence shtese 8. Vlerësimi i Programeve të Studimit në Përputhje me Objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Fakultetit]</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Stafi akademik dhe administrativ bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për cilësinë e programit të studimit, kërkimin shkencor dhe vlerësimin e brendshëm institucional. Në përmirësimin e cilësisë së programit një rol të rëndësishëm luajnë dhe pyetësorët e studentëve si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme konsultative e vendimmarrëse. GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" janë përfshirë staf akademik dhe administrativ, ekspertë të jashtëm dhe studentë. <i>[Evidence 11. "Manualin e Sigurimit të Cilësisë" (IKT QAU Handbook)]</i> <i>[Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT per MAS 2022-2023]</i> <i>[Evidence shtese 8. Vlerësimi i Programeve të Studimit në Përputhje me Objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Fakultetit]</i> <i>[Evidence 29.6 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023 - 21.12.2023]</i> <i>[Evidence 15.1 Raport i Zyrës së çështjeve studentore dhe Karrierës (shqip – anglisht)]</i> <i>[Evidence 19.1 Studimi dhe Analiza e Tregut të punës për programin BSc në Inxhinieri Telekomunikacioni - Nentor 2022]</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se në ngritjen e grupeve të vlerësimit të brendshëm, stafi akademik është i përfaqësuar në mënyrë jo diskriminuese si në bazë gjinie, ashtu edhe grade apo kualifikimi akademik. Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës duke respektuar elementin e barazisë dhe integritetin e stafit akademik dhe studentëve. Ky proces përfshin procesin e vlerësimit të pedagogut nga titullaret dhe nga studentët. Gjithashtu, në hartimin e raporteve dhe në interpretimin e të dhënave institucioni bazohet në dokumentet bazë institucionale (<i>Statuti, Rregullorja e IKT, Libri i Rregulloreve Institucionale, Manualin e Sigurimit të Cilësisë</i>). GVJ nuk gjeti praktika të cënimit të integritetit apo ankimime në lidhje me procesin. <i>[Evidence 11. "Manualin e Sigurimit të Cilësisë" (IKT QAU Handbook)]</i> <i>[Evidence 7. "Libri i Rregulloreve Institucionale" (shqip)]</i> <i>[Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT per MAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)]</i>




	[Evidence shtese 8. Vlerësimi i Programeve të Studimit në Përputhje me Objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Fakultetit] [Evidence 29 6 Raport vjetor i NJSBC 2022-2023 - 21.12.2023]		
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me kompanitë me të cilat IKT ka marrëveshje bashkëpunimi. Programi është vlerësuar prej Komitetit të Kurrikulave, NJSBC dhe vlerësuesit të jashtëm në shtator të vitit 2021. Gjithashtu në procesin e përmirësimit të cilësisë së programit të studimit ka ndihmuar dhe pjesëmarrja në panairin Work and Study, World Education Fair dhe Panairi i Edukimit, turet e përvitshme në shkollat e mesme në të gjithë vendin dhe organizimi i leksioneve të hapura me të ftuar nga jashtë institucionit. GVJ <u>sugjeron</u> institucionin të kryejë vlerësime me të shpeshta të cilësisë së programit, të marrë në konsideratë mendimet dhe ekspertizën e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm dhe të propozojë masa konkrete për adresimin e situatës aktuale ku numri i studentve ka pësuar rënie të ndjeshme në tre vitet e fundit. [Evidence shtese 8. Vlerësimi i Programeve të Studimit në Përputhje me Objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Fakultetit] [Evidence 78. Katalogu i Veprimtarive 2022-2024]		
Konkluzione	GVJ konstatos se: - Në Institutin Kanadez të Teknologjisë, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBC, e cila synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. - NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. - Komiteti i Kurrikulave kryen vlerësimë periodike të programeve të studimit. Vlerësimi i fundit për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" është kryer në vitin 2021. Duke vlerësuar numrin e studentëve në rënie në tre vitet e fundit për këtë program studimi, GVJ <u>sugjeron</u> që institucionin të kryejë vlerësime me të shpeshta të cilësisë së programit, të marrë në konsideratë mendimet dhe ekspertizën e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm dhe të propozojë masa konkrete për adresimin e situatës aktuale.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe	GVJ konstaton se dokumentat (Statuti dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Rregullorja Institucionale dhe ajo e Fakultetit) në të cilat janë përshkruar politikat, strategjitë dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për këtë program studimi, janë vënë në dispozicion të GVJ. Procesi i

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	vlerësimi të cilësisë së programit të studimit (shpërndarja e pyetësorëve, përpunimi i tyre, marrja e rezultateve) është transparente dhe u komunikohet individualisht studenteve dhe të gjithë aktorëve të IAL-së. Në faqen zyrtare web të IKT bëhen publike: Manuali i Sigurimit të Cilësisë, Raporte vlerësimesh pyetësorësh ndër vite, Raporti i pyetësorit me ALUMNI, etj. [Evidence https://IKT.edu.al/quality-assurance-unit-2/]
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ bazuar edhe në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, dhe në takimet e zhvilluara vëren që procesi i vlerësimit të cilësisë në programin e studimit karakterizohet nga transparencja dhe ruajtja e konfidencialitetit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte të vlerësimit të brendshëm të cilat ruhen në arkivën institucionale në përputhje me normat e ligjit nr. 9154, date 06.11.2003 “Për arkivat” me normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në Rregulloren e Njehsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike në Republikën e Shqipërisë si dhe në përputhje me politikat e brendshme të privatësisë së të dhënave i cili është hartuar në përputhje me Programin Kombëtar të Transparencës. Të gjitha të dhënat në IKT përpunohen dhe bëhen publike duke zbatuar politikat institucionale të privatësisë së të dhënave personale. Rezultatet e vlerësimeve u vihen në dispozicion individualisht anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamenteve dhe dekanëve përkatës. [Evidence 12.1 Rregullore e Arkivit (shqip)] [Evidence https://IKT.edu.al/quality-assurance-unit-2/]
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte në funksion të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë si për program studimi ashtu edhe në nivel institucional. Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Në të gjitha rastet është detyrë e autoriteteve drejtuese brenda fakultetit dhe njësive bazë që të angazhohen për ti adresuar drejtë dhe për t'i shmanjur dobësitë apo kërcënimet e shfaqura. [Evidence Shenime nga vizita] [Evidence 11. “Manualin e Sigurimit të Cilësisë” (IKT QAU Handbook)] [Evidence 7. “Libri i Rregulloreve Institucionale” (shqip)] [Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT per MAS 2022-2023. fq. 39-44 (shqip)]
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në IKT është ngritur në vitin 2013 dhe prej atij viti, anëtarësia ka mbetur e njëjtë, duke ruajtur strukturën për të siguruar vijimësi dhe cilësi në insitucion. NjsBC ka në përbërjen e saj një staf akademik të konsoliduar dhe përfaqësues nga studentët. GVJ konstaton angazhim nga ana e IKT në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. [Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip] [Evidence 11. “Manualin e Sigurimit të Cilësisë” (IKT QAU Handbook)] [Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT per MAS 2022-2023. fq. 39-44 (shqip)]




Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	IKT mbështet të gjitha organet e brendshme në trajnime me qëllim sigurimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni. Hartimi i RVB për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” dhe grumbullimi i informacionit në mbështetje të tij ka qenë një proces në të cilin është angazhuar jo vetëm GVB, por edhe gjithë instancat drejtuese të IKT dhe Fakultetit të Inxhinierisë, Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit si dhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. NJSBC ka organizuar takime dhe veprimtari të ndryshme për ndërgjegjësimin e personeli akademik ashtu si dhe studentëve për sigurimin e cilësisë në institucion dhe në programet e studimit. <i>[Evidence 27. Raport Institucional Vjetor i KU IKT per MAS 2022-2023, fq. 39-44 (shqip)]</i> <i>[Evidence https://IKT.edu.al/quality-assurance-meeting/]</i> <i>[Evidence https://IKT.edu.al/quality-of-education-and-teaching-skills-training-session/]</i>			
Konkluzione	Institucioni paraqet kulturë të brendshme të cilësisë mbi politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të cilat janë të sanksionuara në rregulloret dhe strategjitë e institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Telekomunikacioni" të ofruar nga Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Departamenti i Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit, organizon këtë program studimi me angazhimin e një stafi akademik të ri në moshë dhe të përkushtuar në përcimin e dijeve.
2. Ofrimi i programit të studimit në gjuhën angleze mundëson anagazhimin e një stafi akademik ndërkombëtar dhe të kualifikuar dhe lehtëson ndërkombëtarizimin e programit.
3. Lëndët në tërësi, plani mësimor dhe organizimi i tij, janë në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimesh dhe i ngjashëm me ato të ofruara nga IAL të tjera.
4. Ngarkesa mësimore realizohet kryesisht nga personeli akademik efektiv duke respektuar detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi.
5. Për çdo grup studentësh është përcaktuar një këshillues akademik i cili në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit është përgjegjës për mbarrëvajtjen e programit të studimit.
6. Bashkëpunimet me kompani dhe korporata për krijimin e programeve të praktikës profesionale, zhvillimin e projekteve të përbashkëta dhe sigurimin e mundësive të punësimit për studentët dhe partneritete me institucione akademike dhe kërkimore si shkëmbimin e njohurive, organizimin e konferencave të përbashkëta apo mundësi për studime të avancuara dhe projekte kërkimore.
7. KU IKT ka funksionale mekanizma të monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm cilësisë ku përfshihen edhe studentët.
8. Komunikim student-pedagog, student-institucion shumë efektiv.
9. Institucioni paraqet qëndrueshmëri në vite të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.
10. Literatura në dispozicion të programeve të studimit është e viteve të fundit dhe është përzgjedhur nga shtëpi botuese dhe autorë të spikatur të fushave përkatëse, veçojmë marrëveshjet me McGrawHill Education dhe O'Reilly.
11. IAL disponon dhe përdor një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional i cili është zhvilluar dhe mirëmbahet nga departamenti i IT dhe integron platforma si Google Classroom që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.
12. Faqe zyrtare web të pasur me informacion.
13. Institucioni paraqet kulturë të brendshme të cilësisë mbi politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të cilat janë të sanksionuara në rregulloret dhe strategjitë e institucionit.

Pika të dobëta:

1. Ndarja e lëndëve sipas kategorive A, B, C, D dhe E është pjesërisht në përputhje me standartet e kërkuara për secilën disiplinë me shmangie nga standardi për lëndët e kategorisë C. (*Standardi II.1, Kriteri 3*)



2. Angazhimi i studentëve të Inxhinierisë së Telekomunikacionit në mobilitete ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në projekte në fushën e telekomunikacionit mungon. (Standardi II.1, Kriteri 4 dhe Standardi IV.5, Kriteri 5)
3. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni mbulohet në masën 46% nga staf akademik pa tituj dhe grada. (Standardi IV.1, Kriteri 1)
4. Rregulloret institucionale nuk gjenden të publikuara elektronikisht online në faqen zyrtare të institucionit por fizikisht në bibliotekën e IAL. (Standardi V.1, Kriteri 4)
5. Numri i studentëve në tre vitet e fundit për programin Bachelor në “Inxhinieri Telekomunikacioni” ka qenë në rënie. (Standardi IV.5, Kriteri 5 dhe Standardi V.4, Kriteri 2)
6. IAL nuk ofron vijim të mëtejshëm në studimet master në të njëjtën fushë për studentët që mbarojnë Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni.

Rekomandime:

1. Rekomandojmë ndarjen e lëndëve sipas kategorive A, B, C, D dhe E, në përputhje me standartet e kërkuara për secilën disiplinë VKM nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar.
2. Rekomandojmë që në syllabuset e lëndëve të jenë të përcaktuara temat e detyrave/projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike.
3. Të ofrohen alternativa mobilitetesh ndërkombëtare për studentët e programit Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni.
4. Institucioni të bëjë përpjekje që leksionet të zhvillohen nga pedagogë me të paktën gradën shkencore Doktor.
5. Publikimin online në faqen zyrtare të rregulloreve dhe udhëzuesve institucionale në lidhje me programet e studimit në gjuhën shqipe dhe angleze.
6. Institucioni të shtojë angazhimin dhe aplikimet për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e Telekomunikacionit.




Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Telecommunication Engineering" provided by the Canadian Institute of Technology

Strengths and affirmations

1. The Department of Electronics and Telecommunication Engineering organizes this study program with the engagement of a young and dedicated academic staff committed to sharing knowledge.
2. Offering the study program in English enables the engagement of an international and qualified academic staff, facilitating the internationalization of the program.
3. The subjects, overall curriculum, and its organization are in line with the formative objectives of the students for this cycle of studies and are similar to those offered by other Higher Education Institutions.
4. The teaching load is primarily carried out by the effective academic staff, adhering to current legal and sub-legal obligations.
5. For each group of students, an academic advisor is assigned, who, in collaboration with the department head, is responsible for the smooth operation of the study program.
6. Collaborations with companies and corporations for the creation of professional practice programs, the development of joint projects, and the provision of employment opportunities for students, as well as partnerships with academic and research institutions for knowledge exchange, organizing joint conferences, or opportunities for advanced studies and research projects.
7. The CIT Higher Education Institution has functional mechanisms for continuous quality monitoring and improvement, which include student participation.
8. Very effective communication between students and faculty, and between students and the institution.
9. The institution demonstrates stability over the years in the academic staff engaged in this study program.
10. The literature available for the study programs is recent and has been selected from distinguished publishing houses and authors in the respective fields, highlighting agreements with McGraw-Hill Education and O'Reilly.
11. The Higher Education Institution possesses and uses an internal institutional management system developed and maintained by the IT department, integrating platforms like Google Classroom, which enable interactive communication and information exchange between academic staff and students.
12. An official website rich in information.
13. The institution demonstrates an internal quality culture regarding policies, processes, and activities for Internal Quality Assurance, which are sanctioned in the institution's regulations and strategies.

Weaknesses

1. The division of subjects according to categories A, B, C, D, and E is partially in compliance with the required standards for each discipline, with deviations from the standard for subjects in category C. (Standard II.1, Criterion 3)
2. The engagement of Telecommunication Engineering students in international mobility and participation in projects in the field of telecommunications is lacking. (Standard II.1, Criterion 4 and Standard IV.5, Criterion 5)
3. The Bachelor program in Telecommunication Engineering is covered to the extent of 46% by academic staff without titles and degrees. (Standard IV.1, Criterion 1)



4. Institutional regulations are not published electronically online on the institution's official website but are available physically in the HEI library. (Standard V.1, Criterion 4)
5. The number of students in the last three years for the Bachelor program in Telecommunication Engineering has been declining. (Standard IV.5, Criterion 5 and Standard V.4, Criterion 2)
6. The HEI does not offer a master's program for students who complete a Bachelor's in Telecommunication Engineering.

Recommendation

1. We recommend the division of subjects according to categories A, B, C, D, and E, in compliance with the required standards for each discipline as per VKM no. 41, dated 24.1.2018, "On the elements of study programs offered by Higher Education Institutions," as amended.
2. We recommend that the syllabi of the subjects include the topics of course assignments/projects and laboratory work.
3. Alternatives for international mobility for students in the Bachelor program in Telecommunications Engineering should be offered.
4. The institution should strive to ensure that lectures are delivered by instructors with at least a Doctoral degree.
5. The online publication on the official website of institutional regulations and guides related to study programs in both Albanian and English.
6. The institution should increase engagement and applications for national and international research projects in the field of Telecommunications.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X